

GAZETË E PAVARUR. NR. 11 (172) NËNTOR/DHJETOR 2020. ÇMIMI: 50 LEKË. 20

Nga **ABDURAHIM ASHIKU**

— Page 6-7

Nga prof. **ADEM BUNGURI**

— Faq 8-9

Nga **OSMAN XHILI**

— Faqe 11

Rreth 100 kryefamiljarë në Dibër, pavarësisht aktit normativ të qeverisë që ndalon tubimet, protestojnë në Laçës, 10 km larg qytetit të Peshkopisë, për të kundërshtuar planet për ndërtimin e hidrocentralit të Skavicës. Policia gjëmbit organizatorët, ndërkohtë që nuk kishte marrë asnjë masë për parandalimin e tubimit. Protesta diskutohet në emisionin ‘Wake Up’ në Top Channel: Ujërat mbysin fushën e Dibrës

Page 2-3-4

Ndjesa publike, falja e gjobave dhe një referendum lokal - hapi i parë i qeverisë drejt një procesi dialogu të rregullt e ligjor

Lajmet për nisjen e qarkullimit në rugën e Arbrit në pranverën e vitit të ardhshëm kanë qenë të mirëpritura për banorët, por ato për ndërtimin e Skavicës e kanë ulur gëzimin. Sepse, për një popull që shpërngulet, aq më keq pa dëshirën e tyre, duke i shpërfilluar, diskriminuar, gjobitur e sulmuar, rruga e re është që shpresonte t'i kthente, do ti ndihmojë për të ikur. Dhe ky nuk është lajm i mirë.

Banorët e luginës së Drinit kanë nevojë të dinë se çdo të bëhet me të ardhmen e tyre. Qeveria duhet të jetë më transparente me ta. Ata e kanë dëshmuar historikisht se janë më shumë atdhetarë se shumë politikantë dhe qeveritarë në Tiranë. Ndaj, në këtë proces, nuk duhet të shihen si kundërshtarë të së ardhmes së Shqipërisë. Ata duhen përfshirë në këtë proces, dhe një referendum lokal duhet të ishte një nga vendimet e duhura. Sigurisht, pasi qeveria të kërkojë ndjesë publike dhe të falë gjobat shumëmilionëshe ndaj dretësuesve të shoqatës.

Nga **BUJAR KAROSHI** — Fage 4

— Page 4

Ura e Fshatit Fshat u bashkua më 25 nëntor 2020, duke i hapur kështu mundësitë që në pranverën e vitit të ardhshëm, në rrugë të nisë qarkullim i automjeteve. Kjo urë është një nga gjashtë urat e Rrugës së Arbrit, e dyta për nga rëndësia, pas Urës së Vashës. Ajo është e gjatë 174 metra dhe e lartë 157 metra. Konstruksionet metalike të saj, ashtu si Ura e Vashës, janë realizuar me elemente çeliku me karbon të saldeshëm. Përfundimi i saj shënon simbolikisht edhe lidhjen e plotë të të gjitha segmenteve në ndërtim të rrugës, përjashtuar tunelin e Murrizit, 3.8 km të gjatë, që pritet të përfundojë në qershor 2023. Foto: © **Zaim Elezi** (Shih më shumë në faqen 24)

Bej **“Like”** dhe **“Share”**. Pajtohu dhe qëndro me gazetën #rrugaearberit më pranë #Dibrës!

Për më shumë informacion:

Tel: 00455 68 65 08 441.

Email: rrugaearberit@gmail.com



+355 68 65 08 441


$$+ 355\ 69\ 20\ 68\ 603$$
[illegible]

- **Minatorët** kërkojnë statusin e harruar përmes peticionit
- Banorët e **Maqellarës** kërkojnë ujë për vaditje
- **Kamber Faruku:** Kur po shkriheshin akujt
- Kujtime për **Gani Metën**
- **Shefqet Kaca**, njeriu i veçantë
- Mjeku enciklopedist **Ramazan Buci**
- **Caje Poleshi**, zëri i artë i këngës së pastër shqipe
- Katër breza sportistësh të **familjes Skuka**
- **Poet i ngjyrave** të vendlindjes, i dashurisë dhe patriotizmit brilant...
- **Kongresi i Dibrës** i vitit 1909, moment vendimtar në historinë tonë kombëtare
- **Tafë Dauti** i Sllatinës
- Lamtumirë miku ynë i mirë **Hidër Daci**
- **Bardhyl Hidër Manjani**, biri i Grykës së Vogël
- Lamtumirë bilbil i pemëtarisë dibranel!

**Redaksia e gazetës
ju uron lexuesve,
bashkëpunëtorëve, kontribuesve
dhe donatorëve të gazetës,
Gëzuar Krishtlindjen
dhe Vitin e Ri!
Qoftë një vit i mbarë
për të gjithë!**

Gazeta “Rruga e Arbërit” është një media e lirë dhe e hapur.
Çdo kontribut me shkrime, abonime ose donacione është i mirëpritur!
Bëj pajtimin tënd me **PayPal** përmes emailit <rrugaearberit@gmail.com>
Një pajtim vjetor kushton: Në Shqipëri: 600 lekë. Në Europë: 10 Euro.
Në SHBA dhe vende të tjera: 15 USD.
Pajtimi në Europë dhe SHBA është vetëm në versionin PDF.



Gazetë e pavarur. Nr. 10 (171). Tetor 2020
Gazeta doli nga shtypi, 15 dhjetor 2020.
Gjendet në treg gjatë gjithë muajit Janar 2021.

Redaksia e gazetës falënderon lexuesit dhe bashkëpunëtorët e saj për mesazhet dhe shkrimet e sjella për botim.
Kujtojmë bashkëpunëtorët, të cilët duan që shkrimet e tyre të botohen patjetër në numrin e radhës, të konfirmojnë më parë sjelljen e materialit në numrat e telefonit të redaksisë ose emailin e gazetës.
Shkrimet refuzohen për botim vetëm në rast se mermi përgjigje me email. Për çdo rast tjetër shkrimet priten për botim në numrat e radhës.
Shkrimet në redaksi për numrin e radhës priten deri më datë 20 të muajit, përveç rasteve të bashkëpunëtorëve të rregullt.
Gjithashtu, ju kujtojmë bashkëpunëtorëve se shkrimet deri në dy faqe daktilografike kanë përparësi botimi.
GJITHASHTU, KUJTOJMË SE ÇDO SHKRIM I BOTUAR NË NJË MEDIA TJETËR APO RRJETE SOCIALE NUK KA PËRPARËSI BOTIMI.
JU LUTEMI, SHKRIMET QË VIJNË PËRMES EMAIL-it, TË KENË PATJETËR ZANOREN “ë”.

Ju falënderojmë që jeni pjesë e gazetës!

BOTUES:

Musa Riçku
Bujar Karoshi
Shaqir Skarra

Editor i faqes online: Agim Deva

Kontribuan për këtë numër:

Osman XHILI
Abdurahim ASHIKU
Avni ALCANI
Leonard VEIZI
Ballsor HOXHA
Bajram XHAFA
Arif MURRJA
Haki Përnezha
Mevlud BUCI
Nazmi KOÇI
Halil RAMA

Redaksia falenderon për zemërsisht zotin **Bledar Kaca** për donacionin prej 5000 lekësh dhënë për gazetën.

KËRKOHEN KORRESPONDENTË NË PESHKOPI DHE DIBËR TË MADHE

Të interesuarit për korrespondentë/menaxherë duhet të kenë pasion gazetarinë. Përbën avantazh përvojja në shtypin e shkruar ose në qoftë se kanë mbaruar studimet për gazetari dhe letërsi / marketing. Të jenë të angazhuar për punën në grup dhe të jenë të pavarur politikisht gjatë kohës që bashkëpunojnë me gazetën.
Të interesuarit të shkruajnë email në adresën <rrugaearberit@gmail.com> ose të telefonojnë në numrin 069 20 68 603.

Arkivi i gazetës është PA pagesë në faqen e internetit www.rrugaearberit.com.
Falënderojmë z. **AGIM DEVA** për kontributin e vazhdueshëm për mirëmbajtjen e faqes së gazetës në internet dhe arkivin online.
Pajtimet në gazetë mund t’i bëni në çdo kohë duke komunikuar në adresat e redaksisë.
Bëj pajtimin tënd me **PayPal** përmes emailit <rrugaearberit@gmail.com>
Një pajtim vjetor kushton: Në Shqipëri: 600 lekë. Në Europë: 10 Euro. Në SHBA dhe vende të tjera: 15 USD.
Pajtimi në Europë dhe SHBA është vetëm në versionin PDF.
Për kontribute për gazetën mund të kontaktoni redaksinë ose mund t’i bëni ato përmes numrit të llogarisë më poshtë:
Raiffeisen Bank
Rruga e Arberit
Nr. llog. në lekë: 0010036640
IBAN: AL44 2021 1219 0000 0000 1003 6640

Adresa e gazetës:
Rr. “Zenel Baboçi”,
Pall. “Ferar”, Tiranë
Tel. + 355 4 22 33 283
+ 355 69 20 68 603
E-mail: rrugaearberit@gmail.com

Opinionet dhe komentet e botuara nuk shprehin domosdoshmërisht qëndrimin e redaksisë
Çdo shkrim apo foto e botuar i nënshtrohet ligjit për respektimin e të drejtave të autorit. Ndalohej riprodhimi, fotokopjimi, shpërndarja apo ribotimi pa lejen e autorit të shkrimit apo redaksisë.

Protesta diskutohet në emisionin “Make Up” në Top Channel:

Ujërat mbysin fushën e Dibrës

“Unë jam njëri nga ata banorë të Dibrës që kërcënohemi nga Skavica, - tha Haki Përnezha përmes lidhjes me Skype. Dibra ka 141 fshatra me rreth 86 mijë banorë, ndër to 27-34 fshatra mbyten, duke përfshirë 8 mijë hektarë tokë”

“Çmimi i vendosur nga 60 mijë lekë deri 100 mijë lekë, tani do ta lëmë për 200 paketa duhani. Tu ofrosh banorëve një shumë të tillë, është sa cinike aq edhe qesharake. Asnjë ekip qeveritar nuk ka ardhur të na tregojë se çdo të bëhet. Ekipet duhet të vijjnë të ulen me banorët, të japin alternativa. Kjo nuk ka ndodhur”

Me 7 dhjetor në mëngjes, emisioni Wake Up në Top Channel, i drejtuar nga Ori Nebijaj dhe Islami Islami, i kushtoi një kohë të rëndësishme çështjes së protestës së banorëve kundër HEC të Skavicës.

Pasi bëri një përshkrim të shkurtër të planeve të qeverisë shqiptarë në vite për ndërtimin e HEC të Skavicës, Islami Islami pyeti se si do të jenë hapat e mëtejshëm për të kundërshtuar këto plane.

“Unë jam njëri nga ata banorë të Dibrës që kërcënohemi nga Skavica, - tha Haki Përnezha përmes lidhjes me Skype. Dibra ka 141 fshatra me rreth 86 mijë banorë, ndër to 27-34 fshatra mbyten, duke përfshirë 8 mijë hektarë tokë”

“Dëmi i madh ekonomik i çdo familje është i papërfillshëm nga qeveria, por dëmi tjetër është në pikëpamjen e zhdukjes që ne e quajmë hambari i gjithë Dibrës, Në këto fusha që do të mbulohen nga ujërat e Skavicës kanë ndërtuar jetën, jo vetëm banorët e këtyre fshatrave, por edhe banorët e tjerë. Zhduken të paktën 8 vendbanime historike” - tha mes të tjerash Haki Përnezha.

“Askush nga qeveria nuk ka shkuar atje, as nga kjo qeveri dhe as ato të mëparshmet, - tha Bujar Karoshi, redaktor i gazetës Rruga e Arbërit, i pranishëm në studio. Një nga mënyrat që i irriton banorët atje është mënyrë se si qeveria po vepron në lidhje me ndërtimin e HEC Skavica. Që nga viti 2005 e në vazhdim, në mbyllje të mandatit ose në fillim fushatash, qeveria ka folur vazhdimisht për ndërtimin e HEC Skavicë, për projekte, për variante A e B, digën 443 metra e 385 metra, një digë e dy diga, por ajo që është e rëndësishme të theksohet, pavarësisht çfarë varianti do të vendoset për tu ndërtuar, fusha e Dibrës përmbytet”.

Ai tha se me ndërtimin e Skavicës do të krijohen shumë probleme sociale, do të ketë migracion dhe emigracion. Sipas tij 15 mijë banorë do të shpërngulen nga shtëpitë e tyre dhe rreth 40 mijë të tjerë do t’u përmbytet tokat e punueshme.

Ai vuri në dukje problematikat në lidhje me pronësinë.

“Toka që ata punojnë dhe me të cilën jetojnë, nuk e kanë në pronësi - tha Bujar Karoshi. Në vitin 1991 atje nuk u respektua ligji 7501 dhe gjithkush shkoi në tokat e trashëguara. Nuk pati probleme në ndarjen e tyre, por tani ato janë burim konfliktesh. Ato nuk janë të regjistruara dhe nuk e dinë se çfarë planesh ka qeveria për regjistrimin dhe vlerësimin e tyre”.



Ai theksoi se banorët janë fyer nga mënyra se si institucionet po veprojnë dhe nga mënyra se si qeveria po sillet me ta. Ai theksoi se gjoba prej 50 milionë lekësh (të vjetra) për organizatorët e protestës është një mënyrë presioni dhe diskriminimi ndaj banorëve.

Moderatorja Ori Nebijaj tha gjatë një ndërhyrje në bisedë se “nëse do të ndërtohet ky HEC, rezervuari i tij do të fundosë nën ujë të paktën 8000 ha tokë nën kulturë, ose 64% të saj për tërë Dibrën.

“T’i heqësh Dibrës 64% të tokës nën kulturë në rajonin më pjellor që përbën bazën e ekonomisë bujqësore për të, a do të thotë edhe për ju të zbrazësh Dibrën nga dibranët?”, pyeti Nebijaj.

Të dy të ftuarit ishin dakord me këtë konstatim.

Haki Përnezha tha se “çmimi i vendosur nga 60 mijë lekë deri 100 mijë lekë, tani do ta lëmë për 200 paketa duhani. Tu ofrosh banorëve një shumë të tillë, është sa cinike aq edhe qesharake”.

“Asnjë ekip qeveritar nuk ka ardhur të na tregojë se çdo të bëhet. Ekipet duhet të vijjnë të ulen me banorët, të japin alternativa. Kjo nuk ka ndodhur”, tha Haki Përnezha në lidhje direkte.

Islami Islami, duke iu referuar faktit se qeveria

“Një nga mënyrat që i irriton banorët atje është mënyrë se si qeveria po vepron në lidhje me ndërtimin e HEC Skavica. Që nga viti 2005 e në vazhdim, në mbyllje të mandatit ose në fillim fushatash, qeveria ka folur vazhdimisht për ndërtimin e HEC Skavicë, për projekte, për variante A e B, digën 443 metra e 385 metra, një digë e dy diga, por ajo që është e rëndësishme të theksohet, pavarësisht çfarë varianti do të vendoset për tu ndërtuar, fusha e Dibrës përmbytet”.

nuk ka folur me banorët, theksoi se kjo është “përmbytja e parë”.

“HEC i Skavicës e ndan Dibrën në dy pjesë, - tha Bujar Karoshi. Dibra është ndarë njëherë në dy pjesë në vitin 1913, herën e dytë ka ndodhur në vitet 1960-70, me ndërtimin e hidrocentralit të Dibrës, ku 15 mijë dibranë u detyruan të emigrojnë drejt SHBA dhe Turqisë. Tani do të ndahet për herë të tretë, dhe natyrisht që do të ketë një valë tjetër emigracioni apo imigracioni dhe do të ketë një ndarje të madhe kulturore, gjeografike, historike në rajonin e sotëm të Dibrës. Nuk do të ketë më rrugë komunikimi ose ato do të jenë shumë të largëta. Kështu që nga pikëpamja administrative dhe komunikimit, ato duhet ti bashkohen bashkive të tjera: Kukësit, Matit dhe Mirditës.”

Ai ngriti edhe shqetësimin e probleme që sjell në mjedis dhe në peisazhin dhe ekonominë e pjesës tjetër të Dibrës.

“Duke qenë se Skavica do të jetë një ushqyes me rezerva ujore për hidrocentralet e tjera mbi Drin, ajo do të jetë gjatë verës pa ujë, dhe 1 metër sikur të bjerë niveli, dhjetëra metra do të jetë në terren, duke sjellë një dëm të madh mjedisit. Ndaj nuk mund të propagandojmë një botë idilike me varka e anije, me zhvillim peshkimi e turizmi”.

Gjithashtu, ai vuri theksin edhe në ndikimin që do të ketë ekosistemi i ri në pjesën tjetër të ekonomisë së Dibrës, kryesisht në frutikulturë.

“Dibra, - tha Haki Përnezha, ka pasur malet në njërin anë dhe fushën në anën tjetër, të cilat kanë pasur një lidhje organike, kanë komunikuar njëra me tjetrën, kanë mbështetur njëra-tjetrën. Me ndërtimin e HEC, ky komunikim shkëputet, duke i sjellë një dëm të madh komunitetit”.

“Planet e një qeverie të denjë do të duhet të sillnin në sytë e banorëve të një vendi shkëlqim dhe reze shprese - tha në mbyllje të emisionit moderatori Islami Islami, - dhe jo sytë e mbushur me lot, për shkak të gjithë dhimbjes që ky plan do të shkaktoje”.

Bujar Karoshi tha në fund të emisionit se “qeveria duhet të tregojë një vullnet për bisedime me banorët, dhe hapi i hapë është heqja e gjobës për dy organizatorët”.

(Korr. Rr.A.)

Rreth 100 kryefamiljarë në Dibër, pavarësisht aktit normativ të qeverisë që ndalon tubimet, protestojnë në Laçës, 10 km larg qytetit të Peshkopisë, për të kundërshtuar planet për ndërtimin e hidrocentralit të Skavicës. Policia gjobit organizatorët, ndërkohë që nuk kishte marrë asnjë masë për parandalimin e tubimit.

Protestë kundër HEC Skavica

“Jo planeve të qeverisë për të mbytur shtëpitë dhe tokat tona”

Nga **BUJAR KAROSHI**

Më 1 dhjetor 2020, banorët e fshatrave të Fushë Alies, Laçës, Kastriot, Blliqe e Arras u mbledhën për të kundërshtuar vendimet e qeverisë shqiptare për ndërtimin e Hidrocentralit të Skavicës. Protesta e zhvilluar në një kodër buzë Drinit, në Laçës, u thirr nga shoqata “Për Mbrojtjen e Pellgut të Drinit të Zi” me qëllim zgjedhjen e një përfaqësies nga banorët dhe koordinimin e tyre, me qëllim që në bisedimet qeverinë, të mbrohen sa më mirë interesat e banorëve të Luginës së Drinit.

Protesta u zhvillua aty ku ngrihet Lapidari i Betejës së Torviollit, ku Skënderbeu mundi keq ushtrinë e Sulltan Muratit II. Ky lapidar, i ngritur me kontributin e banorëve në 25 nëntor 2014, përkujton gjithashtu edhe Masakrën e Çidhnës të kryer nga ushtria e osmane në vitin 1466, kryengritjet antiosmane 1560-1833 si dhe luftën kundër serbëve në vitet 1913-1920.

Tashmë ky lapidar do të shërbejë edhe si pikënisja e kundërshtimit të planeve të qeverisë shqiptare për ndërtimin e Hidrocentralit të Skavicës, uji i së cilës do të mbulojë këtë lapidar dhe gjithë tokat e pellgut të Drinit të Zi, nga Skavica deri në Gjoricë.

Memorandumi i bashkëpunimit ekonomik Shqipëri-ShBA, i nënshkruar në Tiranë më 3 tetor 2020, mes ministres së Financave Anila Denaj dhe Nënsekretarit të Shtetit për Rritjen Ekonomike, Energjinë dhe Mjedisin z. Keith Krach si dhe memorandumit tjetër i nënshkruar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë Belinda Balluku dhe përfaqësuesit të kompanisë Bechtel, Justin Siberell, nën praninë e kryeministrit Edi Rama i ka irrituar shumë banorët.

“NUK KA VENDIM PA DAKORDËSINË E BANORËVE”

Nazmi Drizi, kryetar i shoqatës u kërkoi banorëve të mbledhur që të mbajnë maskat dhe të ruanin distancat. “Ne kërkojmë që të tjerët të respektojnë ligjet dhe rregullat, ndaj edhe ne duhet ti respektojmë rregullat për mbrojtjen e shëndetit”, u tha ai pjesëmarrësve para nisjes së protestës.

“Nuk duam t’i hapim luftë askujt, s’duam të përplasemi me askënd, por kërkojmë të mbrojmë të drejtat tona - tha Nazmi Drizi në fillim të protestës.

Duke iu referuar marrëveshjes me kompaninë amerikane Bechtel, Drizi tha se “argumentet se duke ndërtuar Skavicën, sigurojmë energjinë elektrike dhe shpëtojme Shkodrën” është fyes për dibranët, por edhe për shkodranët.

“Shkodra është e jona, tha Drizi, malësorë si ne. Qindra dibranë



Pamje nga protesta e 1 dhjetorit 2020

kanë lënë kokën për ndihmë të Shkodrës kundrejt Malit të Zi, ndaj edhe qeveria nuk duhet ta sjellë më këtë argument: Dibra është Dibëra dhe Shkodra është Shkodër”.

Drizi, duke u shprehur kundër ndërtimit të Hidrocentralit, kërkoi nga qeveria shqiptare që me çdo kusht, përpara se sa të marrë vendime, të ulet me popullin.

“Për 30 vjet, tha ai, qeveria nuk ka bërë asgjë për këtë popull: nuk ka rregjistruar tokat dhe shtëpitë, nuk ka bërë asnjë investim, ndërsa tani merr vendime: të mbytim Dibrën!”.

Ai vuri në dukje se nuk do të pranojnë asnjë vendim të qeverisë shqiptare, asnjë marrëveshje bashkëpunimi apo investimi, pavarësisht se kush ndërton apo kush investon, pa një dakordësi të të gjithë banorëve.

Haki Përnezha, historian, banor i Fushë-Alies, tha se “shteti vërtet mund të marrë vendime për interes publik, por gjithashtu shteti shqiptar ka nënshkruar konventat për të drejtat e njeriut, e cila na jep të drejtë të kundërshtojmë, të kërkojmë të drejtat tona, të maksimalizojmë pronën tonë”.

“Për fat të keq, tha Përnezha, ne e dimë se ku jetojmë dhe këtu tek ne nuk ndodhin gjëra të tilla, prandaj dhe sensibilizimi është kaq i madh”.

Përnezha, duke iu referuar historisë, tha se “nuk po bëhet asgjë për evidentimin e vlera të historisë, arkeologjisë dhe trashëgimisë së këtij popullit”.

“Instituti i Arkeologjisë nuk ka caktuar ende një person të vijë të identifikojë dhe t’i studiojë, pa folur për historinë e periudhës së Mesjetës, pa folur për betejën e Torviollit, me të cilat ne krenohemi”.

Haki Përnezha vuri theksin në hartimin e qëndrimeve të drejta e të arsyeshme, të cilat do të detyrojnë qeverinë të marrë vendime të drejta për këta njerëz dhe këtë popull.

“LIGJET EUROPIANE NA JAPIN TË DREJTË TË MBROJMË TOKËN TONË, PASURINË TONË, SHTËPINË TONË”

Ali Hoxha, i cili kishte udhëtuar nga Tirana për këtë protestë, mban edhe detyrën honorifike si “President Nderit i Shoqatës për Mbrojtjen e Pellgut të Drinit të Zi”

“Sot jam këtu për çështje kombëtare. Kam ardhur për të ruajtur tradita tona. Të parët tanë këtë truall e kanë mbrojt me gjakun dhe me jetën e tyre dhe na e kanë trashëguar ne sot. Sistemi diktatorial na shpronësoi, por ja që sot ne i trashëgojmë sërish ato”.

Hoxha, duke iu referuar kompanisë amerikane “Bechtel” tha se “nuk po e bëjnë Shtetet e Bashkuara të Amerikës këtë hidrocentral, po e bën një kompani amerikane. Ne jemi mësuar me konceptin e shtetit të diktaturës, dhe akoma nuk ka na dalë frika nga barku. Nuk është shteti i diktaturës sot. Janë ligjet e demokracisë evropiane, ligje të cilat na mundësojnë ne të mbrojmë tokën tonë, pasurinë tonë, shtëpinë tonë”.

Hoxha, duke bërë një historik të dhënies me koncension e tenderave që nga viti 2005, tha se deri më tani ne i kemi kundërshtuar dhe rrëzuar këto vendime, në sajë të përpjekjeve tona të përbashkëta dhe sepse kemi pasur të drejtën me vete”. Ai u bëri thirrje drejtuesve të pushtetit lokal dhe përfaqësuesve të Dibrës në parlament, që ti mbrojnë fort interesat e banorëve.

Nazmi Skepi, i cili mban edhe detyrën e Sekretarit të Shoqatës, tha se “ne i themi Jo Skavicës dhe Po Dibrës”.

“Këtu nuk ka të majtë dhe të djathtë, këtu jemi të gjithë bashkë për të mbrojtur tokën tonë. Ne luftojmë për të mbrojtur trojet tona, traditat tona, historinë tonë”, tha ai.

(Vijon në faqen 4)

GJOBA RIT TENSIONET MES BANORËVE DHE QEVERISË



Në foto: Nazmi Drizi dhe Ali Hoxha. Foto: N. Feta

10 milionë lekë gjobë ndaj dy drejtuesve të shoqatës

Organizatorët: asnjë gjobë nuk mund të shërbejë si presion për të hequr dorë nga të drejtat tona.

Menjëherë pas protestës, punonjës të policisë kanë shoqëruar në komisaratin e Peshkopisë dy organizatorët, Nazmi Drizi dhe Ali Hoxha, në cilësinë e Kryetarit të Shoqatës dhe Presidentit të Nderit.

Arsyet e ndalimit kanë qenë shkelja e masave anticond dhe aktit normativ në fuqi në lidhje me pandeminë. Dy drejtuesit janë mbajtur për disa orë në komisaratin e policisë, pa u marrë deklaratat e tyre në lidhje me protestën.

Në një njoftim për shtyp më datë 3 dhjetor nga Drejtoria Vendore e Policisë Dibër shkruhet se “shtetasi Ali Hoxha, President i Shoqatës Drini i Zi, dhe shtetasi Nazmi Drizi, Kryetar i Shoqatës Drini i Zi, kanë organizuar një grumbullim me rreth 40 persona, për të protestuar kundër ndërtimit të Hec-Skavica. Gjatë zhvillimit të tubimit, Policia para se të ndërhynte për të shpërndarë tubimin, u ka bërë thirrje protestuesve që të shpërndaheshin, pasi po zhvillohej në kundërshtim me masat anticond”.

Por pjesëmarrësit në tubim thonë për gazetën “Rruga e Arbërit” se “kanë qenë 3 policë, të cilët vetëm kanë vëzhguar nga larg dhe në fund kanë takuar Aliun dhe Nazmiun, të cilët i morën me vete. Ata nuk kanë bërë asnjë veprim për të parandaluar protestën apo grumbullimin e paligjshëm”.

Ali Hoxha, Presidenti i Nderit i Shoqatës, i cili kishte shkuar nga Tirana për të folur në këtë protestë, tha për gazetën “Rruga e Arbërit” se vetëm pasi i kishin futur në makinë, u kishin thënë që do shkojnë në komisaratin për të lëshuar një deklaratë për këtë protestë.

“Ne kemi ndenjur disa orë në korridor në pritje të shefit, - thotë Ali Hoxha, - më pas i kemi telefonuar prefektit të Dibrës, i cili ka ndërhyrë për lirim tonë”.

“Nuk jam njoftuar zyrtarisht për gjobën, - tha Ali Hoxha. Ne kemi dalë nga komisarati pa u marrë në pyetje dhe pa lëshuar asnjë deklaratë. Prefekti i Dibrës na kërkoi ndjesë për arrestimin tonë, ndaj nuk e kuptoj arsyen e gjobës. Unë isha në protestë si gjithë të tjerët, pasi posti që unë mbaj është honorifik dhe nuk kam në shoqatë asnjë detyrë organizative”.

Hoxha e konsideron gjobën ndaj tij dhe kryetarit të shoqatës Nazmi Drizi, si një përpjekje për të trembur popullin në protestat e radhës.

Ali Hoxha tha se me “16 mijë lekë pension, unë nuk mund ta paguaj kurrë gjobën, ndaj nëse ajo është e vërtetë, ajo është për turpin e atyre që e kanë nënshkruar”.

Ndërsa Nazmi Drizi tha me ironi se “edhe pse jam 70 vjeç, do të paguaj këtë gjobë dhe gjithë të tjerat, por kurrë nuk do të lejojmë që qeveria të mbyjë toka tona duke shkelur mbi jetët tona dhe dinjitetin tonë”.

Protestat për ndalimin e synimeve të qeverisë shqiptare për ndërtimin e HEC të Skavicës do të vazhdojnë, pavarësisht aktit normativ të qeverisë.

“Në qoftë se qeveria, për shkak të pandemisë, na heq të drejtën të reagojmë dhe protestojmë, por për të njëjtën arsye duhet të ndalë përpjekjet e saj për mbyjtjen e Dibrës. Sepse pa vullnetin e popullit të Dibrës, askujt nuk duhet ti shkojë në mendje ndërtimi i HEC Skavica dhe mbyjtja e luginës së Drinit të Zi”- thonë organizatorët.

Skavica, qeveria duhet të jetë transparente me banorët

Ndjesa publike, falja e gjobave dhe një referendum lokal - hapi i parë i qeverisë drejt një procesi dialogu të rregullt e ligjor

Nga **BUJAR KAROSHI**

Vendimet e qeverisë shqiptare për të ecur përpara me projektin e ndërtimit të Skavicës, është një lajm i zi për banorët e Luginës së Drinit të zi.

Rreth 34 fshatra do të mbyten nga ujërat e liqenit dhe rreth 8 mijë hektarë tokë e punëshme, do të zhduken përgjithmonë.

Qeveria shqiptare, që nga viti 2005, ka marrë vendime në Tiranë për të çuar përpara këtë proces, madje ka shpallur edhe tendera ndërkombëtare, por të gjitha kanë dështuar. Dhe dështimin nuk ka dalë askush ta shpjegojë, ashtu siç askush nuk ka dalë të marrë mendimin e banorëve, madje ta diskutojë më to: çdo të bëhet me jetët e tyre?

Sipas ligjit shqiptar, hapi i parë i procedurave është një studim fizibiliteti, te i cili një nga kriteret kryesore të vlerësimit është ndikimet mjedisore dhe sociale. Në studimin e fizibilitetit të prezantuar nga qeveria, flitet për ndikimin në mjedis dhe efektet sociale që do të sjellë në Shkodër e Lezhë, por nuk flet fare për problematikat që shfaqen në Dibër. Së paku nuk flitet publikisht, pasi realisht nuk mendojmë se institucionet vendimmarrëse nuk i njohin këto probleme.

Tu kërkosh dibranëve të pranojnë që me përmytjen dhe shpërnguljen e tyre shpëton Shkodra dhe Lezha, është diskriminuere, është një argument që e bën me faj qeverinë, por është edhe një arsye se pse irritohen banorët, të cilët edhe në ditë pandemie, dalin për të protestuar.

Gjatë 30-viteve të tranzicionit, kjo krahinë është lënë larg investimeve publike. Pa rrugë, pa ujë për vaditje, pa projekte zhvillimi, pa një plan mbështetje për bujqësinë, blegtorinë e frutikulturën etj. Gjithçka e arritur në këto vite është vetëm në sajë të punës së tyre, pa asnjë mbështetje qeveritare ose shumë pak.

Kjo sjellje e qeverisë shqiptare, nga njëra anë duke vazhduar me projektin e Skavicës dhe nga ana tjetër duke mos bërë asnjë transparencë me banorët, i ka indinjuar ata, i ka bërë



Pamje nga protesta paqësore e 1 dhjetorit 2020.
Foto: © Neki Feta

Lajmet për nisjen e qarkullimit në rrugën e Arbrit në pranverën e vitit të ardhshëm kanë qenë të mirëpritura për banorët, por ato për ndërtimin e Skavicës e kanë ulur gëzimin. Sepse, për një popull që shpërngulet, aq më keq pa dëshirën e tyre, duke i shpërfillur, diskriminuar, gjobitur e sulmuar, rruga e re është që shpresonte t'i kthente, do ti ndihmojë për të ikur. Dhe ky nuk është lajm i mirë.

të dalin në protesta, të cilat, në të ardhmen mund të jenë më të shumta, më të ashpra dhe më të fuqishme.

Skavica mund të jetë me bilanc pozitiv për qeverinë, por është me bilanc negativ, shkatërrues për këta banorë. Ai konsiderohet se është shkatërrues drejtpërdrejtë për ekonominë e mbi 2500 familjeve, si dhe krijon probleme të tjera për mijëra familje të tjera.

Skavica e ndan dysh Dibërën e ndarë njëherë në viti 1913. Fundos përgjithmonë vlera të mëdha kulturore e historike duke i sjellë një dëm të madh rajonit. Dhe ky plan është i ngjashëm njësoj me planet e kancelarisë serbe, faza e parë e të cilit u krye 100 vite më parë.

Qeveria shqiptare, me sjelljen e deritanishme, është duke shkelur të drejtat themelore të pronësisë dhe të drejtat e njeriut, për të cilat Shqipëria mund të japë llogari nesër edhe në Gjykatën Europiane të Drejtave të Njeriut. Në vend që të gjejë rrugët e komunikimit dhe bashkëbisedimit me banorët, qeveria shqiptare ka zgjedhur të qëndrojë e heshtur. Dhe kur banorët protestojnë, ajo vendos të mbështetet në ligje të përkohshme për ti dënuar ata.

Akti Normativ i Qeverisë shqiptare do të jetë i vlefshëm sa kohë pandemia do të zgjasë, por gjobat dhe ndëshkimet për banorët dhe vendimet e tyre për të mbuluar me ujë Dibërën, është i njëhershëm dhe i pakthyesëm.

Banorët e Luginës së Drinit i kanë dalë zot Shqipërisë kurdoherë, aty ku ka pasur nevojë. Kanë rrokur armët dhe kanë dhënë jetën për liri. Dhe si të tillë, nuk mund të konsiderohen "antikombëtarë", që nuk e duan Shqipërinë dhe vendin e zhvilluar. Ata nuk e dua Shqipërinë të vjedhur.

Qeveria shqiptare, megjithëse është vonë, duhet të nisë menjëherë një fushatë informuese dhe diskutimi me banorët. Të informojë për çmimet e shpronësimit, të ndihmojë në regjistrimin dhe vlerësimin e pronave, tokave dhe shtëpive, kullotave dhe bagëtive, pemëtoreset, pyjet dhe gjithçka tjetër që ata banorë shfrytëzojnë sot.

Të tregojë jo vetëm çfarë është e mirë për kaskadën e Drinit, por edhe për çfarë do të jetë e mirë për banorët - nëse ka. Të tregojë planet e transferimit, punësimit, infrastrukturën e re, urat e shkollat, qendrat shëndetësore, investimet në turizëm e frutikulturë, në mënyrë që këta banorë të zgjedhin të jetojnë në Dibër, jo të migrojnë brenda vendit apo të fëmijët e tyre jashtë atdheut. Në qoftë se qeveria e bën këtë, ndoshta llogaritë nuk do t'i dalin.

Qeveria shqiptare nuk e bën këtë, pasi ajo nuk ka asnjë plan, siç nuk ka pasur asnjë plan në 30-vitet e fundit. Ajo është kujtuar për këto projekte për interesa të kompanive private, maskuar pas interesit publik, dhe vitet e fundit maskuar me atë që duhet rëndom PPP.

Gjatë protestës së fundit, policia vendosi 10 milionë lekë gjobë për dy nga organizatorët, shumë krejt e paarsyeshme dhe krejtësisht e pabalancuar, në shkelje flagrante të të drejtave të njeriut. Dhe duket se kjo gjobë flet për planet e qeverisë për të rritur presionin, ndëshkimin dhe frikësimin e banorëve. Me këto metoda ia ka arritur të zbehi zërin e protestës për hidrocentrale të vegjël, por nuk është rruga e duhur për këtë rast. Sepse këto metoda do të kthehen në bumerang.

Gjatë katër muajve të ardhshëm, deri në zgjedhjet parlamentare të 25 prillit, Skavica do të jetë një objekt

Tu kërkosh dibranëve të pranojnë që me përmytjen dhe shpërnguljen e tyre shpëton Shkodra dhe Lezha, është diskriminuere, është një argument që e bën me faj qeverinë, por është edhe një arsye se pse irritohen banorët, të cilët edhe në ditë pandemie, dalin për të protestuar.

kryesor i debatit publik e politik. Partia Demokratike, më herët në pushtet, dhe Partia Socialiste aktualisht në qeverisje, i kanë mbështetur hapur projektet për Skavicën. Po ashtu, LSI gjatë vitit 2017, kur diskutohej mbi hidrocentralin e Katundit të Ri, ka dhënë mbështetje për Skavicën e madhe. Duket sikur të gjithë janë kundër popullit që banon në 34 fshatra e Luginës së Drinit, por nevoja për vota mund ta detyrojë ndonjëherë prej këtyre partive të ndryshojë qëndrimin, por asnjë marrëveshje nuk duhet nënshkruar me ta, pa u detajuar sjellja e aktorëve politikë pas zgjedhjeve.

Lajmet për nisjen e qarkullimit në rrugën e Arbrit në pranverën e vitit të ardhshëm kanë qenë të mirëpritura për banorët, por ato për ndërtimin e Skavicës e kanë ulur gëzimin. Sepse, për një popull që shpërngulet, aq më keq pa dëshirën e tyre, duke i shpërfillur, diskriminuar, gjobitur e sulmuar, rruga e re është që shpresonte t'i kthente, do ti ndihmojë për të ikur. Dhe ky nuk është lajm i mirë.

Banorët e Luginës së Drinit kanë nevojë të dinë se çdo të bëhet me të ardhmen e tyre. Qeveria duhet të jetë më transparente me ta. Ata e kanë dëshmuar historikisht se janë më shumë atdhetarë se shumë politikanë dhe qeveritarë në Tiranë. Ndaj, në këtë proces, nuk duhet të shihen si kundërshtarë të së ardhmes së Shqipërisë. Ata duhen përfshirë në këtë proces, dhe një referendum lokal duhet të ishte një nga vendimet e duhura. Sigurisht, pasi qeveria të kërkojë ndjesë publike dhe të falë gjobat shumëmilionëshe ndaj drejtuesve të shoqatës.

PROTESTË KUNDËR HEC SKAVICA

"Jo planeve të qeverisë për të mbytur shtëpitë dhe tokat tona"

(Vijon nga faqja 3)

Dalip Alia, njëri nga banorët e Fushë-Alies, tha se "këtu nuk kemi të bëjmë me shpronësim, ashtu sikur e interpretojnë disa pushtetarë. Këtu kemi të bëjmë me shpërngulje masive të popullit. Historia përsëritet dhe tani po përsëritet në një formë tjetër, jo me armë, jo me luftë, por me të drejtat demokratike, duke i dalë për zot vatanit ashtu sikur i dolën paraardhësit tanë për mbrojtjen nga serbët. Ne jemi duke protestuar për të mbrojtur të drejtat tona, dinjitetin tonë".

"Dibra edhe ne, nuk kemi troje dhe toka për të shitur apo për t'i falur kujt", - tha Aranit Skepi, ish-kryetar i komunës së Fushë-Çidhnës.

"Këto janë pronat tonat dhe bashkërisht do t'i mbrojmë, me



protesta të vazhdueshme, me beteja ligjore, duke filluar prej këtu edhe në Strasburg - tha Skepi. Sepse është një e drejtë universale e çdo individi ta mbrojë tokën dhe pronën e vet deri në pikën e fundit. Se kështu na e kanë lënë amanet brezat dhe ne do ua lamë pasardhësve tanë. Nuk ka qeveri dhe nuk ka individ apo

dikush tjetër që të vijë t'i grabisë dhe t'i marrë këto toka. Nuk janë për qëllimet tona dhe për të mirën e këtij vendi, por janë për të mirën e mafies, ato vijnë dhe i marrin tokat tona, ato vijnë dhe na pushtojnë. Ne jemi të bashkuar në protesta, jemi të bashkuar në betejat ligjore, sepse kemi të drejtë".

"Kjo tokë këtu ku jetoni, është blerë me napolona floriri dhe kurrësi nuk mund të shitet me kartmonedhë. Është e pafalshme dhe e patolerueshme që të bëhet Skavica. Gjyshërit tanë na kanë mësuar si mbrohet dhe si do e mbrojmë, por kemi dëshirë që ta mbrojmë me paqe, por ne dimë ta mbrojmë dhe ndryshe", tha Tofik Xhika, një banor i Fushë-Alies.

Protesta u zhvillua e qetë, por kjo nuk e ndaloi policinë që të shoqëronte në komisarjat dy drejtuesit e shoqatës, Ali Hoxha dhe Nazmi Drizi, të cilët u akuzuan më pas për grumbullime në kundërshtim me aktin normativ të qeverisë së datës 15 mars 2020, në lidhje me marrjen e masave administrative kundër infeksionit Covid-19.

DHURONI PËR SHOQATËN

Shoqata për Mbrojtjen e Pellgut të Drinit të Zi u bën thirrje banorëve dhe përkrahësve të çështjes së saj, që të ndihmojnë sadopak financiarisht shoqatën. Të ardhurat që do të mblidhen do të përdoren për të mbështetur shpenzimet që do të duhet të kryhen gjatë veprimtarisë së tyre.

Kontributin tuaj mund ta jepni në numrin e llogarisë **8604030886**, **Raiffeisen Bank**, e cila i përket shoqatës.

Kryetari Nazmi Drizi dhe sekretari Nazmi Skepi i falenderojnë paraprakisht të gjithë ata që do të ndihmojnë në këtë provës. Për shumë informacion, telefononi në nr.355 68 233 2447

Përmes petitionit kërkohet sigurimi i jetës për minatorët, garantimi i dëmshpërblimit të familjarëve në rast aksidentesh, pension për familjarët e viktimave, bursa studimi për fëmijët, rritja e pensioneve për punonjësit e nëntokës, ndryshimi i moshës së daljes në pension, garantimi i kujdesit shëndetësor të veçantë etj.

Minatorët kërkojnë statusin e harruar përmes petitionit

Një petition i Sindikatës së Minatorëve të Bashkuar të Bulqizës, i cili ka mbledhur rreth 3 mijë firma, i kërkon qeverisë të kujtohet për statusin e minatorëve - një dokument që do u garantonte mijëra punëtorëve të nëntokës me probleme shëndetësore, kushte bazike të përkujdesjes për vete dhe familjet.

Nga SAMI CURRI

Reit Çekiçi tregon se doli në pension në janar 2020 së bashku me 27 minatorë të tjerë, por pa u mbushur ende viti, tre prej shokëve të tij ndërruan jetë si pasojë e problemeve shëndetësore nga puna në minierë.

"Ne kur dolëm në pension na mbajtën edhe shpërblimin e vitit që kishim punu, prej 240 mijë lekë," kujton ai. "I gjithë qyteti duhet të ngrihet për të kërkuar statusin e minatorit, sepse është gjaku i këtyre njerëzve," shtoi Reiti.

Minierat janë një nga vendet më të rrezikshme të punës në Shqipëri dhe çdo vit ka aksidente të rënda me humbje jete.

Aksidenti më i fundit u regjistrua në fund të tetorit, kur dy minatorë dhe një inxhinier gjetën vdekjen në galerinë ku punonin, në Selisht të Dibrës. Në pesë vitet e fundit, 30 minatorë kanë humbur jetën në vendin e punës, kryesisht në zonën e Bulqizës dhe Martaneshit dhe me dhjetëra të tjerë janë plagosur.

Familjarët e viktimave përfitojnë dëmshpërblime minimale, kryesisht sipas vullnetit të kompanive ku janë punësuar dhe mbeten pa mbështetje – siç gjeti BIRN në një investigim të mëparshëm. Ndërkohë, shumë minatorë që ia dalin të mbërrijnë në moshën e pensionit, nuk mund ta gëzojnë atë, për shkak të gjendjes shëndetësore.

"Punonjësit e nëntokës më të zakonshme kanë sëmundjet pulmonare, me prekje të mushkërive," thotë Fatos Hoxha, mjek pneumolog në spitalin e Bulqizës.

"Paraqiten të disa formave, nga më të lehtat e deri më të rëndat, që është edhe fibroza pulmonare," shtoi ai.

Hoxha thotë se problemet shëndetësore të minatorëve janë kryesisht për shkak të profesionit dhe me moshën, ato bëhen kronike dhe më të rënda.

Statusi i minatorit, i premtuar disa herë nga kryeministri Edi Rama që nga viti 2009, do jepte trajtim preferencial nga shteti për minatorët që dalin në pension dhe familjet e tyre në rast aksidentesh në punë.

Por ai ka mbetur në letër prej vitesh, duke i lënë minatorët dhe familjet e tyre të pambrojtura nga aksidentet apo sëmundjet që shoqërojnë punën për vite me radhë nëntokë.



Firmosja e petitionit për statusin e minatorëve në qytetin e Bulqizës | Foto : Sami Curri

Në një përpjekje për të tërhequr vëmendjen dhe miratuar statusin, Sindikata e Minatorëve të Bashkuar të Bulqizës, ka nisur prej ditësh një petition, i cili është firmosur deri më tani nga 3500 minatorë dhe ish-minatorë.

STATUSI I MUNGUAR U KUSHTON SHUMË MINATORËVE

Sipas të dhënave nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore janë afro 14 600 persona që trajtohen me pension të nëntokës dhe afro 12,200 punonjës, kontribuues në skemën e pensioneve nga nëntoka. Por shumica e tyre nuk marrin ndihmën që u duhet dhe një pjesë, edhe pse kanë sakrifikuar dhe kanë dalë prej nëntokës me sëmundje kronike, u duhet të paguajnë nga xhepi për mjekimet.

Petrit Hoxha është një prej tyre. Ai i ka kushtuar 38 vite të jetës së tij punës në minierë.

Hoxha ka punuar para viteve '90, kur miniera kontrollohej nga shteti, por edhe pas vitit 2001 ku me qindra leje minerare u dhanë në zonat mineralmbajtëse të Bulqizës dhe Martaneshit.

Hoxha i tha BIRN se vuan nga veshkat, mëlçia e shumë probleme të tjera dhe vetëm në një muaj i duhen 67 mijë lekë [të vjetra] ilaçe.

"Ne jemi të konsumuar dhe kemi punuar në kushte shumë të vështira," theksoi ai. "Kishim martela "VUP" dhe gishtat i kam hala të shtrembur se m'i kapte marteli," shtoi Petriti.

Petriti merr një pension prej 26 mijë lekësh dhe është pesimist se një ditë do të marrë edhe statusin e minatorit, çka do t'i siguronte mbështetje më të madhe ekonomike dhe rimbursim të plotë të mjekimeve që duhet të marrë për shkak të sëmundjeve të shaktuara nga puna në galeri.

Organizatorët e petitionit thonë se statusi do u jepte një ndihmë minatorëve që vuajnë nga sëmundjet kronike, familjeve të minatorëve që humbin jetën pa dalë në pension dhe atyre që ndahen shpejt nga jeta për shkak të sëmundjeve profesionale. Statusi po ashtu do të mundësonte një trajtim mjekësor më të mirë për minatorët, diçka që ata thonë se nuk e kanë tani.

Minatori Agron Skuka është ndër të parët që ka firmosur petitionin është i revoltuar me vonesën dhe

premtimet e pambajtura. Në dorë, ai mban një tufë analiza mjekësore dhe thotë se po përballlet me probleme shëndetësore si pasojë e punës së rëndë në minierë, por në spitalin e Bulqizës nuk merr dot asnjë shërbim se nuk ka mjekë të specializuar dhe se ai nuk paguan dot për shërbim më të mirë në Tiranë.

"Qytet minatorësh dhe mos marrësh shërbimin bazë mjekësor për minatorin është krim," theksoi Skuka.

Paga prej afro 50 mijë lekësh që merr Agroni është burimi i vetëm i të ardhurave në familjen e tij dhe me kalimin e kohës, ajo bëhet e pamjaftueshme për shkak të problemeve shëndetësore.

"Unë një fëmijë e kam në shkollë të lartë për mjekësi," tregoi me krenari Agroni, por shtoi se vetë nuk kishte para për t'u vizituar dhe për të blerë ilaçet.

"Prandaj shpresoj shumë që statusi të miratohet, prandaj e firmosa edhe petitionin," theksoi ai.

PETICIONI DHE KËRKESAT

Firmosja e petitionit është shtrirë në disa qytete, në të cilat ka miniera dhe aktivitet minerar dhe do t'u drejtohet Kuvendit dhe qeverisë. Nisma e ndërmarrë nga SMBB liston një sërë përfitimesh që duhet të ketë kjo kategori, duke qenë se sipas sindikatës, kuadri ligjor në fuqi nuk u përgjigjet nevojave bazike të tyre.

Për kreun e SMBB, Elton Debreshi, ky petition është zëri i minatorëve të Bulqizës, me shpresën

që të dëgjohet nga institucionet.

"Ka 30 vite që statusi i minatorit përdoret në çdo fushatë elektorale," tha Debreshi.

Ai akuzoi sindikatën e tjera se për interesat e tyre dhe jo për hallet dhe problemet e minatorëve e kishin braktisur këtë çështje.

"Duke parë këto pakënaqësi të mëdha na lind e drejta që të nisim këtë petition, për të kërkuar miratimin e statusit të minatorit," shtoi Debreshi.

Petitioni kërkon miratimin e statusit për të garantuar sigurimin e jetës për minatorët dhe garantimin e dëmshpërblimit të familjarëve me 6 milionë lekë në rast aksidentesh me pasojë vdekjen në vendim e punës.

Gjithashtu sipas draftit, familjarët e viktimave duhet të marrin një pension të barabartë me 100% të pagës dhe bursa studimi universitare për fëmijët. Në draft-propozimin e sindikatës, dëmshpërblim kërkohet edhe në raste aksidentesh me pasojë pamundësinë për punë apo aksidente më të lehta.

Çështja e dytë lidhet me pagën e një minatori, që sipas propozimit nuk duhet të jetë më e ulët se 235% e pagës minimale zyrtare. Me pagën aktuale minimale, minatorët kërkojnë rreth 61 mijë lekë pagesë bazë, ndërsa kërkohet edhe pagesë për vështirësi në punë si dhe përfitim i pagës së 13-të.

Në petition kërkohet rritja e pensioneve për punonjësit e nëntokës në 35 mijë lekë. Gjithashtu, kërkohet ndryshimi i moshës së daljes në pension, duke e shkurtuar në 53 vjeç për ata që punojnë 11 vite apo më shumë nën tokë dhe për ata që kanë 10 vite punë, në 55 vjeç.

Po ashtu, petitioni trajton garantimin e kujdesit shëndetësor të veçantë, duke përfshirë barna 100% të rimbursueshme.

PREMTIMET E PAMBAJTURA

Në 1 Maj të vitit 2009, në Ditën Ndërkombëtare e Punëtorëve, kryeministri Edi Rama në atë kohë kryetar i opozitës, vizitoi Bulqizën dhe minatorët e kësaj zone dhe premtoi miratimin e statusit të minatorit.

"Ne do ta firmosim statusin e minatorit pas 28 qershorit si një akt koshience dhe njëkohësisht si një akt faljeje, që ne me atë firmë do t'ua kërkojmë të gjithë atyre që sot

nuk janë më," tha Rama, duke iu referuar zgjedhjeve parlamentare që do të mbaheshin një muaj më vonë.

Rama u zgjodh kryeministër 4 vjet më vonë dhe ka kaluar gati tetë vjet në pushtet, por statusi i minatorit është shumë larg miratimit.

Madje në tetor 2017, kur ish-deputeti i Lëvizjes Socialiste për Integrim në qarkun e Dibrës, Përparim Spahiu depozitoi në Kuvendin e Shqipërisë një draftligj për statusin e minatorit, shumica e rrëzoi atë me pretendimin se sillte efekte negative në skemën e pensioneve dhe buxhetin e shtetit, dhe shtoi se propozimi i bërë nuk ishte shoqëruar me kostot e detajuara financiare.

Ish-deputeti i qarkut të Dibrës nga radhët e Lëvizjes Socialiste për Integrim thotë se ky është një borxh që qeveria ua ka minatorëve dhe se llogaritë financiare nuk duhet të jenë pengesë.

"Përfitimet janë standarte si çdo status i miratuar për punë të veçanta e të vështira," tha Përparim Spahiu. "Dua të theksoj, me gjithë respektin, që asnjë profesion tjetër nuk e meritonte më parë se minatorët statusin," shtoi ai.

Vetë Rama iu rikthye premtimeve për statusin në 16 prill 2018. Në një komunikim me themeluesit e Sindikatës së Minatorëve "Janar 1991", lidhur me projektin e statusit, kryeministri u shpreh se ai do të miratohej brenda mandatit.

"Për këtë mandat kemi premtuar statusin, do ta bëjmë dhe këtë, por t'i bëjmë gjërat me këmbë në tokë," tha Rama.

Zyra e shtypit e kryeministrit dhe ajo e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, nuk iu përgjigjën kërkesës së BIRN për koment.

Megjithatë, edhe pse statusi nuk është miratuar, protestat e minatorëve kanë sjellë vazhdimisht përmirësime legjislacioni.

Në janar 2015, mosha e daljes në pension për minatorët u ul nga 60 vjeç në 55 vjeç. Kjo u shoqërua edhe me një rritje të pensioneve, por statusi u la mënjanë.

Shumë ish-minatorë nuk kanë më shpresa se do të përfitojnë. Petrit Hoxha, i cili flet e kollitet shpesh si pasojë e problemeve në mushkëri nga puna në minierë është pesimist.

"Puna jonë kaq ishte. Ne jemi sot e nuk jemi nesër. Por të paktën, këta që vijnë pas nesh mos kenë fatin tonë. Vuajtjet tona," thotë ai.

Ngjashëm me të, edhe Haxhi Llani, 70 vjeç, i cili ka punuar për afro 25 vite në minierën e Bulqizës thotë se megjithë premtimet gjatë fushatave elektorale, ai nuk shihet 'dritë në fund të tunelit'.

"Gjithë ajo punë që kemi bërë ne, me mijëra që kanë punuar në minierë, s'kemi fituar asgjë," tha Llani.

"Kemi fitu vetëm bukën me rrit fëmijët," shtoi ai.

Megjithatë, Llani shpreson që statusi të miratohet për të përfutur minatorët e rinj që punojnë ne galeri.

"Unë kam mbaru, jam sot e s'jam nesër, por ta japin statusin e minatorit për ata të rinj që janë sot në galeri," përfundoi ai.

Marrë nga www.reporter.al



Petitioni për statusin është firmosur deri më tani nga 3500 minatorë dhe ish-minatorë | Foto : Sami Curri

13 dhjetori si ditë e madhe mbarëdibrane

Nga ABDURAHIM ASHIKU

Njëzet e tetë vjet të shkuara, saktësisht më 13 dhjetor 1992, u hap zyrtarisht Pika Kufitare e Bllatës, u përqaftuan për të mos u shkëputur më kurrë burra e gra të moshuar që 45 vjet të shkuara ishin ndarë dhimbshëm, me lot në sy, me brengë në zemër, të rinj e të reja që nuk e kuptuan (dhe nuk e kuptojnë) pse në vitin e egër 1913 i ndanë për palce fuqitë e mëdha në Londër, pse 45 vjet i ndau ideologjia e mbjellë në një tokë shterpë që as e ujiste, as e prashiste, as e ushqente...

Më 13 dhjetor 1992 u thye kufiri shqiptaro-shqiptar...

Një precedent pak ndryshe nga thyerja e Murit të Berlinit...

I Dibrës, megjithatë mbeti. Mbeti si një litar i kalbur që nuk mban peshën e një varbeci...

Çdo vit në Gjermani, në ditën e rënies së Murit të Berlinit, bëhet festë e madhe edhe tej tri dekadave të ngjarjes.

Çdo vit...

Pse, asnjëherë, nga 13 dhjetori 1992, nuk është bërë asnjë festë popullore, nuk kanë vërsuar në të dy krahët dibranët për tu gëzuar e festuar?

Nuk e di por ngjarje më të madhe midis dibranëve të kësaj e asaj ane të kufirit shqiptaro-shqiptar... NUK KA.

Pse Këshilli Bashkiak i Bashkisë së Peshkopisë dhe Këshilli Komunal i Komunës së Dibrës së Madhe nuk janë mbledhur bashkërisht në Bllatë e të caktojnë 13 Dhjetorin ngjarje të madhe e FESTË POPULLORE?

E përsëris edhe njëherë:

NGJARJE MË TË MADHE SE KJO DIBRA NUK KA PASË...

E mbase nuk do të ketë...

Sigurisht, PO QE SE E HARROJMË ATË DITË...

Për të ardhë ajo ditë, 13 dhjetor 1992, u desh që një ditë të fillimit të erës së re të shkuleshin gardhet e të rrafshohej kloni, u desh një udhëtim prej më se 480 kilometrave (kur mund të udhëtoje vetëm 8 kilometra) i dy skuadrave me të njëjtin emër, me të njëjtin gjak, me të njëjtën gjuhë, skuadrave të "Korabit" të Peshkopisë dhe "Korabit" të Dibrës së Madhe, udhëtim që e kam ndjekë me reportazhe e skica dhe me fotografi.

U desh një udhëtim masiv në këmbë në Ditë Bajrami drejt Dibrës së Madhe dhe Dibrës së Vogël për tu gëzuar, për tu çmallur...

U desh pena e gazetarëve për ta bërë publike e për ta shpejtuar hapjen zyrtare të kufirit midis "Dy Dibrave", ndarë dhunshëm nga Londra 1913...

Personalisht, por edhe kolegët e mi Sami Selishta në Peshkopi, Nefail Spahiu, Ramadan Telqiu, Kujtime Kica në Dibër të Madhe dhe në Shkup, punuam me penë të fortë, me kamerë televizive dhe me mikrofon radiofonik, duke sensibilizuar qeverinë e Shkupit dhe Tiranës për të përshpejtuar rrugët e bashkimit, për të mbushur me zhavorr e beton përroin natyror të ndarjes, për ndërtimin e pikave përkatëse kufitare...

Dhe dita e kalimit zyrtar të njerëzve erdhi...

Erdhi me një protokoll zyrtar...

Erdhi me një vërshim popullor pa doganë, pa leje kalimi, thjesht si njëherë e një kohë kur nuk ishte vënë gurë kufiri, tela me gjemba e rrjeta elektrike.

Ishte një festë e madhe popullore...

Nga dhjetëra shkrime e fotografi (të mjaftueshëm për një libër) që kam bërë në kërkim të kësaj dite por përcjell, një...

"SHËNUAR NË BLLATË, MË 13 DHJETOR 1992"

Këto shënime, së bashku me shënimet e asaj dite ia përcolla, Kryetarit të Bashkisë së Dibrës, Dionis Ymer...

Më premtoi se do të bisedonte me homologun e tij në Dibër të Madhe.

Më kërkoi edhe mendimin tim se si mund të organizohej festa, FESTA E MADHE E BASHKIMIT TË DIBRËS...

Po përcjell emocionet e 13 dhjetorit 1992...

Po përcjell edhe një letër drejtuar kryetarit të bashkisë së Dibrës, Dionis Ymeri me dëshirën që një ditë të jem një meditues i thjeshtë në një festë që do të jetojë në shekuj.



MEDITIM '92

Shënuar në Bllatë, më 13 dhjetor 1992

Bllatë. E diele 13 dhjetor 1992...

Pas asaj nate me shi e borë e atij mëngjesi të ftohtë me mjegull, pason një ditë e bukur.

Një pamje e mrekullueshme fiksohet në retinën e syve të gëzuar, në objektivin e qelqtë të aparateve fotografikë e televizivë. Kërcini dhe dorë për dorë me të Malet e Dibrës, të Dibrës së Sipërme dhe të Dibrës së Poshtme, janë veshur në të bardhë.

Kronika zyrtare e 13 dhjetorit 1992 është kjo: Në orën 12 delegacioni shqiptar i përbërë nga Safet Zhulali, ministër i mbrojtjes, Mentor Bunguri, kryetar i keshillit të rrethit, Kadri Rrapi, kryetar i bashkisë së qytetit të Peshkopisë, deputetë, përfaqësues të partive politike etj., kalon Bllatën.

Para kompleksit doganor të sapondërtuar delegacioni pritet nga Beqir Zhuta, nënkryetar i qeverisë së Maqedonisë, Vllado Popovski, ministër i mbrojtjes Qemal Xhafa, kryetar i keshillit komunal të qytetit të Dibrës, deputetë, përfaqësues të partive politike etj.

Përsëritet Qemal Xhafa, kryetar i komunës së Dibrës. Në fillim në maqedonisht e pastaj në shqip.

Përsëritet Mentor Bunguri, kryetar i keshillit të rrethit të Dibrës.

Fjalimi i oratorëve në esencë është një: 13 dhjetori 1992, hapja e pikës së kalimit kufitar të Bllatës (bashkë me të edhe i dy pikave të tjera që hapen në të njëjtën ditë) është një ngjarje e shënuar, një ëndërr 45-vjeçare e realizuar.

Pritet shiriti i pëdurimit. Delegacionet vizitojnë kompleksin e ri doganor.

Shqiptarët e të dy krahëve të kufirit, pas marrëveshjes së palëve për takim masiv (për atë ditë) "pa rregulla doganore" shpërthejnë drejt njeri tjetrit.

Pleq e të moshuar, gra, të rinj e të reja, fëmijë takohen me njeri tjetrin me gëzimin e njerëzve të një gjaku në zemër, me lotin e përmallimit në sy. Drejt Maqellarës e Peshkopisë, drejt Dibrës së Madhe e fshatrave të saj, udhëtojnë njerëz me krahët e hedhur supeve të njeri tjetrit. Arteriet e vjetra të shqiptarëve zgjerohen e në to rrjedh gjaku i pastër i vëllezërve...

Jashtë kronikës zyrtare është e domosdoshme të shënojmë:

Vonë, në mbrëmje teksa nata kishte rënë, magjistrali i Bllatës ziente nga lëvizjet e ndërsjella...

Në shënimet e mija të 13 dhjetorit 1992 dua të përcjell kontributin e gazetarëve, luftën e tyre me penë, valë radioje e figurë televizive që kjo ditë të vinte sa më shpejt.

Nefail Spahiu, gazetar i "Flaka e Vëllazërimit" në numrin 4431 të 13 dhjetorit 1992 shënon: "Sot në Bllatë të Dibrës hapet kalimi i rregullt me Shqipërinë dhe vazhdon "Pas shumë kërkesave dhe negociatave më në fund 13 dhjetori i këtij viti do të shënojë datën kur Bllata merr statusin e vendkalimit të rregullt ndërkombëtar kufitar..."

E takoj Nefailin i cili thotë: "Maja a lapsit të gazetarëve e shpoi murin dibran. Tani duhet të punojë për ta shembur, për

ta shkukur..."

Ramadan Telqiu më kujton një moment nga kalimi i dibranëve të Dibrës së Madhe nëpër Bllatë në maj 1992: "Tek kalonim kufirin, thotë ai, emisioni shqip i Radio Shkupit përcillte një reportazh të "Zërit të popullit" për kalimin masiv të 15 prillit për Bajram të Madh. Zëri i spikerit Kujtime Kica i jepte reportazhit emocion të fortë. Për një moment ai ndërpritet dhe pak sekonda më vonë në efir përhapet zëri i Lutfi Turkeshit..."

"Kujtimja, tregon Lutfiu të nesërmen e asaj dite në Peshkopi, nga emocionet u bllokua. Ia mora nga dora gazetën dhe vijova leximin..."

Marr nga kujtesa (i kthehem edhe bllokut të shënimeve) diçka nga kujtesa në maj 1991, kur "Korabi" i Peshkopisë dhe "Korabi" i Dibrës së Madhe takohen në "kryeqytetin" e trevës së moçme, në Dibër.

Atëherë Lutfiu e Ramadanit për të përcjellë në radio informacionin, iu desh të ndiqnin linjën telefonike Peshkopi-Tiranë-Athinë-Beograd-Shkup...

Tani këto distanca janë shkurtuar. Nga Peshkopia mund të lidhesh e të bisedosh me linjë të drejtpërdrejt me Dibrën e Madhe nëpërmjet linjës Peshkopi-Maqellarë-Bllatë-Dibër në çdo kohë të ditës.

Midis dy Dibrave ka edhe një pengesë që duhet shembur: detyrimet doganore, taksa e kalimit të kufirit. Për xhepin e grisur të dibranit (të të dy anëve të kufirit) taksa e vënë është një pengesë në rrugën e afrimit të vëllait me vëllanë.

Më 14 dhjetor 1992 në mesditë, nga Peshkopia përcolla Nefail Spahiu. Nxitonte për ti dhënë "Flakës së vëllazërimit" reportazhin e vet me mbresa të dibranëve në të dy anët e kufirit arbitrar të viti 1913...

A.Ashiku



propozim

Dibra, e Madhja dhe e Vogla, në nevojën për bashkim

■ Një letër publike
dejtuar kryetarit të
bashkisë Dibër,
z. Dionis Ymeri

E kam jetuar vullshëm jetën në Dibër, ku lindi një ditë maji 1941, ku punova me përkushtim e dashuri, ku brodha nga Llanga në Draj Reç e Mërkurth të Lurës, ku derdha shpirtin tim në shkrime që do të desha ti mbledh një ditë bashkë në libra, ku fiksova në celuloid mijëra e mijëra pamje, njerëz e evenimente historike, ku më se dhjetëmijë prej negativëve kam arritur ti fusë në një arkiv vetjak. Dibra ku ika prej dhunës të forcave të egra që erdhën në pushtet, ka qenë edhe në këtë një çerek shekulli mërgim, në mendjen time, në shpirtin tim, në krijimtarinë time.

Po jo vetëm ajo, edhe "koka e ndarë" e saj, Dibra e Madhe, qendrën e së cilës e kanë pas në pronësi me troje të lashta paraardhësit e bashkëshortes sime, Sheh Hysen Kuçi, shoqërues i Amdyl Frashërit në Lidhjen Shqiptare të Prizrenit, dekoruar nga Presidiumi i Kuvendit Popullor me rastin e 100 vjetorit të saj, pushkatuar nga serbi më 22 shtator 1913 si pjesëmarrës dhe organizator i kryengritjes popullore dibrane...

Kërkimet në shtypin e kohës dhe në arkiva më afruan me Dibrën, ma bënë ëndërr të jetës sime për të shkruar një ditë...

Dhe shkova një ditë maji 1991, si gazetar shoqërues i skuadrës së futbollit "Korabi"...

Dhe shkova një "Ditë Bajrami" masivisht me mijëra dibranë...

Më pritën bashkë me bashkëshorten dhe fëmijët njerëz të një gjaku...


I prita me dashuri e respekt në kthimin e tyre masiv në Peshkopë...

Ajo që nuk do ta harroj kurrë është 13 dhjetori i vitit 1992, Dita e Bashkimit Shpirtërorë të dy Dibrave, vendosja e pikë kalimeve përkatëse kufitare.

Nga ajo ditë nuk ka dhe nuk do të ketë udhëtim "480 kilometra" por vetën "8 kilometra" për të shkruar e për të ardhë nga Peshkopia dhe Dibra e Madhe.

Ajo thënia popullore e "zierjes së jufkave në Peshkopë dhe ngrënia të nxehta me njerëz të gjakut në Dibër të Madhe," atë ditë u bë realitet.

Atë ditë e përcolla në shtyp



në një reportazh që më doli nga shpirti...

Më vjen keq që filmin ku fiksova fotografite e asaj ditë të shënuar nuk e gjej midis dhjetëmijë negativëve që kam skanuar. Mbase ka humbur përgjithnjë së bashku edhe me shumë negativë të tjerë.

Por ngushëllohem me mbi 100 fotografi që kam fiksuar në ndeshjet e "Dy Korabëve" në Peshkopë dhe në Dibër të Madhe.

13 DHJETORI 1992, SI NJË FESTË E PËRHERSHME POPULLORE MBARËDIBRANE

Për mendimin tim 13 dhjetori 1992 mund e duhet të shndërrohet në një FESTË E PËRHERSHME POPULLORE MBARËDIBRANE.

Mbase mund ta quajmë "BASHKIMI DIBRAN", nisur edhe nga një shoqatë dibrane me të njëjtin emër e vitit 1921, statuti i së cilës gjendet në bibliotekën e Peshkopisë.

Vendimi mendoj se duhet të dalë nga mbledhjet e këshillave bashkiake e komunale të Dibrës (Peshkopë) dhe Dibrës së Madhe (Maqedoni) mbase në një mbledhje të përbashkët pikërisht në pikë lidhjen e dy Dibrave.

Vendimi duhet të gjejë përkrahjen e pushtetit në Shqipëri dhe në Maqedoni për të qenë si detyrim e mbështetje zyrtare.

Vendimi duhet komunikuar në masmedia të të dy vendeve.

Në vijën e kalimit kufitar, pikërisht në lartësi të përroit që ndante dy Dibrat (e që u mbush me zhavorr

e tokë të virgjër, një gjë e bukur dhe domethënëse kjo) të vendoset një memorial i lartë që të simbolizojë atë ditë por edhe të flasë me gjuhën e bashkimit përfundimtar të dy Dibrave e të shqiptarëve nën Maqedoni.

Në ditën e caktuar të mblidhen mijëra banorë dibranë të të dy krahëve dhe të kalojnë lirshëm drejt Peshkopisë e Dibrës së Madhe, si një herë e një kohë, si atë ditë të 13 dhjetorit 1992.

Atë ditë të organizohet nga të dy anët "PANAIRI DIBRAN" me prodhime bujqësore, blegtorale, industriale, artizanale etj. dhe mallrat me pakicë të kalojnë në të dy krahët pa doganë.

Atë ditë grupet e përbashkëta kulturore të zhvillojnë veprimtari

të gjera kulturore e artistik, në kufi por edhe në pallatet përkatëse të kulturës në të dy qytetet.

Ajo ditë duhet të shoqërohet me një ekspozitë të arteve figurative e fotografike.

Atë ditë në Dibër ose në Peshkopë duhet të bëhet një ndeshje midis dy skuadrave futbolistike respektive.

Atë ditë dy skuadra alpinistësh duhet të ngjiten nga të dyja anët e maleve dhe të takohen në kufi ose në manastirin që ndodhet atje.

Unë do të përgatis një ekspozitë fotografike me pamje nga takimi futbolistik i "Dy Korabëve".

Po mu krijua hapësirë kërkimi mund të përgatis edhe një libër kushtuar bashkimit.

Atë ditë të ndahen çmime simbolike për persona që kanë kontribuar dhe kontribuojnë për zhvillimin e mëtejshëm të Dibrës mbarë.

Në Këshillanë e Dibrës së Madhe, në ditën e kryengritjes dibrane kundër serbit, më 22 shtator 1913 janë pushkatuar 5 vetë nga paria e Dibrës. Emrat e tyre janë përmendur nga gazeta "Përlindja e Shqipnias" ("Më parë se të vijin luftëtarët në Dibër, - shkruan gazeta "Përlindja e Shqipërisë" Nr.13 Vjeshtë e Parë -1913 ushtria serbe burgoi tetëdhjet veta nga parësia e vendit, me qëllim që t'i vrasin dhe të nesërmen. Kur u rradhuan për me i plumbos, i arritën Malësorët, andaj s'munden me i vra të gjithë, por veç pesë shpirt.

Këta janë ata që ranë dëshmorë për lirin e atdheut të vet, të cilëve historia meriton t'i shkruaj emnat e tyre për një kujtim të përjetshëm: Sheh Hyseni, Sadullah Strazimiri, Ramiz beu, Karafil beu, Numan Efendiu. U ndritë shpirti") dhe në shumë gazeta të kohës. Për nder të tyre të planifikohet ngritja e një memoriali ku të përjetohen betejat dibrane për mbrojtjen e territoreve shqiptare. Një shkollë apo institucion në Peshkopë apo Dibër të marrë emrat e tyre.

Këto janë mendimet e mija shkruar "me vrap". Shpresoj që ata të zgjerohen në procesin e vënies në jetë të nismës.

Koha e shkurtër, koronavirusi mbase për këtë vit nuk mund të bëhet një festë e madhe popullore.

Një festë me përmasa të mëdha duhet të organizohet në dhjetorin e vitit tjetër por hapat duhen nisur pa humbur kohë.

Abdurrahim Ashiku
23 shtator 2020

NJOFTIME

Njoftojmë lexuesit dhe të gjithë ata që kanë ndihmuar ose dëshirojnë të ndihmojnë me donacione, se e vetmja mënyrë që **KONTRIBUTET TUAJA TË NJIHEN** janë pagesat **PËRMES BANKËS**. Edhe në rastet kur kontributet tuaja janë CASH, kërkoni një faturë të firmosur dhe vulosur nga redaksia.

* * *

KËRKOHEN KORRESPONDENTË NË PESHKOPI DHE DIBËR TË MADHE. Të interesuarit për korrespondentë/menaxherë duhet të kenë pasion gazetarinë. Përbën avantazh përvoja në shtypin e shkruar ose në qoftë se kanë mbaruar studimet për gazetari dhe letërsi / marketing. Të jenë të angazhuar për punën në grup dhe të jenë të pavarur politikisht gjatë kohës që bashkëpunojnë me gazetën. Të interesuarit të komunikojnë me redaksinë.

* * *

Njoftojmë të gjithë bashkëpunëtorët dhe korrespondentët tanë se shkrimet duhet t'i sjellin në redaksi para datës 20 të muajit. Për çdo rast, komunikoni me redaksinë!

* * *

Për më shumë na ndiqni në Facebook në linkun: goo.gl/1bq2r6 ose në faqen tonë www.rrugaearberit.com

Objekt i këtij punimi janë rezultatet e vrojtimeve sipërfaqësore të kryera nga autori në disa nga fortifikimet e kësaj periudhe, topografikisht të lokalizuara në rajonin e Dibrës. Ai synon jo vetëm paraqitjen para opinionit shkencor të këtyre rezultateve, por edhe korrigjimin e ndonjë mendimi voluntarist që nuk i përgjigjet të vërtetës historike.

Të dhëna arkeologjike mbi disa fortifikime të periudhës së Skënderbeut në rajonin e Dibrës¹

Nga Adem BUNGURI
Instituti i Arkeologjisë
Akademia e Studimeve Albanologjike

Një aspekt i rëndësishëm i punës studimore për të hedhur më shumë dritë mbi epopenë skënderbejane, është vendosja e korrelacioneve adekuate midis burimeve historike dhe atyre arkeologjike. Kjo gjë kërkon kryerjen e kërkimeve arkeologjike në kalatë, fortifikimet apo strukturat e tjera, që kronologjikisht i referohen periudhës në shqyrtim. Edhe pse është fjala vetëm për një periudhë 25 vjeçare (1443-1468), pra kohësisht mjaft e kufizuar dhe në terma arkeologjik vështirë e identifikueshme, çelësi i zgjidhjes, është studimi më i thelluar i burimeve arkeologjike dhe gjeografisë historike, si dhe bashkëpunimi midis studiuesëve të arkeologjisë dhe atyre të historisë mesjetare. Ky bashkëpunim është i nevojshëm, veçanërisht kur bëhet fjalë për monumente arkeologjiko-historik, kronologjikisht të lidhura me periudhën e Skënderbeut dhe bëhet i domosdoshëm edhe për faktin, se në studimet historiografike është shfaqur edhe ndonjë pikëpamje subjektive dhe voluntariste, që buron si nga mungesa e këtij bashkëpunimi ashtu edhe nga njohja e pamjaftueshme e terrenit². Kërkimet arkeologjike mbi fortifikimet e Skënderbeut kanë qenë të kufizuara vetëm në disa kala të kësaj periudhe apo struktura brenda tyre. Në periudhën 1964-2018 gërmime arkeologjike janë kryer në qytetin e Stelushit (1964-1966)³, qytetin e Lissosit (1968-1970)⁴, në kalanë e Krujës (1977-1980)⁵, në kalanë e fshehtë të Skënderbeut në Daulë të Kurbinit (1983-1985)⁶, në kalanë e Matricës në Rubik (2016)⁷ dhe janë kryer punime pastrimi të sistemit fortifikues të kalasë së Petralbës (Gur i Bardhë) nga Institutit i Monumenteve të Kulturës.

Objekt i këtij punimi janë rezultatet e vrojtimeve sipërfaqësore të kryera nga autori në disa nga fortifikimet e kësaj periudhe, topografikisht të lokalizuara në rajonin e Dibrës. Ai synon jo vetëm paraqitjen para opinionit shkencor të këtyre rezultateve, por edhe korrigjimin e ndonjë mendimi voluntarist që nuk i përgjigjet të vërtetës historike. Që në fillim duhet të vemë në dukje konstatimin tonë mbi përputhjen e plotë të përshkrimeve të Barletit me topografinë e kalave të Skënderbeut në terren, aq sa shpesh mbetesh i mahnitur nga detajet dhe saktësia e tyre. Kalatë dhe strukturat fortifikuese që lidhen me periudhën e Skënderbeut në rajonin e Dibrës, janë: Kalaja e Koxhaxhikut (Zhupë-Dibër), Kështjella e Modricit (Dibër), Kalaja e Skudrinës (Rukë-Dibër), Kalaja e fshehtë e Skënderbeut në Çidhën të Poshtme, Qyteti i Stelushit (Qafë-Murrë) në kufirin midis Dibrës dhe Matit, Qyteza e Valikardhës (Bulqizë) dhe Kulla e Skënderbeut (Vajkal-Bulqizë). Sipas vlerësimit kronologjik ato ndahen në dy kategori:

a. Fortifikime më të hershme prehistorike, antike të vona dhe mesjetare, gjegjësisht të periudhës së Skënderbeut.

b. Fortifikime të lidhura ekskluzivisht me periudhën e Skënderbeut.

Në kategorinë e parë përfshihen: Kalaja e Koxhaxhikut, Kalaja e Skudrinës, qyteza e Valecardës, qyteti i Stelushit, ndërsa në kategorinë e dytë kështjella e Modricës, kalaja e fshehtë e Skënderbeut në Çidhën të Poshtme dhe kulla e Skënderbeut në Vajkal (fig. 1). Në këtë punim do të trajtohen shkurt disa prej monumenteve të mësipërm.

1. Kalaja e Koxhaxhikut (Dibër)⁸ (x-41°44', y-20°59', z-1160m).

Kalaja e Koxhaxhikut ndodhet në krahinën e Zhupës, midis Dibrës dhe Strugës, në krahun e djathtë të Drinit të Zi, në skajin lindor të Dibrës (Maqedonia e Veriut). Ajo është vendosur në një kreshtë shkëmbore me lartësi absolute 1160m dhe relative 360m, që ngrihet në luginën midis fshatrave Koxhaxhik në juglindje dhe Breshtan në veriperëndim, malit të Stogovës në lindje dhe përroit të Koçitës në veri. (fig. 2-3). Kalaja ka një pozicion të favorshëm strategjik në zotërim të rrugës Ohër-Dibër. Nga sipërfaqja e saj kontrollohet lehtësisht i gjithë krahun e djathtë i



Fig. 1. Hartë e disa fortifikimeve të periudhës së Skënderbeut.

Drinit të Zi, nga kodrat e Zhupës në jug deri në qytetin e Dibrës së Madhe në veri, nga kalonte rruga antike dhe ajo mesjetare Koxhaxhik-Dibër. Rruga e Drinit të Zi bashkon dy arteriet më të rëndësishme rrugore transballkanike të periudhës romake: vian Egnatia në jug (Ohër) dhe atë Lissus-Naissus në veri (Kukës). Duke qenë degëzimi verior i via Egnatias, rruga e Drinit të Zi përfaqëson një korridor mjaft strategjik për të gjitha periudhat prehistorike dhe historike.

Pozita topografike e kalasë së Koxhaxhikut përputhet plotësisht me përshkrimin e Barletit mbi qytetin e Sfetigradit, aq sa ngjan si fotokopje e tij. Ai e cilëson këtë qytet si „ vend fort i mbrojtur dhe gati i paafuëshëm”,⁹ dhe tregon se“...vendi atje ishte aq i pjerrët, sa s’të zinte këmba dhë gjëkund e s’kishe ku të mbaheshe, veçse me ndonjë litar të fortë”¹⁰, dhe se: “rreth murevet s’kishte veçse një rryp shumë të ngushtë që ishte shesh, kurse pjesa tjetër e malit, që vinte menjëherë, ishte fund e krye një rrëpirë e hatashme”¹¹. Ai shkruan se “Qyteti (i Sfetigradit) ishte malor e i ndërtuar në majë të një shkëmbi shumë të lartë, pa asnjë burim uji përbrenda, por edhe pa ndonjë lum afër për ta përdorur. Kishte



Fig. 2-3 Pamje jugore dhe veriore e kalasë së Koxhaxhikut

vetëm një pus brenda, të hapur e të ndërtuar në mes të qytetit, nga kujdesi i lashtë i popullit për dobi vetjake e të njerëzve dhe sidomos për nevojat e luftës... Roja e gjitha përbëhej nga ushtarë dibranë”¹². Sipas Barletit kështjella e Sfetigradit (Koxhaxhikut) ka pasur madhësinë e kështjellës së Stelushit si dhe një pozitë topografike krejt të ngjashme me të, gjë që është konfirmuar nga gërmimet arkeologjike¹³. Kalaja e Koxhaxhikut ruan gjurmë të banimit të saj gjatë periudhës së Bronzit të Vonë dhe Hekurit të Hershëm, periudhës së vonë antike dhe asaj mesjetare, si dhe pjesë të sistemit fortifikues të dy periudhave të fundit.

a. Periudha e Bronzit të Vonë dhe Hekurit të Hershëm (shek. XII-IX para Kr.)

Kësaj periudhe i takojnë disa fragmente enësh. Ata u gjetën në sipërfaqen e kalasë dhe në shpatet jugore të saj. Tre prej tyre janë punuar me brum të kuq argjilor, të përzier me kokriza rënore dhe guralecë të vegjël, me pjekje të njëtrajtshme

Trakti	Murri A	Murri B	Muri C Kulla	Murri D	Muri E	Murri F	Murri G	Shuma
Gjatësia	2.00m	3.50m	6.00m	2.10m	9.00m	6.00m	22m	50.60m
Lartësia	1.50m	1.20m	1.50	0.50m	3.00m	3.00m	0.40m	0.40-3.00m
Gjërësia	?	?	1.40m	?	1.70m	1.60m	?	1 . 4 0 - 1.70m

por jo të plotë, me faqe të lëmuar mesatarisht, dhe ngjyrë kafe në të kuqëremtë, ndërsa ndeshen dhe ato me brum kafe në bezhë. Përfaqësojnë tipin e enëve dyvegjake, me vegjë të ngritura mbi buzë (fig. 4, 1-2, fig.5,1-2), tip mjaft i përhapur në periudhën e Bronzit të Vonë dhe atë të tranzicionit Bronz-Hekur, si në territorin e Shqipërisë (Maliq Ildi¹⁴, Nezir VI (Mat)¹⁵, Gajtana III¹⁶, Zagorë II (Shkodër)¹⁷ e të Kosovës (Vlashnje, Hisar)¹⁸, ashtu edhe në atë të Pelagoonisë (grupi pelagonas)¹⁹ etj. Vetëm një prej pareteve ruan dekorin shiritor në trajtë brinjësh plastike, të zbukuruar me shtypje gishti dhe thellime bigle (fig. 4, 3, fig. 5, 5), teknikë dekorative kjo mjaft karakteristike për poqerinë e epokës së Bronzit në Shqipëri²⁰ dhe në një areal mjaft të gjërë ballkanik²¹. Megjithëse mjaft të pakta, ata e cilësojnë kalanë e Koxhaxhikut si një vendbanim kodrinor të periudhës së Bronzit të Vonë dhe fillimit të epokës së Hekurit. Vendbanime të tilla të vendosura në maja kodrash dhe të fortifikuara me mure prehistorike, përfaqësojnë një tip të zakonshëm të fortifikimeve të Bronzit të Vonë dhe Hekurit të Hershëm²², ku duhet të përfshihet edhe Koxhaxhiku, pavarësisht nga mungesa e fortifikimit prehistorik, që për shkak të mbrojtjes së fuqishme natyrore, duket se nuk ka qenë i nevojshëm.




Fig. 4-5. Fragmente enësh të Bronzit të Vonë (vizatime dhe foto)

b. Periudha e vonë antike (shek. V-VI pas Kr.). Kalaja ruan një sistem të thjeshtë fortifikues, që i përket periudhës së vonë antike dhe asaj mesjetare.

Ky fortifikim gjendet në pjesën më të lartë të kreshtës shkëmbore të kalasë dhe përbëhet nga muri rrethues, një kullë katrore dhe hyrja pranë saj. Kreshta e kalasë mbyllet me një platformë të sheshtë afërsisht poligonale, me kalime të buta në këndet, që brenda mureve ka përmasa 58x34m, perimetër 145m dhe sipërfaqe rreth 1600m². Kjo platformë e fortifikuar, e njohur si “citadela”, ka rrënjë plotësisht shkëmbore nga

jugperëndimi, perëndimi dhe veriperëndimi, ndërsa nga anët tjera pjerrësia e shpateve të saj është shumë e madhe dhe thuasje e pangjytshme.

Shtegu i vetëm që mundëson ngjitjen në kala, gjendet në anën verilindore të citadelës, prej ku realizohet komunikimi me varoshin dhe viset përreth. Linja e murrit të citadelës ndjek vijën kufizuese të kreshtës, përveç anës jugore, ku përfshin brenda sipërfaqes së mbrojtur dhe dy terraca të ngushta, të përshtatshme për banim. Muri shfrytëzon aftësitë mbrojtëse të terrenit, duke përfshirë brenda tij shkëmbinj të lartë natyrorë, kur ato gjenden në linjën e murrit, dhe ndërpritet aty ku ka rënie të rrëpita e të pangjytshme dhe s’ka nevojë për mbrojtje. Sot ruhen 7 trakte të mureve rrethuese, që i kemi emërtuar sipas germave të alfabetit: A, B, C, D, E, F dhe G, me gjatësi përkatësisht 2.00m, 3.50m, 6.00m, 2.10m, 9.00m, 6.00m dhe 22m dhe perimetër të lexueshëm 50.60m. Gjendja aktuale e tyre paraqitet sipas tabelës së mëposhtme:

Në kushtet e vërtetimit sipërfaqësor, është e vështirë veçimi tipologjik i murreve të periudhës së vonë antike prej atyre mesjetare, pasi murret e periudhës së parë janë mbuluar nga ato të mëvonshme, janë shembur ose dëmtuar. Megjithatë, duke u mbështetur në elementët më të sigurtë teknik, mendojmë se periudhës së vonë antike i përket muri i parë i jashtëm i traktit C, me gjatësi të përgjithshme 6m. Është fjala për murin e jashtëm të kullës së vetme të fortifikimit, në të cilin ruhen dy fasada muresh që veshin njera tjetrën, të lidhura përkatësisht me periudhën e vonë antike dhe atë mesjetare. Gjithashtu me këtë periudhë mund të lidhen edhe gjurmë të shkëputura të murrit jugor, të vendosura më në brendësi se sa muri mesjetar, por për të sqaruar këtë duhen kryer gërmime pastrimi. Muri është ndërtuar me gurë lumorë dhe të terrenit, të lidhur me llaç të bollshëm gëlqeror, sipas teknikës *opus incertum*. Llaçi është i një cilësie të mirë, i përzier me shumë rërë të imtë lumi dhe pak gëlqere paraprakisht të stazhionuar. Lartësia e ruajtjes së murrit lëviz nga 0.40-0.80m, ndërsa gjërësia e saktë, nuk mund të matet, pasi faqja e brendshme është e mbuluar nga dherat. Fortifikimi i periudhës së vonë antike, i konstatuar edhe nga studiuesë të tjerë²³, është aktualisht fortifikimi më i hershëm i kalasë së Koxhaxhikut. Megjithëse në ndonjë rast kjo kala është cilësuar edhe si “*aglomeracion urban i halshtatit ilir, i fortifikuar me blloqe gurësh kuadratik*”²⁴, nuk gjetëm gjurmë të fortifikimit të periudhave më të hershme ilire apo asaj urbane. Gjithashtu nuk gjetëm as fragmente enësh të periudhës së vonë antike.

c. Periudha mesjetare (shek. XIV-XV pas Kr.)

1. Sistemi fortifikues. Kalaja është rifortifikuar thuasje tërësisht në periudhën mesjetare, kur janë plotësuar pjesët e dëmtuara të mureve dhe janë rindërtuar trakte të reja të tyre. Ata në pjesën më të madhe të perimetrit mbivendosen mbi linjën e mureve të periudhës së vonë antike, plotësojnë pjesët e shembura të tyre, dhe në rastin më të mirë, i përforcojnë ato me këmisha të jashtme, siç ndodh në fasadën jugore të kullës së vetme të kalasë. Me këtë periudhë lidhen të gjitha traktet e ruajtura, A-G, me gjatësi 50.60 m, përfshirë këtu edhe murin e dytë të jashtëm të kullës të përmendur më lart. Murret janë ndërtuar sipas teknikës *opus incertum* me gurë lumor dhe të terrenit, të lidhur me llaç të bollshëm gëlqeror, të një cilësie të mirë. Llaçi përveç rërës së imtë të lumit përmban edhe shumë gëlqere të stazhionuar. Ai është përdorur me bollëk dhe përveç fugave me gjërësi 2-3cm, mbulon dhe një pjesë të faqes së jashtme të gurëve. (vijon në faqen 9)

(vijon nga faqja 8)

Gurët nuk krijojnë rreshta horizontale dhe nuk nivelohen me copa gurësh të thyer. Gurët e fasadës së jashtme shpesh kanë rënë në faqet e kreshtës dhe muri nuk ruhet i plotë.



Fig. 6a-b- trakte të murit jugor E

Lartësia e ruajtjes së murit lëviz nga 0.40 deri në 2.50- 3.00m, ndërsa trashësia e tij, e matur me vështërsi vetëm në tri pika është 1.40-1.70m. Duhet theksuar se trashësia e murit është e vështirë të matet saktë, pasi faqja e brendshme e tij është e veshur nga dherat e pjerrësisë së kodrës.



Fig. 7-8. trakte të murit jugor F dhe D

Një trashësi e përafërt e mureve rrethuese është ndeshur kala të tjera mesjetare të vendit tonë si në Krujë (0.80-1.50m), në Shurdhah (1.30-2.60m), në Daulë të Krujës (0.75 m, 0.90 m, 1.10m, dhe 1.80m)²⁵, në Stelush (1.50-1.80m) dhe po aq në Petralbë (Gur i Bardhë)²⁶ etj.

Kulla e vetme juglindore me përmasa 6.00x6.00m, duket qartë se është rifortifikuar në periudhën mesjetare, pasi muri i periudhës së vonë antike, vishet në këtë periudhë në anën e jashtme jugore nga një mur i dytë përforcues, me trashësi 1.40m.



Fig.9-10-Muri I dhe II i jashtëm i kullës-trakti C

Hyrja e kalasë duhet të jetë në anën e majtë të kësaj kulle, pasi aty kalon shtegu i vetëm që lidh kalanë me varoshin. Në faqen e jashtme të murit jugor, në segmentin E shihet një vrimë cilindrike me diametër 6cm dhe thellësi të lexueshme 1.00m, e cila i takon mbetjeve të skelerisë metalike të ndërtimit (fig. 11). Vrima të tilla skelash, me formë rethore dhe përmasa të njëjta (6x6cm), që e përshkojnë murin në të gjithë trashësinë e tij, janë ndeshur edhe disa në fortifikime të tjera mesjetare të Shqipërisë, si në qytetin e Stelushit²⁷, kalanë e Ndroqit etj. Seksioni i tyre i njëjtë në të gjithë trashësinë e murit, dëshmon se për ndërtimin e këtyre skelerive janë përdorur tuba hekuri, teknikë e futur në ndërtimin e kalave nga arkitektët bizantinë.



Fig. 11- pamje e vrimës së skelerisë së ndërtimit.



Fig. 12-trakt i murit të një godine brenda citadelës

Në pjesën e brendshme veriore të “citadelës” gjenden rrënojat e një godine, prej të cilës shihet vetëm një trakt muri me gjatësi 1.70m, dhe lartësi të faqes së jashtme 1.10m. Gjërësia nuk mund të matet saktë pasi faqja e brendshme është e mbuluar nga dherat, por nuk e kalon 1.00m. Teknika *opus mixtum* e ndërtimit të tij ndryshon nga ajo e murreve rrethuese. Në strukturën e tij, përveç gurëve, gjenden rrallë edhe tulla me

trashësi 4cm, të periudhës së vonë antike, të ripërdorura pa ndonjë regull, të lidhura me llaç gëlqeror me shumë gëlqere dhe pak rërë (fig. 12). Paraprakisht mund të supozohet se godina mund të lidhet me ndonjë objekt kult, ndoshta me kishën e Shën Mërisë²⁸, por kjo mbetet të konfirmohet ose jo nga gërmimet e ardhshme. Në anën jugore të kalasë, në pjesën më të ulët të saj dhe njëherësh më të mbrojtur nga erërat, gjenden gjurmë themelesh të godinash me gjërësi 0.60m, sa duket me karakter ushtarak.

Gjithashtu në gjysmën jugore të syprinës së saj gjenden pranë njeri tjetrit dy gurë të mëdhenj natyrorë, me sipërfaqe të sheshtë, që ruajnë në mesin e tyre nga një vrimë cilindrike me përmasa 0.30x0.30 x 0.20m dhe 0.20x0.16 x 0.15m, të përdorura si dybeqe për shtypjen e barutit²⁹ (fig. 14), identik me një gur të tillë të zbuluar së fundmi në Kullën e Skënderbeut në Vajkal (Bulqizë).




Fig.14- pamje e dybekut nr. 1 të kalasë.

Në pikëpamje kronologjike, besojmë se fortifikimi mesjetar i kalasë së Koxhaxhikut lidhet me periudhën e Skënderbeut dhe është i njëkohshëm me fortifikimet e kryera prej tij në Krujë, Petrelë, Guri i Bardhë (Petralbë) dhe Stelush³⁰. Me këtë periudhë përputhen teknika e ndërtimit të mureve rrethuese e përshkruar më lart, trashësia e vogël e tyre, mospërdorimi i tullave në përbërje të murreve, cilësitë teknike të llaçit, që shquhet për mbizotërim të gëlqeres në raport me rërën, përdorimi i skelerive prej tubash hekuri, si edhe shumica e materialit të imtë qeramik të gjetur në këtë kala. Në periudhën mesjetare kalaja mendohet të ketë qenë pajisur dhe me dy kalime të nëndeshme në trajtë tunelesh sekrete, element ky i pranishëm në mjaft fortifikime mesjetare.

2. Varoshi. Në anën verilindore të kalasë, pas një qafe të ngushtë, në një disnivel kuatash prej afro 20m, hapet një tarracë e gjërë me kushte mjaft të përshtatshme për banim, e njohur me emrin “varosh”. Është zbuluar për të parën herë nga autori i këtij punimi. Në këtë tarracë me sipërfaqe afro 0,7ha (diametri veri-jug-145m, diametri lindje-perëndim- 47m) shtrihej qyteti mesjetar, i lidhur organikisht me kalanë. Edhe varoshi ka një pozitë të shkëlqyer natyrore dhe mjaft strategjike. I mbrojtur nga perëndimi dhe veriu prej rrënjeve shkëmbore të fageve të tij, ai ka një pjerrësi të lehtë lindore. (fig. 13, 15a). Në varosh ruhen gjurmë të shumta banesash me formë katërkëndëshe, të orientuara nga lindja, zakonisht të mbështetura në shkëmbenj natyror. Në pjesën qëndrore më të dukshme të tij, shihen themelet e një godine katërkëndëshe me përmasa të jashtme 7.00 x4.50 m, të shënuara nga gurë të mëdhenj, me gjërësi 0.90m (fig. 15b).



Fig. 15a-Pamje e varoshit;

Ana lindore e varoshit kufizohet nga gjurmët e një muri të gjatë tarracimi, që ka shërbyer si trase edhe për rrugën e karrove që ngjitej në varosh, e cila është qartë e dukshme (fig. 16).

Trakte të kësaj rruge shihen edhe në lëndinën fushore në jug të kalasë, ndërkohë që bashkimi i



Fig. 15b- themele godinash në varosh



Fig.16- traseja e rrugës së varoshit

tyre nëpër shpatin e pjerrët të kodrës, në terren ende nuk është gjetur. Gjurmë të banesave apo të godinave të ndryshme, ruhen gjithashtu edhe në rrëzën jugore të kreshtës së kalasë, jashtë varoshit, aty ku fillon lëndina e madhe fushore prej disa hektarësh. Duket se ato janë vendosur atje në kohën e lulëzimit të qytetit, kur ai njohu rritjen më të madhe të tij. Sipas studiuesëve, qyteti ka qenë furnizuar me ujë të pishëm nga gurra “Kërmzesu”(turqisht-*uji i kuq*) e kodrës Byk-Duruk, vetëm 4km në lindje të kalasë³¹. Ujësjellësi përbëhej prej qyngjesh qeramike, fragmente të të cilave janë gjetur herë pas here nga banorët lokalë, por të paruajtura, për vlerësimin e tyre kronologjik. Furnizimi i kalave mesjetare me ujë nga burime të jashtme realizohej me tubacione qyngjesh qeramike, ndërsa ruajtja e tij me anë sterash të ndërtuara me kujdes brenda zonës ushtarake³².

REFERENCA

- 1 Kumtesë e mbajtur në konferencën shkencore kushtuar 550 vjetorit të vdekjes së Gjergj Kastrioti Skënderbeut, Tiranë 01-02. 11. 2018.
- 2 BIÇOKU 2002, 410-411; BIÇOKU 2003, 7-29; BIÇOKU 2005, 68; BIÇOKU 2006a 61-82; BIÇOKU 2006b, 79-82; BIÇOKU 2016, 89-121; 122-133; 163-168.
- 3 ANAMALI, 1967, 105-112.
- 4 PRENDI 1969, 241-247.
- 5 KOMATA 1982, 221-228.
- 6 SARAÇI 1987, 203-214.
- 7 HOXHA 2016,151-171.
- 8 Falenderoj miqtë dhe bashkëpunëtorët që më kanë shoqëruar në vizitat e realizuara në këtë kala sipas viteve: 1983: Prof. Selim Islami (Tiranë) dhe Naim Fetahu (Dibër); 2006: Moisi Murra (Peshkopi), Pëllumb Naipi (Tiranë), Hysen Prapadniku, Qeram Lleshi, Sazan Prapadniku dhe Bardhyl Skara (Dibër); 2007: Sazan Prapadniku, Bardhyl Skara dhe Atli Dema (Dibër).
- 9 BARLETI (1537) 1964, VI, 235.
- 10 Idem, V, 198.
- 11 Idem, VI, 237.
- 12 Idem, V, 220.
- 13 ANAMALI 1967,105-110.
- 14 PRENDI 1977-1978,13, tab. VIII, 2, IX, 5; PRENDI 1966, pl. XVII, 1, 6; PRENDI 1982, pl. IV, 9; PRENDI 1974, 107, tab. VIII, 1-5, IX, 3.
- 15 ANDREA 1990, 38, tab. XVI, 15-16.
- 16 JUBANI 1972, tab. X, 5.
- 17 ANDREA 1996, 31, tab. VII, 3.
- 18 BUNGURI-GASHI 2004, „AiA”,Tiranë, Prishtinë; BUNGURI-GASHI 2006,“AiA”, Tiranë, Prishtinë.
- 19 GARAŠANIN 1983b, 788, tab. CIX, 1-2.
- 20 PRENDI 1977-1978, 13.
- 21 GARAŠANIN 1983a, 463-470, fig. 33, II, 1, 4 dhe III, 1, 4.
- 22 ISLAMI- СЕКА 1965, 448-449.
- 23 МИКУЛЬНИЧ 1999, 404.
- 24 ВИТРАКОВА – ГРОЗДАНОВА 1966, 199.
- 25 SARAÇI 1987, 205; ADHAMI 1971, 87; SPAHIU - KOMATA 1974, 263.
- 26 Sipas vrojtimeve të autorit në kalanë e Stelushit dhe në atë të Petralbës.
- 27 Sipas vrojtimeve të autorit në murin e dytë rrethues të kalasë së Stelushit.
- 28 BARLETI 1537 (1964), IV, 192. “Perlati (Pjetër Perlati-komandant i Sfetigradit-AB) mori masat...pastaj, nga një portë e vogël, që e ka emrin “Dibrane”, i priti barbarët në qytet. U fut brenda vetëm purpurati (një nga këshilltarët e sulltan Muratit II-AB) bashkë me tre ushtarë dhe dy shërbëtorë, të cilët përmes sheshit të qytetit, i shpuri në faltoren e Shën Mërisë, ku, pasi thiri më pleqtë e qytetit, urdhëroi të bëhej mbledhja”.
- 29 LLESHI 2005, 205, fig. 8.
- 30 KARAISKAJ 2016, 155: “Fortifikimet në të cilat vuri dorë Skënderbeu, ishin në radhë të parë: Kruja, Petrela, Guri i Bardhë (Petralba), Stelushi e Sfetigradi”.
- 31 LLESHI 2005, 200; MURRA 2005, 134.
- 32 KOMATA 1982, 225-226, fig. 6-7; KARAISKAJ 1985, 59 vv, fig. 5.

Banorët e Maqellarës ndër vite kanë ngritur shqetësimin e tyre tek organet vendimmarrëse për ujin vaditës, por reagimi i tyre ka qenë heshtja dhe neglizhenca

aktualitet

Banorët e Maqellarës kërkojnë ujë për vaditje

Më shumë se 300 banorë të zonës së Maqellarës kanë nënshkruar një petition drejtuar bashkisë së Dibrës me kërkesën e tyre për përmirësimin e situatës së vaditjes së tokave bujqësore.

Më shumë se 300 banorë të zonës së Maqellarës kanë nënshkruar një petition drejtuar Bashkisë së Dibrës me kërkesën e tyre për përmirësimin e situatës së vaditjes së tokave bujqësore. Në këtë petition banorët kanë ngritur shqetësimin e kahershëm të tyre për mungesën e ujit vaditës, keqmenaxhimin e rezervuarëve dhe burimeve të tjera ujore, mungesën e ndërhyrjes së bashkisë për pastrimin dhe mirëmbajtjen e veprave ujitëse, dhe keqadministrimin e ujit vaditës.

Bujqit e 22 fshatrave të Maqellarës edhe këtë sezon veror u përballën me vështirësitë në vaditjen e tokës bujqësore, nga ku rendimenti u ul me të paktën 30% dhe cilësia e produktit nuk është në nivelin e kërkuar nga tregu, duke krijuar një ulje të kërkesës së tregut për produktet e tyre. Kjo situatë ka ndikuar që të ardhurat për familjet e fermerëve të jenë më të ulta se vitet e tjera nga bujqësia, të cilët këtë vit i kishin sytë nga prodhimi vendas pasi dhe të ardhurat nga emigrimi ishin të ulta për shkak të krizës së pandemisë 'Covid19'.

Banorët e Maqellarës ndër vite kanë ngritur shqetësimin e tyre tek organet vendimmarrëse për ujin vaditës, por reagimi i tyre ka qenë heshtja dhe neglizhenca duke u mjaftuar me premtime elektorale të pambajtura, fonde që nuk dihet ku shkojnë, dhe njerëz që marrin pagat pa ditur vendin e punës dhe nga bien liqenet e Maqellarës.

Përballë një situatë të tillë, Behar Dema së bashku me një grup nismëtarësh banorë të Maqellarës, ndërmorën një fushatë të gjerë advokimi që kërkesat e banorëve të mos jenë zë i humbur në "koshin e kërkesave" drejtuar bashkisë së Dibrës. Me fakte dhe të dhëna konkrete të mbledhura nga terreni dhe



"Jemi në të drejtën tonë" thotë Behari, pasi të gjitha kërkesat janë sipas kuadrit ligjor, sipas detyrave funksionale të Bashkisë, teknikisht të zgjidhura me efikasitet dhe të realizueshme, dhe me një ndikim të drejtpërdrejtë në të ardhurat e familjeve të fermerëve, atëherë përse mos përmbushen këto kërkesa? Arsya është shumë e thjeshtë, që punonjësit e Bashkisë Diber nuk punojnë dhe fondet shpërdorohen në projekte të mëdha me shumë donatorë apo për dieta e blerje të vogla që përdoren për të kënaqur nëpunësit e vegjël."

Petitioni i nënshkruar nga 300 banorët, është një dokument që i jep më shumë mbështetje Beharit dhe grupit nismëtarë për të rritur presionin tek autoritet vendore dhe drejtuesit e Bashkisë Diber, të cilët jo vetëm publikisht por edhe ligjërisht (sipas nenit 19 të ligjit

Bujqit e 22 fshatrave të Maqellarës edhe këtë sezon veror u përballën me vështirësitë në vaditjen e tokës bujqësore, nga ku rendimenti u ul me të paktën 30% dhe cilësia e produktit nuk është në nivelin e kërkuar nga tregu, duke krijuar një ulje të kërkesës për produktet e tyre.



Maqellarë, duke sjellë ndotje të ujit të pijshëm të dy fshatrave të tjerë kjo e nxjerrë dhe nga analizat e kryera nga Drejtoria e Higjienës Diber;

- Të garantojë me vendim të këshillit Bashkiak realizimin e pikave të mësipërme.

Për çdo institucion vendorë kërkesat e banorëve të Maqellarës do ishin të realizueshme, aq më pak për Bashkinë, që përveç fondeve nga qeveria qendrore, arkëton edhe fondet nga taksat vendore, duke e vënë edhe para një detyrim moral jo vetëm zyrtar.

Kërkesat e banorëve të Maqellarës janë shumë reale dhe të realizueshme, por ato duan dëshirën e mirë të bashkëpunimit të drejtuesve të Bashkisë Diber dhe angazhim të punonjësve të departamenteve dhe sektorëve që merren me bujqësinë dhe shërbimet që këto kërkesa të realizohen.

Nisma e banorëve të Maqellarës me mbështetjen nga opinioni publik, dhe media

Financuar nga LevizAlbania



sociale dhe lokale do të detyrojnë që dyert e zyrave të Bashkisë Diber mos jenë të mbyllura për qytetarët por të jenë vendi ku zgjidhen hallet e komunitetit dhe merren shërbimet më të mëdha publike.

Nisma "Liqenet funksionale ndihmë për Maqellarën" po kërkon që jo vetëm të angazhojë qytetarët në ngritjen e zërit të tyre për të kërkuar ujin vaditës, por edhe punonjësit e Bashkisë të dialogojnë dhe punojnë për zgjidhjen e shqetësimeve të banorëve të saj. Kjo është diçka e re që po ndodh në Bashkinë Diber, por një shembull i mirë se si banorët duhet të angazhohen që të kërkojnë të drejtat e tyre.

Ky petition është ndërmarrë në kuadër të nismë "Liqenet funksionale - ndihmë për Maqellarën", financuar nga LevizAlbania, një projekt i Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim, SDC.

Korresp. Rr.A.

Një projekt i Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim SDC



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim SDC



shembuj konkret nga fermerët, ato u rropatën dyerve të bashkisë duke bërë takime me përfaqësuesit më të lartë që punojnë në departamentin e bujqësisë, zyrat e financave, sektorin e vaditjes dhe anëtarë të këshillit bashkiak. Mungesa e dëshirës, neglizhenca, prepotenca, dhe paafërsia e stafit të bashkisë për të dhënë zgjidhje problemit nuk i demoralizuan grupin nismëtarë që të mos rreshtin së kërkuari të drejtën e tyre në mënyra të tjera. Mbështetja e gjerë që kërkesa e tyre ka gjetur te opinioni publik, që në mënyrë të vazhdueshme shprehen me postime dhe mesazhe në rrjetet sociale dhe median lokale, janë një shtysë që Behari dhe grupi nismëtarë ta vazhdojnë nismën e marrë deri në përmbushjen e saj.

139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore: "E drejta e kërkesës, ankesës dhe vërejtjes", janë të detyruar të kthejnë përgjigje kërkesave të banorëve të Maqellarës, të cilat përmbledhen në këtë petition, duke kërkuar Bashkisë Diber që të marrë këto masa ndërhyrje:

- Të marrë masa për rehabilitimin e rrjetit të kanalizimeve të ujërave vaditës,
- Të ndërhyjë sa më shpejt në pastrimin dhe vënien në efikasitet të të plotë të dy liqeneve në Maqellarë dhe Vojnik aktualisht jashtë funksioni;
- Të marrë masa për mos shkarkimin e ujërave të zeza në liqenin e Vojnikës pasi aty pranë është dhe objekti i shkollës fillore të tre fshatrave;
- Të ndërhyjë në mos përdorimin nga ana e fermerëve si ujë vaditës kanalet e zeza të fshatit

Dibra eksporton çdo vit rreth mbi 100 ton gjethe të tharë të kësaj bime, dy tre herë më shumë se Maqedonia. Kur profesori dhe gjithë komisioni panë dhe dëgjuan temën e përgatitur me shumë kujdes, krahas notës maksimale, i thanë që doktoratura ishte realizuar në mënyrë shumë dinjitoze.

Shkencëtari i bimëve mjekësore

Nga **OSMAN XHILI'**

Askush nuk do ta besonte se fëmija i dhjetë i një familje të varfër nga fshati Mustafë do të bëhej doktor shkencash dhe një shkencëtar i mirëfilltë i bimëve mjekësore. Zyberi i vogël, më shumë se uri për bukë e ushqime kishte uri për libra, dije e shkencë. Filloi ti ngjisë hapat e shkollimit, duke qenë gjithnjë në tabelat e më të mirëve. Atë vit që mbaroi tetëvjeçaren, në Zall Dardhë u hap shkolla e mesme bujqësore dhe Zyber Gjoni do të ishte një nga nxënësit e parë dhe maturantët e parë. Ai kishte dëshira të mëdha dhe pse mundësitë për t'i realizuar ishin tepër të vogla. Donte të bëhej mjek për të shëruar njerëzit, apo kimist për të realizuar ata reaksione kimike që të linin pa mend, si në laborator, ashtu dhe në botën e gjallë që e rrethonte.

Instituti i Lartë bujqësor i Korçës do të ishte stacioni i radhës për djalin e ardhur nga Dibra. Ishte larg gjërave që kishte ëndërruar. Nuk do të bëhej as doktor dhe as kimist, por kishte bindje absolute se do të hapej dhe një shteg i ri në jetën e tij. Shkolla e mesme që kishte mbaruar, kishte qenë disi larg parametrave të duhur, por shumë shpejt, studenti i ri i plotësoi boshllëqet dhe ishte në vallen e konkurrentëve. Të gjithë profesorët ishin korrektë, por rektori, që i jepte lëndën e mikrobiologjisë, ishte më kërkuesi. Në një nga kolokiumet, krahas notës dhjetë, kishte vënë dhe një shënim: "Ju lumtë! Ju përgëzoj! Keni punuar shumë mirë, Kështu vazhdoni dhe më tej!"

Zyber Gjoni nuk ishte nga ata studentë që kënaqen shumë shpejt. Vlerësimet e të tjerëve ishin shtysë dhe detyrim moral për të punuar më shumë akoma. Në provimin e fundvitit, në po të njëjtën lëndë me rektorin, Zyberi kishte shkruar gati dhjetëra faqe formati, a thua po punonte për një temë doktorature. Ishin këto përpjekje maksimale të Zyber Gjoni, që peshonte pak në kilogramë, por shumë në dije e mençuri, që e detyruan rektorin t'i propozonte për një vend pune si pedagog në universitet. Zyberi nuk pranoi. Ai e dashuronte vendlindjen, Dibrën, me të gjitha ndenjat e trupit. Asaj donte t'ia kushtonte rininë, kohën, energjinë dhe aftësinë krijuese.

KTHIM NË VENDLINDJE

Ndoshta do ta kishin dërguar në ndonjë nga kooperativat bujqësore të kohës, sikur dikush të mos kishte lënë një shënim shumë pozitiv në sivinë e tij. E kush mund të ishte ky dikushi, tjetër njeri, veç rektorit të dikurshëm, si një engjëll mbrojtës? Për dy tre për qind të studentëve më të mirë, apo siç quhen sot ekselencia, rektorët dërgonin emrat te drejtorja e komisionit të planit të shtetit në Tiranë. Falë këtij rekomandimi, Zyberi filloi punë në ndërmarrjen e grumbullimit të asaj kohe, specifikisht në sektorin e bimëve mjekësore, që kishin një peshë shumë të rëndësishme. Nuk kaloi vetëm se një vit dhe ai u bë nëndrejtor i kësaj ndërmarrje dhe qëndroi i tillë deri në shkrirjen e saj.

Çdo njeri tjetër në vendin e tij do të kishte privatizuar një pjesë të asetëve të ndërmarrjes dhe do të niste kësaj ortekun e pasurisë, për tu llogaritur tek vipat e Dibrës. Por kjo mënyrë veprimi e pasurimi nuk i shkonte për shtat Zyberit, kulturës dhe edukatës së tij familjare. Ata vërtetë kishin qenë të varfër, por të ndershëm. Kështu pra, tranzicioni e gjeti Zyber Gjoni pa asnjë



dyshtë në xhep, me një asistencë 25 mijë lekë të vjetra në muaj.

Një ditë, rreth 25 vite më parë, shkon në Tiranë dhe krejt rastësisht, takon një shok shkolle, që kishte ngritur një kompani të grumbullimit e përpunimit të bimëve mjekësore. Pasi pinë kafet dhe u çmallën, shoku e pyet Zyberin, se me se merrej dhe ku punonte. Zyberi ngre supet dhe i tregon për asistencën, që nuk i dilte as për nevojat minimale të familjes.

-Përse nuk del privat? – e pyeti shoku.

-Nuk kam para,- përgjigjet Zyberi, me sinqeritet.

Shoku i thotë se mund ta ndihmonte si fillim dhe Zyberi mund t'ia shlyente me kalimin e kohës. Ashtu u bë. Nuk vonoi shumë dhe Zyberi ngriti një kompani të vogël, që e emërtoi "Medi Plant Dibra 94" dhe kështu filloi historia e kësaj kompanie që po i ngjit hapat ngadalë, por mjaft të sigurt. Vetëm pak ditë pas krijimit të kompanisë, Zyberi shkon tek zyrat e përkrahjes sociale dhe u thotë atyre që ti hiqnin asistencën, pasi kishte filluar aktivitetin privat. Punonjësit e zyrës hapën sytë fort nga ajo që dëgjuan. Mund të ishte rasti i parë, që një njeri të kërkonte vullnetarisht shpëtimin e pagesës, kur shumë të tjerë e lakmonin, pa e merituar dhe pa pasur nevojë.

MIK I FERMEREVE TE DIBRES

Thamë që në fillim se një nga profesionet, që donte të bëhej Zyberi, ishte mjekësia. Donte të kuronte sëmundjet dhe plagët e trupit të njerëzve. Në fakt, ai arriti shumë më tepër se kaq, filloi të mjekojë plagët e shpirtit njerëzor. Filloi të luftonte varfërinë, duke shtuar sadopak buzëqeshje në fytyrat njerëzore. Ai e quan kompaninë e tij një sipërmarrje sociale, për të reduktuar varfërinë. Më tej Zyberi bën një krahasim të bukur, kur e quan atë si "postblloku" i parë për azilkërkuesit. Nuk janë pak, por mbi njëmijë familje që nxjerrin bukën e gojës, duke mbledhur bimë mjekësore dhe i shesin tek kompania që drejton Zyberi. Gra, fëmijë, pleq, grupime këto jo shumë të fuqishme, që përpiqen të ndihmojnë familjet e tyre, duke mbledhur, tharë e shitur bimë mjekësore. Ka fshatra të tërë, si Lura, Illica, Rabdishti, Popinara, Selishta, Lukani e ndonjë tjetër, ku të ardhurat nga

bimët mjekësore, përbëjnë zërin kryesor të fitimit në familjet e tyre.

Zyberi i sheh njerëzit që merren me grumbullimin e bimëve mjekësore, jo si çirakë, por si partnerë seriozë, që punojnë si një familje e vetme. Kjo e bën Zyberin të hedhë sytë tej në drejtim të projekteve, që u vijnë në ndihmë fermerëve. Para dy vitesh në Melan u implementua një projekt i kultivimit të mëllagës, që dhe pse filloi me vonësë dha rezultate të kënaqshme. U mbollën 8-9 dynmë me këtë kulturë dhe u mbledhën mbi 7 kuinalë mullagë, duke i shtuar arsenalit të bimëve mjekësore të kultivuara dhe një mundësi tjetër. Të ardhurat nga kultivimi i bimëve mjekësore e kalon dy deri në tre herë prodhimin e marrë nga misri, gruri jonxha e kultura të tjera të traditës.

Këtë vit po përpiqet të thithë projekte ndërku-fitare për kultivimin e bimëve mjekësore nga fermerët e interesuar. Çmimet që afron Zyberi për njësi të bimëve të grumbulluara, janë ndër më të mirat e tregut. Fermerët likuidohen menjëherë për mallin e sjellë. Ka pasur raste kur çmimi i produktit në treg është rritur, pasi është grumbulluar dhe Zyberi u ka dërguar njerëzve lekë shtesë, duke u shtuar gëzimin dhe respektin për të.

MIK I MADH I BIMËVE DHE NATYRËS.

Shfrytëzimi pa kritere i bimësisë dhe popullacioneve të saj, ka bërë që sipërfaqja ku rriten bimët mjekësore të zvogëlohet nga viti në vit dhe për pasojë dhe prodhimi që merret prej saj. Në këtë situatë Zyberi ngre alarmin për të shpëtuar florën dhe faunën, bimët dhe bimësinë. Të mendojmë pak dhe për brezat e ardhshëm, duke u lënë dhe atyre një trashëgimi të pasur. Ka plot raste, kur njerëz të paformuar presin blinin për t'ia vjelur më kollaj lulet, presin dëllinjën e zezë, për t'ia vjelur kokrrat më rehat, duke bërë që të shteren rezervat për vitin në vazhdim. Ka plot raste që shkolen rrënjët e agulicës, apo ndonjë bime tjetër. Këtyre praktikave të dëmshme duhet tu jepet fund njëherë e mirë.

Zyberi bën me fermerët vazhdimisht kurse e seminare trajnimi. Aty fermerët marrin njohuritë bazë si të bëjnë vjeljen e bimëve mjekësore, pa i dëmtuar ato, si t'i thajnë e t'i magazinonjë, për të rritur cilësinë e prodhimit dhe për të shtuar paratë në xhepat e tyre. Zyberi porositi vazhdimisht që korra e këtyre bimëve të mos bëhet rrafsh me tokën, apo kur vilen lulet dhe kokrrat të lihet deri në 30 për qind e tyre pa hequr, duke siguruar vazhdimësinë për vitin tjetër. Ndonjëherë Zyberi e bllokoi grumbullimin e rrënjëve të bimëve medicinale, kur kjo rezikon zhdukjen e tyre. Madje, ai propozon dhe një moratorium disave për grumbullimin e bimëve të rezikuara, siç mund të jenë rrushi i ariut, sanza (gentiana lutea), salepi, rrënjët e agulicës dhe ndonjë tjetër si këto.

Veç kësaj mase, rëndësi merr kultivimi i disa bimëve mjekësore, siç përmendëm rastin e mëllagës. Vitin e kaluar u sollën në Dibër me projektin e kompanisë "Agroherbal" 130 mijë rrënjë agulice falas dhe u shpërndanë tek fermerët e interesuar. Fare mirë mund të kultivohet dhe shtogu, që deri tani është trajtuar si një bimësi spontane. Në një seminar trajnues në Austri, Zyberi sheh blloqe me shtog të kultivuar. Vlera e lartë e lulesës

dhe kokrrave, si dhe shtimi i lehtë me copa e bëjnë bimën e shtogut shumë të lakmuar në tregun e bimëve mjekësore. Ajo mund të shërbejë dhe për të luftuar erozionin në toka jo produktive. Po kështu mund të mendohet shtimi i trandafilit të egër dhe plot bimë interesante si këto.

Zyberi po boton dhe një libër të ri, kushtuar bimëve mjekësore, më të kompletuar se ai që ka botuar më parë. Në të është derdhur gjithë përvoja dhe eksperiencia e tij e grumbulluar në dekada. Çdo njeri mund të gjejë aty diçka që i intereson, në mos për efekt të grumbullimit të këtyre bimëve, të paktën për ta përdorur si mjekim alternativ në jetën e përditshme.

DOKTORATURA

Kishte kohë, që Zyber Gjoni po mendonte të punojë për një temë doktorature e prapë ai nuk nxitohej. Në fakt, ai kishte mbi 40 vjet që punonte për një gjë të tillë, që atëherë kur jeta e tij u lidh në pakthim me bimët medicinale, aq të dashura e aq të dobishme. Drejtuesi i punës shkencore i propozoi një temë të lehtë, që Zyberi të mos lodhej shumë, por hasi në kundërshtimin e tij. Zyberi nuk ishte mësuar t'ia falnin gjërat, donte t'i fitonte me meritë, siç kishte bërë tërë jetën e tij.

Rrushi i ariut (Arctostaphylos uva ursi), ishte një bimë mjekësore, jo shumë e njohur, por mjaft e përhapur. Vlerat e shumta shëndetësore të kësaj bime e kishin ngacmuar shumë shkencëtarin e palodhur. I tha profesorit se doktoraturën dëshiron ta bënte pikërisht me studimin teorik e praktik të kësaj bime. Profesori e kundërshtoi fort.

-Mos i hyn kësaj pune, se do të dështosh! – i tha miqësisht. Më tej, si për ta bërë më konkrete arësyt, i tha se për këtë bimë vetëm dy tre rreshta janë të shkruara nëpër librat, ku trajtohen bimët



mjekësore. Në fund, kur pa vendosmërinë e Zyberit, u dorëzua. Eksperiencia e tij e gjatë e kishte mësuar se ku do ta kërkonte. Korabi, Rabdishti, Sllatina e ndonjë vend tjetër, do të ishin vendet ku do të ngrinte eksperimentet. Për ta bërë sa më të saktë, ai ngriti jo një eksperiment, por shtatë të tillë me të paktën 50 bimë secili. E hetoi bimën deri në detaje, për rrënjët, gjethet, kërcellin e kokrrat, kur lulëzonte, kur piquej, kur duheshin mbledhur gjethet e kur kokrrat dhe çdo të dhënë tjetër, që mund t'i interesonte. U bënë analiza biokimike për përqindjen e Arbutinës dhe përbërësve të tjerë. Natyrisht shfrytëzoi dhe literaturë, aq pak sa mund të ishte shkruar për këtë bimë. Bëri mjaft analiza në laboratorin e tij, apo në të tjerë, kur i tij nuk i kryente dot analizat. Rezultatet ishin tejet interesante. Rrushi i ariut ishte një dezinfektant natyror i shkëlqyer dhe pa efekte anësore. Gjethet e tij kishin veprim diuretik, tonik dhe adstringjent në fshikzën urinare dhe në veshka. Ekstraktet e kësaj bime gjenden në mbi 200 lloje produktesh mjekësore në Gjermani.

Dibra eksporton çdo vit rreth mbi 100 ton gjethe të tharë të kësaj bime, dy tre herë më shumë se Maqedonia. Kur profesori dhe gjithë komisioni panë dhe dëgjuan temën e përgatitur me shumë kujdes, krahas notës maksimale, i thanë që doktoratura ishte realizuar në mënyrë shumë dinjitoze.

Në të gjitha këto arritje Zyberi nuk është i vetëm. Ai ka ndihmën maksimale të bashkëshortes, që shquhet për marrëdhënie korrekte me gratë fermere. Djali i Zyberit punon mjaft mirë, krah babait dhe është certifikuar për bimët mjekësore organike. Vajza e tij është një studente e shkëlqyer e mjekësisë, duke realizuar kështu ëndrrën e hershme të babait të saj. Është kjo një familje model, një familje që rrezaton dritë, humanizëm, sinqeritet e vlera të larta njerëzore.



Kongresi i Dibrës i vitit 1909, moment vendimtar në historinë tonë kombëtare

Presidenti i Republikës Ilir Meta vizitoi më 22 nëntor Dibrën e Madhe, ku mori pjesë edhe në akademinë solemne kushtuar 111-vjetorit të “Kongresit të Dibrës”. Të pranishëm në këtë akademi ishin edhe kryetari i Parlamentit të Maqedonisë së Veriut, Talat Xhaferri, kryetari i BDI-së, Ali Ahmeti, ambasadori i Shqipërisë në Maqedoninë e Veriut, Fatos Reka, kryetari i Komunitetit Hekuran Duka, autoritete qendrore e vendore, klerikë, historianë e përfaqësues nga diaspora shqiptare.

Në kuadër të përkujtimit të kësaj ngjarjeje të rëndësishme historike, Presidenti Ilir Meta vlerësoi personalitete të shquara me kontribut të veçantë, të propozuara nga Komuna e Dibrës si dhe nga Shoqata “Bashkësia Dibrane”.

Me titullin “Kalorës i Urdhrit të Skënderbeut” Presidenti dekoroi Komunitetin e Dibrës së Madhe me motivacionin “Në shenjë vlerësimi për rolin dhe kontributin historik në organizimin e veprimtarive me rastin e 111-vjetorit të Kongresit të Dibrës. Njësi administrative që mban gjallë ndjenjën kombëtare dhe ruan lidhjet me bashkësinë tradicionale dibrane në Tiranë”.

Kreu i Shtetit shqiptar dekoroi me Titullin “Kalorës i Urdhrit të Flamurit” Teodor Jovan Dibranin (pas vdekjes) “Në vlerësim të kontributit të tij për çështjen kombëtare shqiptare. Udhëhoqi shqiptarët e Dibrës për përdorimin e gjuhës shqipe në shkollën e Nistovës së Rekës, si dhe në ceremonitë kishtarë.” dhe Tofik Jegenin (pas vdekjes) si “Figurë e dalluar e çështjes kombëtare. Luftoi me të gjitha energjitë dhe përpjekjet për liri dhe pavarësi. Pjesë e klubit patriotik ‘Bashkimi’. Delegat në ‘Kongresin e Dibrës’”.

Ndërsa me “Dekoratën e Artë të Shqiponjës” Presidenti Meta çmoi Selim Rusin (pas vdekjes) “Për kontributin e shquar në luftën për liri dhe pavarësi kombëtare. Veprimtar i shquar në zgjimin kombëtar shqiptar dhe pjesëmarrës në Kongresin e Dibrës. Për rolin e spikatur në përparimin e të drejtave të shqiptarëve në trevën e Dibrës” dhe Shefki Shatkun (pas vdekjes) “Në vlerësim të kontributit të shquar si luftëtar udhëheqës i trupave për liri dhe pavarësi. Pjesëmarrës në shumë veprimtari luftarake për mbrojtjen e atdheut; për kontributin e veçantë në krijimin, përf forcimin e artit të luftës dhe punime në fushën e saj”.

Gjithashtu Presidenti Meta nderoi me Titullin “Për Merita të Veçanta Civile” zotin Mexhit Capa “Për kontributin e palodhur, duke mbajtur gjallë veprimtarinë shkencore, kulturore dhe historike mes Dibrës së Madhe dhe bashkësisë tradicionale dibrane në Tiranë. I dalluar për shpirtin njerëzor dhe paraqitjen e vlerave atdhetare e patriotike”.

“Jam shumë i lumtur mes jush, në vendin e Kastriotit, aty ku jo vetëm lindi, por edhe ku zhvilloi shumicën e betejave të tij Heroi ynë Kombëtar Gjergj Kastrioti dhe i fitoi të gjitha - tha në fillim të fjalës së tij Presidenti i Republikës.

Kongresi i Dibrës i vitit 1909, përfaqëson një pikë kthese dhe një moment vendimtar të historisë sonë kombëtare. Edhe pse, mendimet dhe idetë ishin të ndryshme në Kongres, patriotët shqiptarë, që në fillim u treguan tepër aktivë për t’u paraprirë të gjithë të papriturave.

Platforma e përgjithshme që i bashkoi delegatët në këtë kongres, ishte bashkimi i forcave dhe qasja e pikave të programit të ‘Kongresit të Dibrës’, si një platformë tipike kombëtare.

Kancelaritë e huaja dhe rilindasit do të shkruanin në shtypin e kohës mbi fuqinë dhe fjalën e delegatëve në këtë kongres dhe qëndrimin e tyre emancipues me kërkesat që ata parashtruan.



Patrioti dhe rilindasi dibran, luftëtari i lirisë, Josif Bageri, në kryeartikullin e tij tek ‘Shqypja e Shqypnis’, e datës 1 gusht 1909, do të vlerësonte në pedestal se: ‘Ai kongres ishte i mbushur me ide kombëtare dhe përparimtare’.

Në këtë kohë klerikët si Vehbi Dibra dhe Hafiz Sherif Langu shquhen për aktivizimin e tyre si ndër pjesëtarët më në zë të klubit ‘Bashkimi’, që ishte hapur në Dibër të Madhe, në dhjetor të vitit 1908, po edhe kudo në çdo vatër Rilindase.

Pranë tyre dhjetëra anëtarë aktivë zhvillonin një aktivitet të gjerë në qytet dhe në krahinat për rreth, për të mbajtur gjallë në popull dashurinë për atdheun, dëshirën për të kënduar e për të shkruar shqip.

Bashkëvendimtar me idetë e tyre për të kaluar në një mbrojtje kombëtare me armë në dorë ishin patriotët Elez Isufi, Suf Xhelili, Dine Maqellara dhe shumë kapëdanë të tjerë.

Historiografia shqiptare për vetë rëndësinë dhe epërsinë e mendimit dhe dominimit të faktorit shqiptar në kongres, e ka quajtur këtë tubim mbarëkombëtar si ‘Kongresi Shqiptar i Dibrës’.

Në prill të 1909 patrioti i madh Kristo Luarasi i shkruante Asdrenit: ‘Sot mora një letër nga Dibra e më thanë se të gjithë janë bashkuar për çështjen shqiptare’.

Pra Dibra hyri kështu në fazën e kryengritjes së përgjithshme drejt pavarësisë së Shqipërisë.

Dibra është një trevë e bekuar jo vetëm nga natyra, por në veçanti me njerëzit e saj të ditur, të mençur, trima dhe atdhetarë të rrallë.

Dibra e madhe dhe Dibra e vogël, apo Dibra e Epërme dhe e Poshtme kanë qenë dhe janë një. Vendi i trimërisë, i besëlidhjes, i dokeve, zakoneve dhe urtësisë, i grykës së Radikës, i maleve të larta dhe i mençurisë, i fjalës dhe i pushkës, vendi ku dështoi çdo

luheshin intriga nga më të rrezikshmet, Ismail Strazimiri mes të tjerash do të shkruante:

Kurrë nuk durohet kjo robëri,
Dibra e Moisit asht Shqiptari!
Çohi burra, çohi, gjithë me besa-besë,
Për Dibrën luftoni me të madhen shpresë!
Familjet e mëdha patriotike i dhanë influencën e tyre jo vetëm Dibrës, por frymëzuan mbarë popullin shqiptar.

Sentenca e mirënjohur proverbiale që thotë se: ‘Mendja dhe urtësia ka le në Dibër’ dhe thënia e personalitetit të shquar të Luftës së Dytë Botërore, anglezit Xhulian Ameri, i cili gjatë Luftës së Dytë Botërore qëndroi në Shqipërinë e Veriut, ka thënë se: ‘në Dibër unë bëra universitetin e dytë, pasi të parin e bëra në Universitetin e Oksofordit’. Këto dhe shumë të tjera e bëjnë Dibrën, në sytë e studiuesve të huaj edhe më të gjallë dhe më autentike, sepse Dibra është jo vetëm një krahinë patriotike, por dhe një krahinë mjaft qytetare dhe përparimtare.

Është fakt se sot Dibra nuk e ka shkëlqimin e dikurshëm, por është në duart e dibranëve të shfrytëzojnë çdo rrethanë pozitive, që sjell bashkimi i vlerave dhe i aspiratave kombëtare, por dhe ndryshimet gjeostrategjike, për të gjetur rrugët dhe mjetet, që do të ngrënë Dibrën në çdo pikëpamje në nivelin e merituar.

Le të shtojmë forcat, edhe për përfundimin e ‘Rrugës së Arbrit’, në mënyrë që ta bëjmë Dibrën një qendër të rëndësishme të zhvillimit dhe të shtojmë mundësitë për një perspektivë më të begatë për të rinjtë dhe fëmijët e Dibrës! Mos harrojmë se me çfarë filloi ‘Kongresi i Dibrës’: me edukimin patriotik të fëmijëve!

Unë mendoj patriotizmi më i madh që ne sot mund dhe duhet të dëshmojmë është t’i edukojmë jo vetëm me këtë ndjenjë patriotike fëmijët tanë, por të bëjmë çdo gjë e ardhmja e tyre të jetë pikërisht, këtu në trojet e të parëve të tyre”.

Më shumë për vizitën e Presidentit të Republikës së Shqipërisë në qytetin e Dibrës së Madhe mund të lexoni këtu: <http://bashkesiadibrane.blogspot.com>



Presidenti i Republikës Ilir Meta vlerësoi me titullin “Kalorës i Urdhrit të Skënderbeut” Komunitetin e Dibrës së Madhe; me Titullin “Kalorës i Urdhrit të Flamurit” Teodor Jovan Dibranin (pas vdekjes) dhe Tofik Jegenin (pas vdekjes); me “Dekoratën e Artë të Shqiponjës” çmoi Selim Rusin (pas vdekjes) dhe Shefki Shatkun (pas vdekjes); me Titullin “Për Merita të Veçanta Civile” zotin Mexhit Capa

Ishte pikërisht kjo vetëdije kombëtare, që na thërret edhe sot!

Në pikat kryesore të kongresit, i jepej rëndësi e veçantë:

- 1- hapjes se shkollave fillore dhe të mesme me mësim në gjuhën amtare;
- 2- njohjen e zakoneve dhe gjuhës shqipe nga nëpunësit shqiptarë.
- 3- Rekrutimin e ushtarëve shqiptarë.

ekspeditë e ushtrive pushtuese dhe vendi që do të mbahet mend përgjithmonë në memorien e kombit shqiptar, për atë që i ka dhënë në çdo kohë dhe në çdo epokë kombit tonë, sepse gjithmonë kur ka pasur nevojë kombi ynë, shqiptarëve u kanë kënduar pushkët nëpër kulla.

Pikërisht kur fatet e atdheut ishin ‘në teh të thikës’ dhe në kuriz të popullit tonë po

printime dixhitale

me ngjyra dhe bardh e zi

shpejtësi | cilësi | çmime të favorshme


libra | broshura | revista | fletëpalosje

katalogë | kalendarë | postera | ftesa etj.


duke filluar nga 1 kopje e vetme

për informacion: mbbotime@gmail.com / Cel. 069 20 68 603

BOTIME TË REJA



Botimet M&B
ISBN: 978-9928-307-56-9
Nr. faqeve: 96
Çmimi: 600 lekë




Botimet M&B
ISBN: 978-9928-307-81-1
Nr. faqeve: 80
Çmimi: 500 lekë



Botimet M&B
ISBN: 978-9928-307-09-5
Nr. faqeve: 128
Çmimi: 800 lekë



Botimet M&B
ISBN: 978-9928-307-11-8
Nr. faqeve: 248
Çmimi: 700 lekë



Botimet M&B
ISBN: 978-9928-307-77-4
Nr. faqeve: 96
Çmimi: 500 lekë



Botimet M&B
ISBN: 978-9928-307-79-8
Nr. faqeve: 120
Çmimi: 500 lekë



www.rrugaearbërit.com

Na ndiqni **online**, falë ndihmës së z. Agim Deva, të cilin e falenderojmë për ndihmën dhe përkushtimin.

Informacioni për faqen online: info@rrugaearbërit.com

Informacioni për versionin e printuar:
rrugaearbërit@gmail.com

Përdor KONTAKT PAGE për pyetje dhe sygjërimë.

Shtyp butonin "**NDIHMO EDHE TI**" që gjendet në faqen e parë në versionin online për tu abonuar dhe kontribuar në botimin e gazetës, ose kontakto me redaksinë. Çdo kontribut bëhet publik.

Çdo lloje kontributi shkon në masën 100% në llogarinë e gazetës në Tiranë/Shqipëri në mënyrë të sigurtë përmes PayPal.

Website është një kontribut në shërbim të botimit të gazetës "Rruga e Arbërit", lobimit për ndërtimin e rrugës me të njëjtin emër, që do lidhë Tiranën me pjesën tjetër të Ballkanit në Lindje të Shqipërisë, si dhe zhvillimin e Dibrës dhe krahinave përreth.

Mund të na ndiqni edhe në Facebook duke kërkuar me emrin "Rruga e Arbërit" ose përmes lidhjes:

<https://tinyurl.com/lcc3e2f>

REKLAMO BIZNESIN TËND

Një faqe e plotë me ngjyra kushton 15000 lekë

Me 1000 lekë mund të rezervosh një reklamë gjatë gjithë vitit në format kartvizite (8x5cm)

NE jemi gazetë e lirë dhe e pavarur nga ndikimi politik. Pavarësia dhe liria jonë garantohe vetëm nga mbështetja e lexuesve...
BËJ PAJTIMIN TËND!

Një pajtim vjetor kushton: **600 lekë.**
Në Europë: **10 Euro.**
Në SHBA dhe vende të tjera: **15 USD.**
Pajtimi në Europë dhe SHBA është vetëm në versionin PDF.

Botimi i gazetës është punë vullnetare, ndaj çdo pajtim vjetor ose dhurim, është i mirëpritur. Dhurimet pranohen vetëm përmes llogarisë bankare që gjendet më poshtë dhe për çdo rast ai do të bëhet publik.
Raiffeisen Bank, Rr. Kavajës, Tiranë. Sëift code: SGSBALTX. IBAN(ALL): AL44 2021 1219 0000 0000 1003 6640

Bigmarket

PESHKOPI

DI ÇFARË ZGJEDH!

GJITHMONË ME OFERTA...

Shkëputur nga libri i Kamber Farukut:
“Kur po shkriheshin akujt”

shënime

Kur po shkriheshin akujt



Kryetari Astrit Kuka ishte djali i Ziqe Kukës, një njeri i nderuar në Peshkopi, punonjës gjithë jetën në spital. Ziqja kishte punuar kryeinfermier, por njerëzit e tjeshtë i thërrisnin: “Doktor Ziqja”. I sjellshëm, i qetë dhe i pangutur, tolerant, një ekonomist shumë i mirë, me Astritin merreshe vesh. Kishte mbetur Astriti në themel të vlerave të familjes. Po kështu, edhe sekretari Fitim Mata, me profesionin ingjnier, i cili mbulonte arsimin dhe kulturën, ishte njeri me kulturë dhe një sens të gjërë mirëkuptimi. Pavarësisht se vinim nga parti opozitare, ne këshilloheshim dhe përpiqeshim të ruanim barazpeshën drejtuese. Pa një stabilitet mes nesh nuk mund të kishte stabilitet social, ekonomik dhe politik poshtë në institucione dhe popull. Për fat të mirë, komiteti ynë pluralist i stabilitetit nuk ishte i përgarë e shamatosur që pastaj të mbetej vetëm dekor dhe në përmbajtje të ishte një shportë me grenëza.

-Atje në Luzni janë bërë lëmsh. A po shkon, se je edhe nga ato anë dhe ua din më mirë gjuhën? Vetëm se kjo është urgjente. Më mori në telefon kryetari i Luznisë, -më thotë Astriti.

Atë pasdite vonë, mora rrugën për Luzni, që kalonte nga Muhurri, anës Drinit. Në anën e djathtë ngriheshin brinja të hirëta, vende-vende mbuluar me dushqe deri në lartësinë e Mollës së Hoxhe. Më tej ishin disa brezare, që kishte çelur ndërmarrja pyjore duke shkukur dushqet. Brezaret kishin ngelur si vija alienësh, ishin kthyer në bokërrima. Sekush kishte nxjerrë idenë për të shpyllëzuar këto vise për t’i kthyer në kullota. As kullota, as pyll. Toka u ça dhe dheu ra në përrua e në Drin. Pikërisht këtu, para disa javësh, një makinë me ndihma humanitare mbushur me miell u grabit. Luznakët e katundeve të epëra i zunë rrugën, e shkarkuan dhe ikën lart me thasët e miellit mbi shpinë.

Gropë më gropë e kanaleve të rrugës të hapura nga shirat e përrrenjtë, mbërrij te lagja e parë e Katundit të Ri. Sapo kaloj shtëpitë e Pulicëve, te një shpat pranë përroit, shoh një numër të madh luznakësh burra, gra e fëmijë, si të ishte një panair. Po prishnin stallat e blegtorisë. Lopët i kishin rrëmbyer kush dy, kush një e kush asnjë. Kishin sistemuar anash tjerçullat. Vazhdonin të ulnin trarët e çative. Shoferi i ra borisë. Para nesh në xhade kishte zënë rrugën një grua, bashkë me vajzën e saj 12-13 vjeçare. Po tërhiqnin me mundim të madh një peshore hekurri nga ato të mëdhatë, që ishte përdorur te stallat për peshimin e koncentratit për ushqimin e lopëve. Dukeshin si dy milingona me një kokërr të madhe gruri, ngre e rrezou drejt folesë. Edhe ata po e çonin peshoren në shtëpi duke e tërhequr zvarrë, por tehet e hekurit nguleshin në tokë dhe stërmundoheshin. Atë hekur kishin mundur të kapnin në atë zallamahi bastisëse te stallat.

Mespërmes fshatit dolëm te një shesh, ku ishin zyrat administrative të Luznisë. Edhe aty ishin mbledhur mjaft njerëz. Kalova mes tyre dhe u futa në zyrën e këshillit popullor pluralist. Kryetari Rrem Colja më pa me indiferencë dhe sa lëviz i pak me përtesë kur i zgjata dorën. Ai ishte përfaqësues i PS dhe, me sa duket, pas alarmit që kishte dhënë, priste ndonjë tjetër nga rrethi, jo mua. Njerëzit, që ishin në zyrë, u përvitën disi, por asnjëri nuk doli jashtë. Ata i gjeta në një debat të nxehtë, por tani e ndërpre në sherrin dhe po prisnin. Panë dhe makinën jashtë dhe menduan se ky do jetë dikush. Pastaj e morën vesh se kush isha.

Sapo nisa të pyesja se çfar kishte ngjarë, një fshatar ia behu në derë:

-I vunë drynin dyqanit. E mshellën!
-Kush e mbylli?-e pyes.
-Pronari i tokës.

-Edhe mulliri nuk punon, e kanë mshelun, -më drejtohet njëri prej atyre, që ishin brenda në zyrën e Rrem.

-Po mullirin përse?
-Kan prerë vijën e ujit.
-Ç’patën me vijën e ujit?

-Vijën e ujit, zoti nënkryetar, e ndalën, sepse ai, që kishte mullirin i zuri rrugën atij, që vija e ujit kalonte nëpër tokën e tij. Dhe rrugën ia zuri ditën e dasmës.

Emëra nuk përmendi asnjëri.
-Po ju çfar bëni kështu, i keni hapur luftë njëritjetrit?-u drejtohem me vështrim pyetës.

-Bini policinë këtu, të futen në burg ngatër-restarët, merrni masa se jemi keq!

U mendova një copë herë. Luznakët i prisnin fjalën njeritjetrit, Rrem Colen nuk e dëgjonte njeri, as që e kishin në defter. Ndofta edhe fjalët e mia u hynin në njërin vesh dhe u dilnin në tjetrin. I kishte kapur inati me shoqishoqin. U duhej gjetur gjuha, përndryshe, çdo fjalë ishte e kotë.

-Dëgjoni këtu!-e ngrita pak zërin. Heshtën menjëherë. -Kam një propozim edhe unë. Dilni e prishni edhe çatitë dhe shtëpitë dhe pastaj hajdeni te Komiteti në Peshkopi, se do ju biem çadra e të dilni e të jetoni në zhurë të Drinit!

Dola, i hypa makinës, dhe u largova atë mbrëmje nga Katundi i Ri i molepsur në ngatër-resa të vjetëra. As të nesërmen, as javë më vonë, nuk morëm ndonjë lajm shqetësues nga Luznia. Ishin marrë vesh. Edhe dyqani ishte hapur, edhe mulliri punonte, edhe rruga ishte çelur. Me sa duket, kishin thirrë traditën shekullore të bashkëjetesës dhe ajo i kishte pajtuar e kthyer në rrugën e Zotit.

Kjo detyrë më njohu me shumë njerëz. Një ditë troket në zyrën time Osman Vladi. Dukej që në pamje dhe lëvizje se ishte një burrë i urtë, i qetë. Fliste ngadalë, sikur i peshonte fjalët. Më parë kishte qënë drejtor i shkollës 9-vjeçare.

-Jam kryetari i këshillit popullor të Arrëmollës, -e nisi bisedën. -Kemi një hall të madh, bagëtitë e kooperativës i kanë marrë barinjtë dhe do miq të tyre, populli, shumica, nuk kanë marrë asnjë bisht.

-Pse nuk krijuat një komision dhe t’i ndanit?
-E kemi krijuar, por nuk pyet kush komisionin, - më thotë Osmani.

-Çfar kërkon nga unë?

-Të vijë një komision nga rrethi, të ndërhyjë ndofta edhe policia dhe të zgjidhet kjo punë. Njerëzit janë shumë të acaruar, bagëtitë janë djersa e të gjithëve.

-Mirë zoti Osman, do ta shohim se çfar mund të bëjmë, -i them dhe Osmani largohet.

Unë as që u mora me atë gjë. Na binin njëqind lodra në kokë, le të merreshin vesh vetë me njeritjetrin. Por Osmani, edhe pse kishte lodhje të madhe ardhja nga Armolla, me orë të tëra më këmbë deri në Reç, erdhi përsëri. E përçolla duke i thënë afërsisht të njëjtat fjalë. Por ai erdhi sërish. Herën e tretë i drejtohem:

-A keni lista kur u krijua kooperativa në 1967-tën Osman?

-Jo, nuk kemi, as që bëhet fjalë! Çfarë listash?

-Po, ja, njeri ka futur në kooperativë njëqint berra, tjetri shtatë, njeri dy pendë qe, tjetri fare, njeri tridhjetë dynmë tokë, tjetri katër. . . Çdo gjë u zerua në atë kohë, u kalua në barazitizëm, quaje konfiskim. Apo jo?

-Ku don të dalësh, zoti nënkryetar?

-Osman, miku im, vërtet mendon se një ekonomi, që u krijua me padrejtësi, sot, pa asnjë letër të themelimit, do të shkatërrohet me drejtësi?

Osman Vladi më hodhi vështrimin e tij kuptimplotë. As ai nuk erdhi më për këtë punë, as unë nuk dëgjova se si vajti filli i ndarjes së bagëtive në Armollë.

Sinan Kadriu erdhi nga Dohoshishti, një fshat ngjitur me Peshkopinë. Dohoshishti ishte sektor i ndërmarrjes bujqësore.

-Sillen lloj-lloj hajdutësh e kopilësh rreth stallave të lopëve, janë tuj na i marrë lopët. Po bëjmë roje vetë, se NB-ja nuk merr frymë kërkund. Kanë mbetur lopët si mall pa zot, - më thotë. Sinani ishte një burrë zeshkan, rreth të 60-tave. Duhet thënë se lopët e Fermës, siç njihej popullorçë NB-ja, ishin lopë race, shumë të mira. Nuk ishin si lopët kockë e lëkurë të kooperativave.

-A ke ndonjë mendim zoti Sinan se çfar mund të bëjmë?

-Prandaj erdha, ta bisedojmë. Lopët janë edhe pa ushqim. Nuk ka kush merret me ta. Brigada e foragjereve nuk egziston. . . Nuk e di ç’të të them!

-Me ligj Ferma nuk është prishur, -i them.

-Por ligji nuk thotë që lopët të ngordhin për të ngrënë, apo të na i vjedhin. Kemi marrë jonxhë e kashtë nga shtëpitë tona, por kjo punë kështu nuk mund të shkojë gjatë. Unë, që kur u nisa për këtu, erdha me një mendim, -vazhdoi Sinani.

-Hëë!

-Unë them të krijojmë një komision si fshat dhe t’i shpërndajmë lopët nëpër familje. Po qe se Ferma ngrihet më këmbë, lopët aty janë.

-Kështu bëje. U thuaj se ke edhe miratimin tim.

Një të thënë e një të bërë, Sinani e kreu atë punë po atë ditë. Lopët u shpërndanë, stalla e Fermës u zbraz.

Të nesërmen vjen në zyrë sërish Sinani, që në mëngjes. E kishin raportuar dhe e kërkonte prokurori i rrethit për ta proceduar, sepse kishte cënuar pronën shtetërore. Marr në telefon krye-prokurorin dhe i shpjegoj çështjen.

-Po qe se duhet, ua sjell edhe me shkrim, -i them.

Lopët shpëtuan. Shumë pak ditë kaluan dhe Ferma mori rrokullimën në përrua. Tufat me lopë në Zall Sinjë dhe Kastriot u rrëmbyen natën dhe përfunduan pa nam e pa nishan. Kjo vinte sipas metodës: “Tërhiq e mos e këput”. Edhe thuhej se NB-ja nuk është prishur me ligj, edhe në fakt ajo nuk egzistonte, ishte fundosur në batak.

Kuvendi Popullor i Republikës së Shqipërisë në atë kohë, me vendim unanim të deputetëve të Partisë Socialiste dhe të Partisë Demokratike, mori vendimin më 17 korrik 1991 për ndarjen e tokës së kooperativave bujqësore për frymë, sipas Komisionit të Ndarjes së Tokave në çdo njësi. Ne, pasi e rrahëm si çështje njeri me tjetrin, si Komiteti Drejtues i degës vendore të PD në Dibër, ishim kundër këtij ligji. Qëndrimin dhe protestën tonë ia dërguam me një letër edhe kryesisë së PD në Tiranë. Reagimi gojor ishte se ju duhet të zbatoni ligjin. Ne ishim të prerë për moszbatimin e këtij ligji, secili fshatar apo qytetar do të merrte pronën e tij.

Atë pasdite na erdhi një ftesë nga Shyqyri Begu në fshatin Vakuf. Kishte për darkë Azem Hajdarin. Nëpër mbrëmje, një grup me Safet Zhulalin përpara, u gjendëm te oborri i Begut të Vakufit. Shyqyriut i kishte hija mikpritja. Me atë qelshen e bardhë, që nuk e hiqte asnjëherë nga koka dhe që i shkonte shumë, na heq përpara te oda e miqëve, ku ishte Azemi, i cili ishte ulur në një kolltuk tek. Dukej mjaft i lodhur, barku sikur i kishte kërcyer, ishte shëndosur. Ndofta nga pagjumësia, nga lodhja, nga gjumi i prishur apo shrrëgullimi i orarit të ngrënies. Azemi ishte djalë i ri dhe me energji të jashtëzakonshme. Lëvizja dhe prania e tij në atë kohë përbënte ngjarje, ishte në vëmendjen e të gjithëve.

Nisëm mes nesh një debat për tokën. Azemin sikur po e përkundnim dhe e vumë në gjumë. Me shumë zor i çilte sytë nganjëherë, pastaj i mbylleshin përsëri si me darë. Por erdhi një çast që Lideri i Dhjetorit e shkundi lodhjen, u drejtua dhe u ftillua.

-Dëgjoni këtu! Kush të dojë të rrijë me PD, kush të dojë të shkojë me parti të tjera! Ky është ligji dhe do zbatohet!-tha Azemi sikur të kishte qënë një dëgjues i vëmendshëm gjatë gjithë kohës kur rrinte me sytë mbyllur.

Nuk më erdhi mirë një shpërthim i tillë, sepse foli sikur PD-ja të ishte një ndërmarrje dhe ai drejtori. Por, të gjithë u hoqëm sikur ai nuk tha

asgjë. Ndofta ashtu i takonte të thoshte, ndofta e kishte bindje. U ndërrua biseda në gjëra të tjera më shlodhëse. Këtë dinte ta bënte aq mirë dhe me art i zoti i shtëpisë Shyqyri Begu.

Nuk mund të mbeteshe jashtë nga vorbullat, që krijoi ligji 7501. Kishte disa me pak tokë, që e kishin qejf këtë ligj. Por ata ishin tepër të pakët dhe po shuheshin dalëngadalë.

Shitoret në katet e para të pallateve të qytetit të Peshkopisë u privatizuan duke i marrë shitësit. Pronarët e tokës dyndeshin në zyrat tona duke kërkuar të drejtën e tyre si pronarë të tokës.

-Kur të dalë ligji, do të kompensoheni, -ishte përgjigja jonë. Mirëpo një ligj i tillë as që dukej në horizont.

Para meje paraqitet një fshatar nga Kovashica e Shupenzës, me mbiemërin Toçi. Lëvizte me duar e me këmbë, dukej mjaft i gajledisur. Hidhte fjalë e batuta për moszbatim ligji, sikur fliste me vete, por me zë të lart.

-Pse ke ardhur?-i them.

-Po ja, ju të PD-së nuk njihni ligjin. . .

-Shko e tako kryetarin, sepse është i PS-së, pse vjen tek unë?

-Vij te ju, se ju po pyeteni, se ata nuk po i njeh kush. . . -filloi Toçi duke folur shpejt e papushim. Ishte mjaft llafazan ose i gojës-të themi, por ky ishte tipi i tij, pak rëndësi kishte.

-Ulu, -i them, -sepse nuk mund të ndahet kanuni mbi kalë.

Toçi ulet.
-Si është puna?

-Tokën që më dha kooperativa poshtë shtëpisë ma ka bllokuar një shoq emi si pronari i tokës. Ligji ma dha mua, ai më ka vënë gardhin, vetëm duhet me u vra me të!

-Po shtëpinë?-e pyes.

-Shtëpinë dhe një rryp toke janë në tokën time para kolektivizimit.

-A ke tokë tënden nga babai, që e ke pasur pronë dikur?

-Kam, por ajo është poshtë, te kthesa e rrugës, atje ku është një mulli, afër Okshatinës. Atë tokë le ta marrë kush të dojë, e kam larg. Unë e dua tokën rreth shtëpisë, që ma ka pas dhanë koprativa, por edhe sipa ligjit sot.

-Me që erdhe para meje, unë të këshilloj të shkosh e të marrësh tokën që të ka lënë babai. Secili të marrë pronën e vetë, - i them.

Toçi u hodh më këmbë:
-Kështu thua ti?!

-Kështu them.

-Ke ardhur në këtë karrige për të mos zbatuar ligjet e shtetit?

-Këtë ligjin për të marrë pronën e tjetrit, nuk e zbatoj!-i them.

Toçi iku pa u përshëndetur, duke përplasur derën.

Pas dy javësh, Astriti, kryetari, më pyet te zyra e tij. Unë po qëndroja më këmbë, nuk më kujtohet se për çfar po këshilloheshim.

-A ishte një fshatar nga Shupenza një ditë tek zyra jote?

-Nuk më kujtohet. . .

-Njëri, që kishte biseduar për ligjin e tokës. . .

-Po, . . . më duket ishte nga Kovashica.

-I ka bërë letër kryeministrit Ylli Bufi dhe ai e ka kthyer me një shënim.

-Hahaha! Çfar thotë?

Astriti tërhoqi përgjysëm sytarin e tavolinës para vetes dhe shletoi letrën, pa e nxjerrë jashtë.

-Ai ka thënë. . . ti i ke thënë. . . Ai ka thënë.

Ti i je përgjigjur. . . -vazhdoi Astriti të lexonte ankesën e tij te Kryeministri.

-Ky Toçi e paska një të mirë. -i them. -Të gjitha sa shkruan janë të vërteta. Ta shoh letrën?

-Lëre, lëre, -tha Astriti, -nuk ke çfar i sheh.

E kuptova se nuk donte të shihnja shënimin e Kryeministrit.

Te dera e Komitetit jashtë ishin një grup fshatarësh.

-Duan takim me zëvendëskryetarin, -më tha nëpunësi i rojes- janë nga Maqellara.

Dola dhe i takova dhe, bashkë me ta, u ngjitëm në zyrë.


-Ne jemi komisione të ndarjes së tokave mes fshatrave Pocest e Katund i Vogël, -mu paraqitën.

Kur po shkriheshin akujt / Kamber Faruku

Shënime për njerëz e ngjarje

Botimet Dita Print

ISBN: 978-9928-229-74-8 / Faqe: 296 / Çmimi: 1000 lekë



-Po e ndani tokën?-i pyes.
-Po e ndajmë, sekush në tokën e vetë.
-Pse paskeni ardhur atëhere?
-Na ka hasur sharra në gozhdë me ndarjen e tokës mes dy fshatrave. Këta të Katundit të Vogël e duan ndarjen për përroi, sepse aty ndahet sektori i koprativs, -thotë një i Pocestit.
-Si ka qënë ndarja e vjetër, para koperativës?-i pyes.
-Nuk ka qënë për përroi.
- Do ta bëni ndarjen atje ku ka qënë kufiri i vjetër mes fshatrave, ky është mendimi im-u them.

Pa asnjë debat të mëtejshëm, për pesë minuta, gjithshka mbaroi. Fshatarët dolën krahas njeritjetrit duke qeshur, pinë një kafe bashkë në qytet dhe shkuan në Maqellarë e mbaruan punë qetë-qetë. Vijat e ndarjes i kishin të gatshme në kujtesën e brezave.

Salla e kinemasë u mbush me mbi dyqint agronomë nga koperativat bujqësore, që nga Golloborda, Fushë Bulqiza e deri në Kala të Dodës e Reç. U zhvillua një takim udhëzues për ndarjen e tokës sipas ligjit 7501, si do të inventarizoheshin pemët e NB-së dhe të kalonin në përkujdesje të fshatarëve, por do të mbe-teshin pronë e NB. Kishte ardhur nga Ministria e Bujqësisë zëvendësministri Koço Kote me një ekip specialistësh.

Kur mbylla tubimin, u thashë të pranishmëve në sallë:
-Tani porositë i dëgjuat, ruani raportet e vjetëra me pronën.

Një mërmërimë i pushtoi të gjithë si një erë që tund lisin, agronomët sikur u shkundën. Toka po ndahej sipas kufinjëve të vjetër dhe jo për frymë duke përzier pronat e njeritjetrit sipas ligjit 7501. Këtë diskutim e kisha bërë edhe me zotin Koço, por ai e kishte bërë rrugën nga Tirana hypur në kalin e ligjit 7501. Koço Kote ishte zëvendisministër i PD-së.

-Bëjmë ndonjë vizitë në ndonjë fshat, takojmë ndonjë koperativist, njihesh me mendimet e tyre. . . edhe dalin njëherë nëpër Dibër, -i them zëvendësministrit.

Nisemi për Muhurr. Ishte një ditë e vranët shtatori, shiu kishte pushuar. Në qendër të Muhurrit kalojmë një urë teli mbi lumin Murrë dhe zbresim te parku me plepa kanadezë. Nuk gjetëm lokal hapur dhe po rrinim më këmbë duke kundruar plepat gjigandë dhe ujërat e turbullta e të bollshme të Drinit e Murrës, që bashkoheshin më poshtë. Pas pak vërejmë dy fshatarë, që po vinin drejt nesh në një udhë të hollë. Aty i sillte rruga, sepse do të kapërcenin në urën e telit. Ishin të moshuar, por të mbajtur. Plaku përpara u shmangej pellgjeve të shiut nëpër plepa. Mbante shkopin në dorën e djathtë, të cilit i mëshonte fort. Në dorën e majtë kishte futur mes gishtave një llullë, që e thithte herë pas here duke nxjerrë shtëllunga tymi. Fliste me zë të lart duke u ndalur e kthyer nga tjetri, i cili kishte një qeleshe të bardhë në kokë. I njoha, ishin Bajram Prençi dhe Isni Hoxha, banorë të lagjes matanë Murrës, Lagja Hoxhe.

U përshëndetëm me ta.

-Ky zotëria është zëvendësministri i bujqësisë Koço Kote, kishte qejf të shihte Dibrën dhe unë e solla në Muhurr, -u them.

-Qoftë shëndoshë!Mirë shumë paska ba!-foli me zë të lartë Bajrami, si të fliste para ushtarëve. Kjo ishte natyra e tij, kishte një zë të lart kumbues dhe fliste me ton.

-Ky zotëria don me ju pyet se si po shkon puna e ndarjes së tokës për frymë sipas ligjit, që ka nxjerrë qeveria, -vazhdova shpjegimin tim.

-Si asht ajo për frymë?

-Po ja, të ndahet toka barabartë dhe ta marrësh pjesën tënde aty ku të të bjerë. . .

-Si ku të më bjerë????!!!!

-Atë e cakton komisioni.

-Si e kishte emërin ky zotnaja?-më pyet Bajrami.

-Koço Kote.

-Nigjo, or Koçe!Unë këtu në këtë lagje kam tokë më pak se të gjithë. Dua vetëm tokën teme, asnjë metër më shumë. Të vijë kush e të futet në tokën teme, -tha Bajram Prençi me zë të lartë, që dëgjohej deri matanë te rruga përtej lumit, duke vënë gishtin tregues te tëmbthi anash kresë -duhet të më biesh me një plumb këtu e t’ më dalë këtu dhe. . . të jetë plumb Dum-Dum!E more vesh?Shko, or Koçe, dhe ua thuaj edhe atyre na!t

-Zoti Koço, - ndërhyra me takt, -prandaj ju pyet.

-Edhe unë iu përgjigja. Shnet!-tha Bajram Prençi dhe, bashkë me Isni Hoxhën, u largua duke e ngulur shkopin më fort në tokë e duke thithur llullën më shpesh.

Kur po ngjiteshim kthesave të kodrinave të buta për në Peshkopi, mu kujtua një episod nga krijimi i koperativës në Maqellare. Ngjarja përkon pothuaj në simetri me ndodhitë për prishjen e koperativës tani pas tridhjetë e pesë vjetësh në Muhurr. . . .

Në një mbledhje të popullit, nga ata të nxehtat për futjen në kooperativë, ku bënte hije dajaku, operativi i sigurimit me emrin Hajro, i drejtohet me tërsëllimë fshatarit Habe Kërkuti:

-Do të futesh se s’bën në kooperativë, nuk ke nga ia mban, të cilësojmë kulak, ngule në tru, ore Zhabe!

-Bëni çfar të doni, nuk hi në koprativë, merre vesh, or Hale!-iu përgjigj Habe Kërkuti.

Ishte mezi i vjeshtës. Shira, mbledhje, sherre, tym, pasiguri, kërcënime, thasë të zbrazur në krahë, thirrje, protesta, letra që i mernte era.

-Ka një mbledhje në Qeveri. Jam pa qejf, me grip, po marr antibiotikë. Jam ftohur më duket, a po shkon ti?-më tha kryetari Astrit Kuka.

Me një “Fiat” të kryetarëve që nga koha e komunizmit, mora rrugën për Tiranë. Në timon ishte Xhaja, siç njihej nga të gjithë. I kujdesshëm dhe fjalëpak, Fadil Melani e kishte këtë sjellje që nga ajo kohë kur duhej të mbyllje gojën. Udhëtohej këndshëm me Fadilin, ishte njeri i humorit dhe miratues e i papeçatur. Kishte qejf fërnetin dhe vetë thoshte se, pa një dopio fërnët, nuk e shoh mirë rrugën.

U futa në ndërtesën e Kryeminstrisë për herë të parë në jetën time. Pas disa kontrolleve, koridoreve, kthesave e labirinteve, hyra në sallën e mbledhjeve. Zura vend nga bishti i një tavoline stërmadhe në formë të shkronjës U, e cila mbyl-lej me një tavolinë tjetër ku rrinin tre drejtues të mbledhjes. Në të dy anët ishin renditur ministrat e Qeverisë së Stabilitetit. Kryetarët e Tiranës, El-basanit dhe Dibrës ishin të thirrur në mbledhjen e Qeverisë këtë rradhë për të raportuar për punën.

Në qendër zuri vend kryeministri Ylli Bufi. Me trupin drejt, dy krahët e lëshuar përpara mbi një dosje, me fytyrën në formë trekëndëshi, gojën e vogël buzëmbledhur dhe veshët e liruar nga flokët e prerë shkurt, me trupin e hollë me bel dhe flokët kaçurrela pak të ngritura si me hark në maje të kresë, silueta e kryeministrit më ngjante si një qyp me dy vega,i nxjerrë nga rrënojat e qytetit antik të Apolonisë në Fier.

Anash tij, në krahun e majtë, rrinte zëvendëskryeministri ZyhdË Pepa. Me një fytyrë zeshkane në të errët, kostumin e zi, kokën katrore dhe flokët e të zeza të shpupurisir dhe me një xhufkë të bardhë thinjash në anën e ma-jtë, ai dukej si një korb i kartaleshur i përplasur mes ferrash.

Në anën e djathtë qëndronte zëvendëskrye-ministri Gramoz Pashko, i cili rrinte kokulur dhe shfletonte e paloste sa në të majtë e sa në të djathtë të tij fashikuj letrash, sikur nuk ishte në mbledhje, por në një tavolinë shtypshkronje. Me

fytyrën e bardhë dhe gojën e madhe me buzë të prera, me ballin e lart dhe veshjen e çelët, ai dukej si një perandor romak i mundur në betejë dhe që priste egzekutimin me moskokëçarje.

-Kanë ardhur ata nga rrethet?. . . Mirë, të mbarojmë njëherë me ata, pastaj do kalojmë në marrjen e disa vendimeve si Qeveri, sipas rendit të ditës, që ministrat e kanë përpara. Me rrethet kemi dy analiza:Masat për ngrohjen me dru zjarri, sepse jemi në prag dimëri, dhe ndarjen e tokës sipas ligjit 7501. Fillojmë nga Tirana. Fjalën e ka zoti Malasi, - e hapi mbledhjen Ylli Bufi.

Kryetari i Tiranës Tomorr Malasi foli shkurt për disa çeshtje, paraqiti gjendjen e vështirë për drutë e zjarrit. Kaloi diskutimi i tij me ndonjë pyetje dhe pa debat. Po kështu dhe Elbasani.

-Ju të Dibrës!-ma dha fjalën mua Kryeministri.

Nisa të shpjegoj, pak me emocion, se drutë e zjarrit i kemi të siguruara, sepse dy ndërmarrje, atë të Përpunim Drurit dhe Parkun e Mallrave i kemi në punë.

-Mirë, mirë, për drutë. Por ju jeni shumë keq me ndarjen e tokës sipa ligjit 7501. Para dy javësh bëmë një seminar në Rrëshen me zonat veriore e verilindore, ku ishte shoku ZyhdË. Që nga ajo kohë ju nuk keni bërë asgjë. Jeni rrethi më problematik në vend! -ndërhyri Kryeministri. -Ne tokën e kemi ndarë, zoti kryeministër, ju këtu bëni mbledhje sa të doni, ne kemi mbaruar punë me ndarjen e tokës, - i them.

Antarët e kabinetit qeveritar i përshkoi një mërmërimë habie. Thëniet e mia ishin jashtë çdo pritshmërie për ta dhe pa asnjë dorashkë apo etikë.

-Si e paskeni ndarë?!-foli Ylli Bufi duke për-plasur buzët e mbledhura dhe hedhur vështrimin çuditshëm mbi mua.

-E kemi ndarë secili në pronën e vetë.

Ndërhyri ZyhdË Pepa:

-Zoti kryeministër, këta as nuk e vënë ujët në zjarr për zbatimin e ligjit, nuk duan t’ia dinë se ka shtet apo jo, janë qeveri më vete!

-Ore, jeni në vete ju?-vazhdoi Ylli Bufi. -Nuk mund të lejojmë këtë situatë, do ndani tokën sipas ligjit.

-Edhe Europolin të bini, toka është ndarë!-u them disi me ngërc në të folur, sepse ishin hedhur të gjithë si skifterë me vështrimet mbi mua dhe ndjehesha i vetmuar.

-Ka mësuar edh fjalën Europol!-mërmëriti ZyhdË Pepa.

Ra një heshtje pa rrugëdalje.

-I kujt partie je ti?-më pyeti Ylli Bufi.

-Nuk kam ardhur këtu si përfaqësues i ndonjë partie, por si drejtues i komitetit ekzekutiv, -ia ktheva. Ylli uli kokën dhe u shfry si qumështi i grafulluar kur i hedh ujë të ftohtë.

Gramoz Pashko vetëtimthi u shkëput nga letrat dhe mu drejtua:

-Pse edhe ju nuk hyni në grevë urie si komiteti i Matit për tu bërë zonë e lirë ekonomike?Të futeni edhe ju!Siç ka paralajmëruar edhe Puka se edhe ata do të hyjnë në grevë urie!

- E kuptova ironinë dhe sarkazmën e Gramozit, por heshta, nuk doja t’ia ktheja me të njëjtën monedhë. Pasi ishte shpallur Zonë e Lirë Ekonomike Kavaja me Vendim Qeverie, kishin vërshuar kërkesa edhe nga rrethe të tjera, sipa asaj përallës “Vrapo djali i nënës se ngele pa hise!”. . Një pjesë komitetesh egzekutive pluraliste, në mënyrë qesharake, ishin futur në greva urie dhe ishte krijuar një gjendje absurde.

Njerëzit përplaseshin atje zyrave për bukën e gojës dhe njëmijë halle të përditshme, drejtuesit vendorë kishin mbyllur dyert dhe rrinin në greva urie. Neve në Dibër, as që na kishte shkuar mendja për një gjë të tillë. Gramozi ishte i xhindosur me të drejtë.

-Edhe ju mbylluni në grevë që të duket se po lufoni për popullin!-vazhdoi.

-Ne, zoti Gramoz, nuk është se kemi bërë ndonjë studim për leverdinë ekonomike të zonës së lirë. . . -fillova të mërmëris.

-Po ja, të futeni edhe ju me shokët,në grevë urie!

-Zoti Gramoz, pse nuk e fut ti gjithë Shqipërinë në Zonë të Lirë Ekonomike dhe, automatikisht, të futemi edhe ne si Dibër?!-u revoltova me sarkazmën e tij të zgjatur.

-Eeeeeee praaaa!Këtu është puna, por kush na pranon se????!!!!Nuk të pranon kush!-e mbylli ndërhyrjen Gramozi me një si kakarisie.

-Zoti Ylli, kemi biseduar edhe më parë bashkë, e thashë dhe më parë. Këta të Dibrës janë të papërgjegjshëm, nuk merresh vesh me këta!Propozoj që, pasi të shqyrtojmë vendimet

që kemi për të marrë sot në këtë mbledhje, në fund të marrim një vendim qeverie për shkriren e Komitetit Pluralist të Dibrës, dhe, në bash-këpunim me forcat politike atje, të ndërtojmë një komitet tjetër nga e para dhe të fillojmë ndarjen e tokës. Të krijohet një ekip qeveritar që të shkojë menjëherë në Dibër!-foli tepër i revoltuar ZyhdË Pepa.

-Dakord, shoku ZyhdË, -tha Ylli dhe u drejtua nga tavolinat në anë,ku rrinin sekretarë dhe juristë:-Përgatisni vendimin ta miratojmë në fund të mbledhjes. Kjo seancë mbyllet këtu. Kalojmë në çeshtje të tjera të rendit të ditës. Shokët e rretheve janë të lirë.

-Si ia kalove në mbledhje?-më pyeti kryetari kur u ktheva.

-Ia nxora fundin, ia hoqa dyshemesë edhe ato dy dërrasa, që patil-i thashë. Dhe ia shpjegova fije e për pe.

-Eh, dreqin!Tu kishe thënë se do ta rregullojmë, se kështu e duan ata, -tha Astriti.

Nuk zgjati shumë dhe na njoftuan se një ekip nga Kryeministria vjen në Dibër. Ishte fund nëntori, një kohë e zymtë dhe e ftohtë dimëri. Një ekip qeveritar zbriti me helikopter në fushën sportive “Korabi” dhe erdhën drejt e në sallën e mbledhjes, ku po prisnim, sipas porosisë që na ishte dhënë. Ishin të pranishëm të gjithë antarët e komitetit ekzekutiv të stabilitetit si dhe përfaqësues të partive politike.

Ekipin qeveritar e kryesonte zëvendëskryemi-nistri ZyhdË Pepa. E shoqëronin ministri i bujqë-sisë Nexhmedin DumanË, ministri i tregtisë së brendshme dhe turizmit Agim Mero dhe disa ministra të tjerë.

-Me vendim Qeverie është shkarkuar komiteti ekzekutiv pluralist i stabilitetit i Dibrës për neg-lizhencë dhe moszbatim me dashje të ligjit 7501 për tokën, -tha ZyhdË Pepa dhe lexoi Vendimin e Qeverisë.

Në sallë ra një heshtje e thellë. Ky ishte një njoftim krejt i papritur për të gjithë.

-Prandaj janë këtu edhe shokët e partive poli-tike, të krijohet një komitet i ri pas konsultimeve dhe të mblidhemi sot ose nesër ta strukturimin dhe ta miratojmë pastaj në Qeveri e të fillojë punën menjëherë, -vazhdoi ZyhdËu.

Asnjë nuk po fliste. Dikush kishte ndonjë bllok shënimesh përpara, dikush ndonjë copë letër, ndonjëri asgjë.

-Tokën e kemi ndarë, nuk duam ndihmë nga Qeveria, -ishte në thelb përgjigja jonë.

-Qofshi faqebardhë që erdhët, sepse na ka ardhur në maje të hundës!-e nisa diskutimin unë.

-Mirë i kemi shokët, nuk kemi të tjerë, - tha Elmas Lala nga dega e PS-së.

-Zotërinjtë kanë punuar mirë, -foli Safet Zhu-lali nga dega e PD-së.

Në një mendje ishin edhe kryetari i PSD-së Kujtim Leka dhe ai i PR-së Durmish Shehu.

Ekipi qeveritar ngeli si gomari në duhan. Ngulnin këmbë ZyhdË Pepa me shokë se është marrë një vendim qeverie, por, si mund të zbatohej ky vendim, kur nuk pranonin partitë politike për të sjellur njerëz të tjerë në drejtim?

Mjeku Rahim Xhika, antar i komitetit nga PS, vjen me vonesë në mbledhje dhe ulet në fund të sallës dhe nis e ngacmohet me batuta me ata, që kishte pranë. Pas disa debatesh, vonë fare, merr vesh se këta paskan ardhur nga Tirana për të shkarkuar komitetin ekzekutiv të Dibrës e për ta zëvendësuar me një tjetër. Ai edhe vetë ishte antar komiteti.

Ngrihet doktor Rahimi më këmbë i revoltuar dhe i drejtohet ZyhdË Pepës:

-Kush je ti, që dashke të bësh këtë punë?

-Jam zëvendëskryeministër, kam vendim qeverie, -thotë ZyhdËu.

-E din ti se këtu je në Dibër?A e sheh se kokën e kam të zbardhur?Edhe ti e ke një pullë të bardhë, por nuk je menduar mirë kur je nisur për këtu. Ktheu nga ke ardhur!-i thotë Rahimi dhe ulet. Në sallë shpërthyen të qeshura. ZyhdËu me Nexhbedin Dumanin e ndonjë tjetër në presidium filluan të çuçurisnin me njeritjetrin. Mbledhja nuk kishte kuptim të vazhdonte më.

Po atë ditë moti të zymtë, helikopteri u ngrit në qiellin me re dhe u kthye në Tiranë. Më 6 dhjetor 1991 qeveria e Ylli Bufit u rrëzua. Ajo, realisht, u rrëzua që në mbledhjen e komitetit ekzekutiv të stabilitetit në Dibër. Ishte një qeveri e pafuqishme, e përkohshme, pa identitet. Nuk mund të merrte asnjë vendim, mbështetej në kërraba partishë.

Në vitin 1963 pushteti i kohës bëri një punë shumë të mirë, nga të rrallat gjana të mira që ka bërë. U ngritën komisione për pajtimin e gjaqeve. Me marrëveshje e mirëkuptim, me bindje e, paksa me shtërngim, me diplomaci e me propagandë intensive, me lutje e me rixhá, në fshat dhe në gjithë Dibrën u ndërmor aksioni për pajtimin e gjaqeve...

Nga **BAJRAM XHAFA**

(vijon nga numri i kaluar)

* * *

Aty, në krye (krajë) të gjurrës do të mblidheshin në aksham grania e vajznia edhe për të shkëmbyer përvojat e mbresat e ditës a thjeshtë për muhabet. Atyre të hasmeteve u binte të përshkonin cep më cep mëhallën me shtëpi paksa të shpërnadara edhe atëherë kur duhej t’u jepnin ujë bagëtitë.

Gjurra shërbente edhe për të larë teshat. Kjo bahej në fund të javës, ditën e pazarit kur burrat e shpisë ishin në pazar. Por edhe në ditë të tjera, për lehtësi të zënies së vendit të “zjarrit” për të vu kazanin e teshave. Gratë e vajzat e mëhallës, secila për hesap të vet, ngarkonin në shpinë çarçafë, ndërresa, rroba, velenxa, lëkurë e rraqe të tjera dhe i lëshonin në gjurrë. Vinin kazanin e teshave afër buçakut të ujit a pak ma larg dhe ndiznin zjarrin. Finjën e kishin parapërgatitur dhe pastaj fillonin lamjen sipas proceseve: zbutja, futja në finjë, zierja, shpëlarja etj. Një ritual që vazhdonte gjithë ditën. Në vitet ’50 sapuni ishte gjë e rrallë. Finja që bahej me hirin e zjarmit zevendësonte sapunin. Pastaj ndemja e rrobave për t’u terë bahej nërpër gardhet e arave aty përreth. Kur tereshin, çarafët dhe këmishat shdrisnin nga bardhësia dhe lëshonin aromën e finjës. Ndemja për t’u terë ishte edhe njëlloj ekspozimi që shërbente edhe si emulacion. Sy të vemendshëm do të vlerësonin se kush zbadhte ma mirë çarçafët.

* * *

Të kthehemi edhe njëherë të shtëpia e xha Ganiut.

Derën e madhe (portën e hyrjes) shtëpia e kishte nga veriu, nga Përroi i Pekneut, kurse kundruall saj, nga ana jugore dhe në krye të oborrit ishte kamxhiku (deriçka) njëkapakësh, që përdorej më së shumti. Pranë bunarit ishte një man i madh i am(b)ël me kokrrat e kuqe sa “grushti”. Në fund të oborrit, ngjit me murin e shtëpisë ishte një grumbull i dendun, në dukje ferrash, por kur vinte pranvera, ato çelnin në trandafila gjithfarë ngjyrash, të kuq si gjaku, rozë, të bardhë e të verdhë me aromë dehëse që aman o Zot. S’kishte gjë ma të bukur. Ishin trandafila të “butë”, të kultivuar që atëherë pak kush mbillte prej tyre. I kishte sjellë vetë Ganiu që nga Tirana ku punonte si oficer a nënoficer. Rrugët e fshatit ishin plotë me tradafila të egër, edhe ata plot aromë, aromë origjinale, super, të egër, genuine, në ngjyrë të kuqe e të bardhë, që rriteshin vetë e delnin nga ferrat e zakonshme pa pyetur askend dhe që në gusht shtator banin kolomana (manaferra) të zes e të ëmbël, plot shije që konsumoheshin vetëm nga fëmijët.

* * *

Ganiu dhe Remi ishin një shtëpi e qénun. Nuk mund të thuhet se ishin të kamur, por bukën e vitit e banin me burimet e vetë shtëpisë. Për Malësinë kjo konsiderohej gjendje e mirë ekonomike. Ishte familje me hyrje e dalje të shumta, me dreka e darka, plot me miq, të afërm e të largët, miq shtëpie e njerëz qeverie. Edhe vetë ishin të zanë me punë qeverie.

Kishin një tufë modeste, dhen e dhi, një ose dy lopë mali dhe, herë një mushkë e herë një kalë si hajvan barre. Në shtëpinë e tyre, në vitet ’50 merrnin edhe ndonjë hyzmeqar për të mbuluar nevojat e shtëpisë, kryesisht për të ruajtur e mbarështuar blegtorinë.

Ganiu dhe Remi nuk ishin vllazën, por kushërinj të parë. Baballarët e tyre, Tushi dhe Shahini kishin qenë vllazën, kishin jetuar bashkërisht si një familje në harmoni e mirëkuptim; një shtëpi me elhamllëk, siç i thoshin atëherë. Ishte zakon i kohës. Kur më 1971 u ba elektrifikimi i fshatit, jashtë në çardak (telis) një llampë elektrike e linin të ndezur (e lënë edhe tani) gjithë natën. Nga larg e në krye të fshatit, në errësië dukej që ylli polar. Pa zhurmë e pa bujë, por duhej të tregonin diçka të veçantë nga të tjerët. Krenari e padamshme.

Sheherin e Dibrës së Madhe me dritat që vezullonin në ngjyra të shumta kur i ndiznin çdo mbrëmje e kishin drejt a drejtë, në vijë ajrore, ashtu siç Sheheri qendronte karshi edhe nga shtëpia ime këndej përroit; ashtu siç, Dibrën, Sheherin e Dibrës e kishte shtëpia dhe zemra e çdo dibrani, para apo prapa malit qoftë ajo. Peng i historisë dhe mallkimi i saj, Sheheri i Dibrës ishte zemreku i sahatit të çdo dibrani. Kur Fuqitë e Mëdha, që u shofshin, ia dhanë Sheherin më 1913 Serbisë, pastaj Jugosllavisë, më pas FYROM-it që i faroftë Zoti atë dhe krijuesit e saj, dhe së fundi Maqedonisë Veriore, por jo Dibrës shqiptare dhe

dibranëve. Dibra dhe dibranët mbetën pa kokën që kurdís mendjen e një populli dhe pa zemrekun që kurdís zemrën e tij, pa qendrën e tyre dhe pa shpirtin e tyre.

Remi kishte qenë partizan dhe ishte anëtar i Partisë Komuniste, (më pas, Parti e Punës së Shqipërisë), pra ishte komunist. Kjo bënte që marrëdhëniet me pushtetin të ishin të mira, megjithë faturën e rëndë të biografisë së Ganiut. Shtëpia e tyre priste e përcillte miq e mysafirë, të deleguar e njerëz të qeverisë. Kështu kishte qenë kjo shtëpi edhe përpara “Çlirimit”, edhe më herët, në kohën e Zgimit Kombëtar (Rilindjes) e të Pavarësisë. Në fshat kishin emër të mirë.

Dikur për ta kishte pasur edhe një kangë, në fillim të shekullit, kur kishte lindur Ganiu, por tashmë atë kangë nuk e zinin me gojë. Punë vrasjesh, gjaqesh e hakmarrjesh. As e kam dëgjuar ndonjëherë prej Ganiut dhe as kam pyetur për të. Edhe të tjerët nuk kishin dëshirë ta preknin atë histori. Ishte një kujtim i keq, histori e trishtë, një tabu. Ishte brenda në katund dhe mund të trazoheshin urjat. Disa punë lypin urti. Dhe hasmetet e zotëronin atë.

Në vitin 1963 pushteti i kohës bëri një punë shumë të mirë, nga të rrallat gjana të mira që ka bërë. U ngritën komisione për pajtimin e gjaqeve. Me marrëveshje e mirëkuptim, me bindje e, paksa me shtërngim, me diplomaci e me propagandë intensive, me lutje e me rixhá, në fshat dhe në gjithë Dibrën u ndërmor aksioni për pajtimin e gjaqet ve. Aksioni përfshiu gjithë vendin. Në prani dhe para ekipeve prestigjioze të përbëra prej burrash me emër të mirë dhe autoritet, me parti e me pushtet, burra kuvendi e pleqnar kanuni, solemnisht u dha fjala dhe u muar zotimi për faljen e gjaqeve. **U pajtuan gjaqet**, u shtinë pushkë, u shtru bukë *dhe iu pi kafja*. Nuk ka më kthim prapa.

Ra perdja e zezë e një historie të rëndë. Ishte një mrekulli, historike do të thosha. Pas 1990-s kur ra diktatura komuniste, sidomos në kaosin e vitit 1997-të, Dibra provoi me fakte se ai kapitull ishte mbyllur njëherë e për gjithmonë, dëshmi e urtësisë, burrërisë dhe karakterit të fortë të tyre. Madje, u banë edhe lidhje miqësore që e salduan edhe më shumë mbylljen e asaj historie. Subjekt i kësaj drame të rëndë të trashëguar nga e kaluara ishte edhe familja e Gani e Rrem Metës.

* * *

Në fëmijërinë time xha Ganiu ishte tek të ’50-at. Kishte një portret me tipare të skalitura. Sy zbironjës, shikim të vëmendshëm. E mbante veten, në veshje, në sjellje dhe në gjithçka. Nuk mbaj mend ta kem parë të parruar, gjë që në fshat tek burrat ka një shkujdesje për paraqitjen e jashtme. Ngarkesa e madhe e punëve të bujqësisë nuk të len të merresh me “salltanete” e të bësh kujdes për paraqitjen e jashtme. Mbante mustaqe ashtu si gjithë brezi i tij, por me masë. Ishte burrë me sharm. Në paraqitjen e tij, gjithçka ishte serioze dhe asnjë grimë ekstravagance.

Nga trupi vinte paksa ndën mesataren. Ishte serioz dhe gëzonte autoritet. Fliste me masë dhe i kishte peshë fjala. Kur fliste, veshët do të drejtoheshin nga ai. Përveç peshës së fjalës, ishte edhe zëri i trashë e kumbues që ia shtonte autoritetin, intonacioni i tij. Në njëfarë mënyre, kishte një të folur skenik, imponues por jo teatral. Shkonin në një linjë me logjikën dhe përmbajtjen e mendimit.

Dallonte shumë nga burrat e tjerë të fshatit, jo vetëm si moshë por edhe si formim. Duke mos ditur të kaluarën e tij, e merrja si gjithë mëhallalinjtë dhe bashkëfshatarët e tjerë. Në fakt shpejt do ta kuptoje se ai nuk ishte një “bujk” e një “katundar” si gjithë të tjerët. Edhe pse punonte si të gjithë në punët e bujqësisë: në mbjellje, ujitje, prashitje, premje misri, transport me kuaj apo mushka etj., ai tregonte se ishte gatuar për punë të tjera. Ishte brum tjetër. Për këtë ishte i ndërgjegjshëm edhe vetë.

Mua më “hahej” shumë muhabeti me xha Ganiun. Edhe atë me mua. Duke pas një shkollim të rregullt, madje për histori-geografi, që ishte “fusha” e tij, vazhdimisht hapte biseda për ngjarje e figura historike, shqiptare e botërore. Ai kishte kënaqësinë se kish ku të zbrazej, por dhe unë habitesha me dijenitë e tij, saktësinë dhe rrjedhshmërinë e narracionit. Fliste pa përtim. Ato që dinte i tregonte bukur dhe me endje. Dinte

t’i ilustronte me filozofinë e me moralin e jetës. Kombinonte bukur historinë me letërsinë, nga e cila dinte jo pak autorë dhe vepra.

Dijet e tij nuk i kishte spontane. I kishte vënë me kujdes dhe i ruante me kujdes. Lexonte vazhdimisht. Kishte një fond librash që i kishte grumbulluar dhe i rilexonte ato. Abaz Xhafa, mësuesi i fshatit që kishte mbaruar Normalen e Elbasanit më 1934 kishte një bibliotekë shumë të mirë dhe vazhdimisht e furnizote me libra si p.sh. “Lahuta e Malcis” të At Gjergj Fishtës. Lexonte natën me kandil.

Kur isha në Universitetin e Tiranës aty nga 1967-ta, vitin e tretë të studimeve kishim si detyrë vjetore të përgatisnim në mënyrë të pavarur edhe një temë studimore shkencore me afat një vjeçar. Udhëheqës shkencor kisha prof. Stefanaq Pollon, që ishte edhe dekan i Fakultetit. Profesori më thirri në zyrë, hera e parë që hyja në zyrën e dekanit dhe më komunikoi temën që do të përgatisja: “Lufta për arsimin dhe shkollën shqipe në vitet 1908-1912 në Dibër”. Më dha udhëzimet përkatëse për burimet që do të shfrytëzoja, literaturën dhe...kaq. Unë nuk u pashë më me profesorin. As shkova ndonjëherë për ndonjë konsultim.

Pasi mora detyrën, shkova në bibliotekën e Institutit të Gjuhësisë dhe Historisë ku më vunë përpara një dosje me shënime të Haki Stërmillit në të cilën ishte edhe vepra e tij në dorëshkrim “Dibra në prag të historisë”. Shihja aty shënime në copa letrash e kapakë fletoresh shkrimi, edhe në kuti cigaresh, shënime të zverdhura nga rrezet e diellit nga qendrimi i fletëve pranë dritares e plot gjëra të tilla. Letra paska qenë me shumë kursim. Mora material edhe nga libri i prof. Petraq Pepo “Kujtime veteranësh të Rilindjes Kombëtare”. Aty mu hap një dritare e fortë “hulumtimi”.

Gjatë procesit të studimit, zakonisht praktikonim metodën me “lidhje të shkurtër”. E kishim bërë zakon që të mbanim shënime të hol- lësishme nga leksionet që na jepnin në fakultet, të konsultonim literaturën nga klasikët e M-L për seminare, t’i mësonim leksionet kur të vinte koha e provimeve dhe me kaq mbaronte puna. Ndërsa këtu ndryshonte puna. Ishin përpjekje për të bërë punë shkencore. Shënimeve që kisha nxjerrë u shtova dhe kujtimet që kisha marrë gjatë pushimeve dimërore tek mixha Gani. Kujtimet e Xha Ganiut ishin më jetësore dhe “autentike”. Kjo e shtonte larminë dhe impenjimim e studimit tim me një referencë më tepër nga “dëshmitarët” e gjallë nga populli.

Në fund të vitit, kur dorëzoheshin detyrat, më thirri në dekanat. Nuk kisha shkuar ndonjëherë për t’u konsultuar me udhëheqësin e temës, apo për të kërkuar ndihmë. Kishte menduar se për temën vjetore nuk e kisha vënë ujin në zjarr, dhe filloi menjëherë qortimet dhe vërejtjet. Madje më foli pak i nervozuar, gjë që nuk ishte në natyrën së tij. Më qortoi rëndë pse nuk isha interesuar për temën. Nuk ke ardhur asnjëherë të konsultohesh për burimet, literaturën, referencat, kujtimet e bashkëkohësve, madje as për të bërë planin e temës. Në fakt, të gjitha këto unë i kisha marrë prej “vedit”, ashtu siç kisha ditur.

Nuk thashë asnjë fjalë. Si mbaroi profesori, mendova se puna e diplomës do të mbetej për sesionin tjetër. I turpëruar dhe me kokën ulur, pa bërë zë i zgjata profesorit një fletore katër lekëshe ku kisha shkruar temën ashtu siç kisha ditur dhe i thashë: kam shkruar këtu diçka si punë paraprake dhe mbi bazën e vërejtjeve do ta ripunoj e do t’ua sjell.

Si mori fletoren, tha se do ta shihte. Pas disa ditësh, tek po kalonte në korridor, më ndaloi dhe më tha: Po ti e kishe bërë mirë, kishe punuar mjaft mirë, me strukturën, problemet, burimet, literaturën, referencat etj. Tema ishte e plotë, tha dhe më uroi. U çlirova. Falenderova edhe ndihmën e xha Ganiut.

Strategjia shtetërore e partiake e përmbysjes

Nga Hasmetet (fisi Meta) nuk kishte veçse trekatër familje. Të katrat, në mëhallën e Epër: dy në krye, e dy në fund të mëhallës. Kishin një kushëri në Tiranë, një Xhek Meta që u vinte dhe i shkonin për sebepe e vakijate. Dalloheshin për qëndrime të matura e korrekte në komunitet.

Mëhalla e Epër zotëronte një burim të vogël uji, Kroji i Epërm, poshtë të cilit banorët e mëhallës kishin bërë një hurdhë për grumbullimin e ujit. E përdornin vetëm për ujitjen e kopshtit

të zarzavateve, zakonisht një shpore spece, domate, kastraveca, qepë, prasë dhe një parcelë të vogël duhan etj. Për më tepër nuk mjaftonte uji. Respektohej një radhë ose rend për përdorimin hurdhës. Çdo familje konsumonte rezervën e ujit të grumbulluar sipas rendit: gjatë ditës ose natës. Nuk mbaj mend që, për sherr, fëmijët e hasmete të ndanin vijën e ujit kur radhën e kishte ndonjë tjetër, siç ndodhte në ndonjë rast tjetër. Edhe zullume të tjera të qëllimshme, fjala vjen (f.v.) me bagëtitë, nuk mbaj mend të bënin. Jeta e fshatit jep shkas për sherre të shumta e të llojllojshme, të vogëla dhe jo të vogëla. Edhe intrigat e vogla të fshatit, fëmijët, gratë, bëjnë punën e tyre.

Si tokë “buke” Ganiu dhe Rremi kishin disa parcela të vogla të shpërndara një këtu e një atje, si gjithkund në malësitë tona. Pjesa më e madhe mbi ujë, në të thatë dhe më pak nga toka qi i kapte ujitja (toka nën ujë). Ara më e mirë që kishin ishte Lenishtja, ndonjë 2 dynym a pak më tepër dhe dy copa toke tek Gjurra e Te(j)me. Në katundin Gjoricë e Epërme patën një parcelë me tokë të mirë në sipërfaqe kompakte prej dhjetë dynymësh që e kishin blerë para ca kohësh, por aty nga viti 1954-1955 atë e banë tramtë duke e këmbyer me ca toka, shumica djerrina të thata që morën nga Halit dhe Ramiz Xhafa në Gjurrën e Teme, të cilët u shpërgulën nga Kovashica në Gjoricë. Më pas u krijua kooperativa bujqësore dhe toka e humbi vlerën e saj, ashtu si dhe çdo gjë tjetër në atë sistem.

Para shtëpisë së tyre, tej avllisë varej poshtë deri tek shtëpia e Halitit një bahçe e rrethuar mirë që kishte nga llojet e ndryshme të pemëve. Shtrenjtësia e jetës nuk e lejonte luksin që banorët të mendonin për të kultivuar frutikuturën. Buka, buka, buka e çullëve, kjo ishte e para, ishte baza. Bukë e groshë dhe një shllinë. Dimrit edhe ca turshi, që Dibra i ka zanat. Nuk kishte pretendime të tjera. Fukarallek.

Në bisedat që mixha Gani nxiste midis njerëzve për zgjerim horizonti për kuptimin e jetës. E pyeti filani filanin (emrat nuk më kujtohen): Kush quhet bujk i mirë? – Bujk i mirë asht ai qi ban bukën e vitit, përgjigjet tjetri. Kjo asht kryesorja, mos me i lanë fëmijët pa bukë. Bukë e grosh e fale Zot. Çduem tjetër më. Si të kem bukë e groshë, unë jam agá, ishte përgjigja. – Jo, i thotë Ganiu. Bujk i mirë asht ai që përveç misrit e groshës zhvillon edhe pemën, mbjell edhe mollën, mbjell dardhën, ftoin, kumbullën, qershinë, arrën etj. Ai asht bujk mirë, i mëshonte idesë për të cilën e kishte provokuar xha Ganiu.

Në përgjithësi në Dibër, e vaçanërisht në zonën e Malësisë, ku toka është shumë e kursyer, bujqit linin të “zhvilloheshin” e të mbijetojnë ata pemë që falte zoti, edhe atá, kur ishin në periferi të arës, të tokës së “bukës”, në porene, në meja ose në proje, në meraje, në kullota e në toka berihabá. Këtu “kultivoheshin” arrat (që mbinin vetë), kumbullat e zeza, kajsiat (e egra) me të cilat bëhet baki shumë e mirë, gështenjat, dardhat e egra (gorica), ftojt, mollar. Parcelë toke e caktuar enkas për pemëtore shihje rrallë e aspak: Gani Meta e kishte një bahçe të tillë të mbjellë me lloje të ndryshme pemësh. Kishte aty dardha, molla, kumbulla, një kumbull e veçantë që Ganiu e paska marrë në Itali qysh në kohën e Zogut a në kohën e Italisë, pemë që lulëzojnë edhe sot.

Kultura e rrusht zhvillohej vetëm në disa pe-rene ku hardhijat kacavareshin nëpër kumbulla, plepa, më ndonjë lis etj. Nga shërbimet i bëhej vetëm ndonjë krasitje. Shartimi i pemëve ishte një shërbim i rrallë dhe zotërohej nga pak njerëz. Shkolla Amerikane e Fulcit në Tiranë dhe Kavajë gjatë kohës së Mbretërisë përgatiti mjaft special-istë edhe nga Dibra, por veprimtaria e tyre ishte e kufizuar. Në Kovashicë pjergulla të mira rrushi kishte Halit Tomja (Hoxha e Vogël), Halit e Hysni Toçi, Ali Xhafa tek Përroi i Madh, pjergulla të cilat, kur ishim fëmijë, i shihnim nga larg si tek fabula dhelpra dhe rrushtë: “si e pa që s’mund t’i zërë, / tha, qenkan të pa bërë”.

Për kultivimin e rrusht nuk krijoheshin vreshta të posaçme. Edhe në këtë drejtim Ganiu ishte “pionier”, apo siç thuhej në kohën e kooperativës, “shkollë e përvojës së përparuar” në bujqësi. Ganiu kishte një vneshtë bukur të mirë aty tek “Vneshtt”, të cilën e mbajti deri vonë në vitet ’60.

vijon numrin e ardhshëm

Shefqet Kaca është njeriu, intelektual, profesionisti dhe specialisti me të gjitha cilësitë pozitive.

Shefqet Kaca, njeriu i veçantë

Nga SHAQIR ÇERPJA

Është përcaktuar dhe pranuar si aksiomë, kanë thënë dhe thonë se, çdo njeri bën gabime dhe ka të meta dhe se, njeri pa gabime e pa të meta nuk ka. Dhe, kjo është një e vërtetë e provuar, por është një e vërtetë relative, jo absolute. Sepse, ndonëse rrallë, shumë rrallë, bile tepër, tepër rrallë, ka edhe njerëz pa të meta. Çdo njeri dëshiron e lakmon që të të mos ketë gabime dhe të meta. Si të gjithë njerëzit e tjerë, edhe unë kështu dëshiroj e lakmoj, të jem njeri pa gabime e të meta. Por, jo! Nuk jam unë njeri pa të meta e gabime, por unë njoh një njeri të rrallë dhe të veçantë, pa asnjë të metë. Nuk e kam njohur tani. E kam njohur shumë herët, shumë kohë më parë, para shumë viteve dhe dekadave, e njoh që në kohën dhe në moshën e fëmijërisë. Nuk jemi nga i njëjti fshat, por na njohu, na lidhi e na bashkoi shkolla, jeta shkollore, që nga klasa e pestë deri në klasën e tetë, në shkollën 8-vjeçare në Lashkizë. Pas kryerjes e përfundimit të shkollës 8-vjeçare, rrugët tona u ndanë. Unë fillova direkt punën mësues në Lashkizë, ndërsa ai vazhdoi shkollën e mesme mjekësore "Jani Minga" në Vlorë. Rrugët tona u ndanë, por nuk u nda, nuk u ndërpre dhe nuk u shpëput lidhja jonë shoqërore, shoqëria jonë e pastër, e çiltër, e singertë, shoqëri, që vazhdon edhe tani. Ai është Shefqet Kaca. Që nga mosha e fëmijërisë, kur u njohëm dhe takuam për herë të parë e deri tani, ai ishte, është dhe mbetet njeriu model, njeriu më i veçantë, pa asnjë të metë. Dhe, jo vetëm unë e njoh kështu. Kështu si unë e njohin të gjithë njerëzit në të gjithë fshatrat e Dardhës, por edhe shumë e shumë njerëz në zonat përreth si Lurë, Reç, Sllövë, Çidhin, etj. Dhe, për të gjithë njerëzit, që e njohin, Shefqet Kaca është njeri i veçantë, njeri pa asnjë të metë.

Shefqet Kaca u lind në fillim të pranverës, në fund të muajit të parë të pranverës, më 27 mars 1956, në fshatin Tartaj të Dibrës. Shefqeti, ashtu si gjithë moshatarët e tij të fshatit e zonës, lindi në një familje të varfër. Ai ishte fëmija i parë i dy prindërve model, Vesel dhe Ahmedie Kacës, dy prindër e dy njerëz shembullor, të thjeshtë, të urtë, të qetë, të heshtur, të drejtë, dashamirës, punëtorë, të çiltër, me shpirt e zemër të bardhë, ku buronte vetëm mirësi. Familja e tij, fillimisht e vogël, kishte halle dhe probleme të mëdha, kishte vështirësi të shumta ekonomike. Sigurisht, edhe fëmijët rriteshin me preokupimet dhe hallet familjare, edhe



fëmijët mbanin e kishin mbi supe barrën dhe peshën e këtyre halleve të familjes. Dhe, kështu, me halle e midis halleve, me vështirësi dhe midis vështirësive e nisi dhe e filloi jetën fëmijore, udhën e jetës së tij, Shefqeti. Që në fillim, që në hapat e parë të jetës fëmijore, ai u takua, u ballafaqua, ndjeu dhe përjetoi hallet, problemet dhe vështirësitë e familjes, të cilat e ndoqën dhe e shoqëruan gjatë, deri pas mbarimit të shkollës së mesme. Familja e tij ishte e varfër nga ana ekonomike, por ishte shumë e pasur në vlerat dhe virtytet njerëzore. Dhe, Shefqeti, trashëgoi nga familja e tij këtë pasuri të madhe e të çmuar, edukatën familjare, dashamirësinë, korrektësinë...

Ai trashëgoi të gjitha vlerat dhe virtytet e prindërve të tij. Ishte djalë shumë i urtë dhe me sjellje shembullorë, i respektueshëm, korrekt, serioz, etj., cilësi këto, që e shoqëruan gjithmonë, gjatë gjithë kohës, kudo e kurdoherë.

Pas kryerjes së shkollës 8-vjeçare në Lashkizë, Shefqetit iu dha bursa për të vazhduar shkollën e mesme mjekësore "Jani Minga" në Vlorë. Familja e tij nuk kishte ndonjë mbështetje të veçantë politike e shtetërore dhe as ndonjë lidhje miqësore me ndonjë njeri të pushtetshëm, por, ndoshta, drejtësia e familjes së tij e ndihmoi, i hapi rrugën dhe i dha mundësinë që Shefqeti të vazhdonte shkollën e mesme mjekësore, në degën më të zgjedhur e më të preferuar për atë kohë, por edhe për tani. Por, më shumë se sa për Shefqetin, kjo bursë rezultoi shumë e rëndësishme dhe shumë me vlerë për Dardhën dhe dërnjanët, për njerëzit, të cilëve, Shefqeti u ka shërbyer dhe u shërben me shumë devotshmëri, ndërgjegje, përkushtim, me përgjegjësi dhe korrektësi.

Sapo mbaroi shkollën e mesme mjekësore, u caktua të punonte në Lurë, një zonë me hapësirë të madhe gjeografike, me fshatra të shpërndarë, që nga Gur-Lura e deri në Lajthizë të Mirditës, nga Tejmolla, Sumej e deri në kufi me fshatin Mërkurth të Mirditës; me teren të thyer malor dhe me rrugë të vështira. Ishte djalë i ri dhe kishte shumë ëndrra e dëshira, pasion, vullnet dhe optimizëm për punën dhe jetën dhe, për gjithë kohën që punoi në Lurë, jo pak, por plot dhjetë vite,

Shefqet Kaca është çmuar e çmohet, është vlerësuar dhe vlerësohet. Ai ka marrë vlerësime të larta institucionale, por vlerësimin më të madh, dekoratën më të lartë ia ka dhënë populli, njerëzit, të cilëve, ai u ka shërbyer dhe u shërben me shumë ndërgjegje, përkushtim dhe korrektësi.

kudo ku shkoi, punoi dhe shërbeu, në çdo fshat, lagje e familje, la gjurmë të çmuara mirësjellje, përkushtimi e shërbimi dhe fitoi e mori vlerësimin e lartë, respektin dhe mirënjohjen e njerëzve dashamirës të Lurës. Pas dhjetë viteve punë të suksesshme në Lurë, transferohet e vjen në vendlindje, fillimisht në ambulancën e fshatit Lashkizë dhe pastaj në qendrën shëndetësore Zall-Dardhë, ku vazhdon të punoj edhe tani, duke mbuluar me punë dhe shërbim të gjithë fshatrat e Dardhës. Për Dardhën dhe dërnjanët ishte shans i mirë, fat dhe fatmirësi, që t'u shërbente një njeri i veçantë, i ndërgjegjshëm, i përkushtuar, korrekt si Shefqet Kaca. Ai kishte dhe ka zemër dhe shpirt të bardhë, është human dhe gjithmonë është treguar i gatshëm dhe asnjëherë nuk është kursyer e shmangur për t'u shërbyer njerëzve, kudo e kurdo, jo vetëm ditën, por edhe natën, në kushte edhe shumë të vështira, në kulmin e vapës së diellit përvëlues e të acarit drithërues, në shi e në borë. Ai është njeri gojëmbël dhe i respektueshëm për të gjithë njerëzit njësoj, pa dallime e preferenca. Po aq sa profesionalisht, ai kuron e shëron shpirtërisht, me fjalën e ngrohtë, me buzëqeshjen e çiltër, me komunikimin e ëmbël e të përzemërt, me durimin e madh, me optimizmin e lartë, duke u dhënë njerëzve të sëmurë dhe familjarëve të tyre besim dhe shpresë. Me punën e tij të palodhur, me përkushtimin që ka treguar dhe me profilin e spikatur njerëzor, intelektual dhe profesional, ai, jo vetëm ka rritur e shumëfishuar vlerat e tij, por ka rrit në shkallën më të lartë vlerat e profesionit të tij. Moralisht ka rritur edhe statusin e tij profesional, duke fituar moralisht statusin e mjekut, të një mjeku human, të një mjeku me përvojë, të një mjeku me përkushtim maksimal. Për këtë arsye, njerëzit preferojnë dhe kërkojnë shërbimin e tij, u binden dhe u besojnë konkluzioneve të tij, pranojnë dhe zbatojnë këshillat, porositë dhe rekomandimet e tij.

Mirësjellja, edukata, kultura dhe toleranca e bëjnë jo vetëm të dëshërueshëm, por edhe të lakmueshëm e të admirueshëm komunikimin me Shefqetin, jo vetëm në aspektin e

punës së tij profesionale, por edhe në aspektin e marrëdhënive të përditshme shoqërore. Ai është modeli i njeriut bashkëpunues,, gjithmonë i gatshëm për të marrë përsipër dhe për të bashkëndarë me shokët dhe kolegët çdo punë, shërbim dhe përgjegjësi. Tek Shefqet Kaca, asnjëherë nuk gjeti e nuk pati vend mendjemadhësia, mburrja dhe krenaria cinike. Shefqeti nuk mburret asnjëherë, por Dardha dhe dërnjanët mburren dhe krenohen me Shefqetin, së pari si njeri, por edhe si profesionit i aftë dhe i përkushtuar. Profili njerëzor, intelektual dhe profesional i tij, është modeli më i mirë dhe më i spikatur, jo vetëm për t'u shërbyer njerëzve, por edhe për edukimin e tyre me dëshirën, dashurinë, disiplinën, përkushtimin dhe korrektësinë për punën dhe detyrën. Në shpirtin e tij human nuk ka asnjë peng shpirtëror për ndonjë punë e shërbim të harruar, të neglizhuar, të nënvleftësuar e të bërë keq. Modeli i tij njerëzor dhe profesional është i rrallë dhe i veçantë; i duhen më shumë se kurrë jetës tonë, kohës dhe realitetit tonë, sepse u mungon atyre.

Shefqet Kaca është njeriu, intelektual, profesionisti dhe specialisti me të gjitha cilësitë pozitive, pa asnjë të metë. Ai, asnjëherë nuk e mendoi, nuk pranoi dhe nuk e provoi, që detyrën dhe profesionin e tij human ta kthente në biznes. Shpirti i tij human shpërndan vetëm mirësi dhe mbjell e jep besim e shpresë. Në profilin njerëzor dhe profesional të Shefqet Kacës, edhe sikur të përpiqesh, të gërmosh e të kërkosh për të gjetur ndonjë të metë, nuk gjen dot, sepse nuk ka asnjë të metë, sepse ai është njeriu shumë i veçantë, pa asnjë të metë. Të shkruash për Shefqet Kacën është shumë e lehtë. Për Shefqetin mund të shkruaj kushdo, sepse për të shkruar për Shefqetin, nuk është e nevojshme të kërkosh, të gesh e të zgjedhësh fjalë të bukura. Portretin e tij e ka zbuluar dhe zbuluron puna e tij shembullore, përkushtimi që ka treguar dhe modeli i spikatur njerëzor dhe profesional, që ka krijuar.

Ai jeton i lumtur, sepse puna e palodhur, me ndërgjegje e përkushtim maksimal, i jep atij qetësi dhe rehati shpirtërore. Ne krenohemi me Shefqet Kacën, ndërsa Shefqeti krenohet me familjen e tij të shtrenjët, me prindërit, që e rritën dhe edukuan dhe me fëmijët e tij, që ai dhe bashkëshortja e tij kanë rritur dhe edukuar, njëri nga të cilët, djali i madh i Shefqetit, këngëtari Bledar Kaca ka krijuar profil artistik të mirënjohur dhe shumë të afirmuar.

Shefqet Kaca është çmuar e çmohet, është vlerësuar dhe vlerësohet. Ai ka marrë vlerësime të larta institucionale, por vlerësimin më të madh, dekoratën më të lartë ia ka dhënë populli, njerëzit, të cilëve, ai u ka shërbyer dhe u shërben me shumë ndërgjegje, përkushtim dhe korrektësi.



Shefqet Kaca



Bëj pajtimin tënd me

përmes emailit <rrugaearberit@gmail.com>

Një pajtim vjetor kushton:

Në Shqipëri: 600 lekë.

Në Europë: 10 Euro.

Në SHBA dhe vende të tjera: 15 USD.

Pajtimi në Europë dhe SHBA është vetëm në versionin PDF.

Ne nuk jemi gazetë e pavarur, ne jemi gazetë e lirë dhe pavarësia jonë garantohet vetëm nga mbështetja e lexuesve...

Nga QAZIM SHEHU

Vëllimi poetik më i ri i Mevlud Bucit shenjtëron, përmes një verbi të singertë e plot ndjenjë vendlindjen; vendlindjen si natyrë me male, gryka, përrenj, shkëmbinjtë, thepa, kresh-ta, lëndina, lule; vendlindjen përmes një zëri epik, me traditat, luftërat për liri, kullat, qëndresën dhe mbijetesën, për të ngritur lart virtytet e malësorit, të cilat u shenjtëruan nëpër shekuj dhe mbajtën gjallë karakterin e etnisë; poeti shenjtëron e shpalos dashuri, mall, përkushtim dhe mirënjohje edhe për sa njerëz të cilët i ka njohur, njerëz të thjeshtë po edhe të përmendur. Kjo është pak a shumë natyra tematike e këtij vëllimi që i bëhet me dije lexuesit që në fillim, për të kuptuar se Mevlud Buci është një poet i hapur, dhe gjithë krijimtaria e tij poetike përshkohet nga vrulli i pandalshëm i zbulimit të thesareve njerëzore, dhe këto thesare mbeten të paçmueshme, duke bërë një thirrje ideotematike, se nuk ka gjë më të bukur se sa të duash njeriun, se përmes kësaj dashurie do dhe lartëson veten. Mevlud Buci është një poet original, i cili ka zërin e tij; ai vjen në poezi me një ritëm dhe vrull intensiv, përmes lakonizmit të shprehjes dhe energjisë së fjalës, duke rendur në përfytyrime konkrete të jetës, larg abstragimeve të panevojshme dhe kërkimit të figurës për ta mistifikuar atë në kuptime të errëta vramendjeje. Si i tillë, ai mbetet poet i singëritetit të vargut dhe asnjëherë nuk e mbyllet poezinë me kërkime dhe thellime të panevojshme, gjë të cilat do ta largonin atë nga ky origjinalitet, sepse ai i këndon asaj që njeh, që ndikon, që përjetohet dhe pastaj transformohet në fuqi imaginative vargu; kështu, poezia e tij mbetet e rrjedhshme, melodioze, me vargje që vijjnë në metrin e tyre sipas shpërthimit të frymëzimit e kjo ia rrit patetikën dhe dinamikën e vargut dhe e bën të veçantë e të dallueshëm në vetësinë e tij poetike. Ky vëllim flet për një punë dinjitoze, për përzgjedhje dhe renditje të poezive në aspekt të vlerave të tyre.

Poezia e Bucit ka një shtrat të gjerë ku mund të lëvizë, të qëndrojë e të stacionohet, ajo mbart një frymëzim të thellë për vendlindjen për njerëzit e saj, për far e fisin, njerëzit e afërt, duke shenjtëruar dashurinë njerëzore; prandaj me të drejtë poeti ia ka vënë titullin “Shenjtëria”, titull që mund të arrijë deri në nivelin fetar të nderimit. Ky shenjtërim nuk është një deklaratë, po një burim i singertë i ndjenjës dhe besimit, një pulsimit i natyrshëm i kësaj ndjenje, një shpalosje, sa e ngadalte, aq edhe e vrullshme, e kohërave të cilat te Buci vijjnë dhe mblidhen bashkë në metaforën e kujtesës. “Ku ndien dallgë për mallimi/ku loton lulja nga gëzimi/ku çel shpirti frymëzime/ku tjetër, veç në vendlindje”... ; janë këto disa vargje që poeti i shtron si kuintesencë të përjetimit dhe të mendimit të vet për vendlindjen. Dhe poeti është në kërkim të një melodie; atë e përfytyron tek shëtit në katër Grykët, tutje nga Kacnia e Lukani, tek vështron malin e Runjës me pamjen hijerëndë dhe epike, por që fal ngrohtësi, dhe kërkon meloditë që falin drurët e gurët, gjithi i jeshiluar, zogjtë, përrenjtë dhe lumenjtë, kërkon melodinë e jetës e cila nuk mund të kuptohet, veçse si një shpërthim i butë i natyrës e, për pasojë, edhe të zemrës. “Dua dhe kërkoj një melodi/ta gdhend në tela çiftelie/si dritë jetë në sytë e mi/ta çel zambak për dashuri”. Meloditë e jetës në malësi janë të heshtura, të bukura, të pastra, ato nuk përzihen nga gërvima metali as nga pluhurat e intoksikuara të qyteteve dhe të metropoleve; dhe, nga ky këndvështrim, buron edhe tisi romantik i poezisë së Bucit, jo një romantizëm lëngues, por një romantizëm shëruës. Këto melodi të natyrës, ndjellin në shpirt paqe, frymëzim, jetë, mall, brenga, një vlim të natyrshëm çastesh, rrjedhën e kujtimeve dhe të poezisë, dhe Buci arrin të shprehë: “Për vendlindjen nga malli/nis e qaj/se vendlindjen gur stërralli/në zemër mbaj”. Guri i stërrallit është guri që lëshon xixa, ai është gur jete; ja pra, kështu mbetet edhe vendlindja, shkëmb e gur, flamur kujtese që valëvitet hapësirave të saj plot për mallim, po edhe realitet i gjallë konkret me begatitë e saj të mira që shuhën në heshtje nga mungesa e njerëzve të ikur... Dashuria për vendlindjen nuk është e re në poezinë tonë; ajo është trajtuar nga shumë poetë; por e veçantë te ky vëllim mbetet se kjo dashuri shpaloset dhe thuret përmes elementit konkret gjeografik, lokalizohet dhe tabloizohet në një vend të caktuar; jo thjesht si enumeracion kodrash, malesh luginash, as si dekoracion, çfarë janë, por si përjetim i natyrshëm.

Peizazhi i vendlindjes merr domethënie në poezinë e Bucit dhe nuk është thjesht një

Poet i ngjyrave të vendlindjes, i dashurisë dhe patriotizmit brilant...



përshkrim gjeografik, por, më së shumti, gjetje e atyre detajeve të cilët kalojnë dhe vizatohen përmes shprehësisë së ndjenjës dhe ndihmojnë që ta përcjellin atë. “Pllaja, male, shtigje, /Atje kullosin rrufetë, /Atje ku ka folenë thellëza, /Bilbili folenë vetë. /Pranvera bleron vonë, /Bora shkrin në maj. /Ëndërr kam të ngitem, /Vetëm me malin të rritem... “Çfarë mund të kuptosh përmes këtyre vargjeve, veçse mahnitjen që ndjen poeti përmes këtij peizazhi që e jep me fjalë të kursyera thjesht, po me forcë ndiesore, veçse mahnitjen që shkakton një peizazh i tillë dhe gravitetin tërheqës që ai ka, sepse: “Lartësive në maja/ Atje ku retë fjalosen/ Mbi gryka e thepaja/ Ku rrufetë kullosin. / Lartësive të maleve/ Rri fytyrë e të parëve, /Lartësive të ngjitesh/ Ndjen si përtëritesh...”; ja pra, çfarë kumti na jep poeti duke u ndalur në forcën përtëritëse të natyrës, dhe duke e bërë atë pjesë organike të njeriut, një simbiozë aq e qartë dhe të mrekullueshme, e njohur tashmë dhe e sjellë përmes këtyre vargjeve të freskëta me vlerë domethënëse: “Atje lart nëpër ahishte, /Mu tek krojet, anës lisit, /Vrullojnë gurrat në zallishte, /Jehojnë zërat e bilbilit. /Vjen bukuria e ndrit gusha, /Vjen prej shkrepit, prej lëndinës, /I ndez krojet kjo Tanusha, /Shtatkurora e Jutbinës...”

Vëmë re se në poezinë e këtij autori përshihet shpesh fjala Jutbinë, Tanushë, Ajkunë, figura këto të njohura në Cilklin e Kreshnikëve, por edhe për shumëkënd. Mevlud Buci është një njohës i shkëlqyer i folklorit, veçmas atij dibran, po edhe me gjerë, edhe në këto vargje, duke e parë me kujdes fjalën “shtatkurora” të cilën mund ta përcillnim si një metaforë origjinale të autorit, vetiu mund të mendojmë se poeti e sjell peizazhin nga lartësitë eterne dhe nga këto lartësi ai gjen kuptimin asociativ të përjasjes, vetëm për gruan, vajzën e këtyre anëve, kurora këtu janë majat e maleve të veshura me pyje e blerim... Nuk mund ta ndash peizazhin as nga poezia e dashurisë, krahas poezisë për vendlindjen, edhe këtu shkon po aq bukur dhe përputhshëm. Në lirikën e dashurisë, Buci shpalos ndjenjat më të singerta të intonuara here- herë me theksime të folklorit e duke përdorur mjete shprehëse të lirshme: “Deti u ngrit nga shtrati i vet, /Dhe u përplas në breg/ Vetën mori mbrapsht lumi, /Burimin s’ e gjet. / Gurra e kristaltë/E syve të tu, /S’ dihet ku shkoi,

/Logun tim të zemrës, /Shkretëtira e mbuloi...”

Motivi i ikjes nuk është motiv preferencial i këtij poeti, por, ai shfaqet aty-këtu, sepse, më së shumti, poezitë e Bucit afrojnë ardhjen, takimin, intimitetin, bashkëbisedimin dhe jo largimin. “Ti e mira në ato bjeshkë/Zemrën ma dogje eshkë, /Kur të shoh në bebe të synit? Këndojnë zanat në breg të Drinit. /Mbi kunorë bleroi tërfili, /Dhe u ndi një zë bilbili, /Molla dhe ftoi çelën në bahçe, /Karafilat nëpër faqe. “Vajza në poezinë e Bucit nuk i ik konceptit të folklorit, te ajo shihet një dashuri e shëndetshme, një ngazëllim që ia sjell jeta e pastër, një bukuri që rrëzëllit me bukuritë e natyrës, prandaj gjithë mjetet stilistike në përshkrimin e portretit të saj fizik poeti i merr nga natyra, nga lulet, trëndelinat, thëllëzat po edhe nga mitologjia, kur i duhet të përmendë herë pas here zanat si qenie të tilla. “Me shpirtin e saj, ndrit hyjnia/Ëndrrat, poezia, magjia. /Hyjnesha/Diell mbi kresh-ta. /Si pëllumbeshë që ikën/Nëpër rreze të hënës, /Më ndez/Flatrat e këngës. “Ai e hyjnizon dashurinë përmes këtij regëtimi të zemrës, duke sjellë një përfytyrim të gjallë metaforik përmes shfrytëzimit të detajeve natyrore më të pastra, dhe përmes këtij lirizmi mahnitës krijohet apoteoza e bukurisë, magjisë dhe dashurisë në korrespondim me të gjithë këto element që përmendëm më lart dhe që vibrojnë në të gjitha poezitë e këtij vëllimi me këtë temë. “O moj hënëza në agime/Zanë e sertë, manare, /As e merr këngën time/Ndriço hone e drizare. /Ti e bardhë si plat bore/Ngjitesh bjeshkë në livadhe, /Si brerim i një kurore/Plot me lule e petale”. Në këto vargje, poeti shpreh jo vetëm dashurinë po edhe vetminë e maleve, e, në këtë vetmi, patjetër zemra ka nevojë të mbushet me dashuri, për ta bërë më të hijshme më të kuptueshme atë. Kontrastet inkadeshente që krijohen: “Zanë e sertë/manare”, janë mjaft të gjetura dhe sjellin pikërisht atë mendim tipologjik që rri brenda portretit të vajzës malësore. Lirika e dashurisë te ky poet buron me intonacione të buta, ajo përshkruan thjeshtësisht e denjësisht portretin fizik të vajzës malësore me të gjithë ato detaje që poeti i huazon nga natyra, folklori pse jo edhe nga poezia popullore. Është një poezi që shkruhet me spontanitet, e shkurtër, jo shumë e gjatë dhe në çdo aspekt të saj qëllimor dhe ideor reflekton bukurinë, hijeshinë, moralin dhe virtytin e vajzës malësore. Kjo poezi buron përmes ndjenjave të ngrohta, një lirizmi të pastër subtil, brenda këngëtimt të një zemre poetike që vjen në vite e magjepsur nga bukuria e njeriut, bukuria e natyrës dhe bukuria e vendlindjes; kështu lirika e dashurisë impresionin, pikërisht për qartësinë e mendimit dhe vlagën e ndjenjës e cila hijeshon.



Buci është një poet epik; epika e tij vrrullon përmes nderimit për të parët, për luftërat, historinë, qëndresën, mikpritjen, mbajtjen e fjalës së dhënë; ai është një njohës shumë i mirë i historisë së vendlindjes, historisë së Dibrës, këtë e ka dëshmuar në libra të tjerë. Nderimi për të parët është në radhë të parë nderim për vetveten, për të sotmen, dhe të ardhmen, dhe kjo ide përshkon si një fill i pashkëputshëm gjithë poezitë e tij epike, të cilat dallohen për një ritëm të fortë të shprehuri, shpesh me vargje rapsodikë. Simboli i kullës shëtit aty-këtu dhe bëhet simbol-rrethqëndror i epizmit, i cili mbledh rreth vetes dhe tjerr shtëllungat e reve të kohërave dhe, prej tyre, tjerr fijet e kujtimeve të pambaruëshme. “Një katund sofër e bujarisë, /Murra e vjetër e Arbnisë, /Në çdo fis e në çdo kullë/Gen trimnie për flamur”. Vargje sintetike, plot kuptim, me të cilat shprehet gjithë koha e sendërtuar në ato kulla bujare që ruajtën etninë, se në ato kulla jetonin fise të forta me emër, të cilët u bënë qëndrestarë përballë turkut, serbit dhe çdo

pushtuesi. “Dritë jete në ato vise/Kala bese nëpër fise. /I njeh koha dhe Grika/Mihët, Manrekët e fisin Nika, /Fisin Miha, përshpirtbardhësinë/Nika i luftës, për lirinë, /Fisi Biba me bij të furtunës/ Balldjersit, sokola të punës. /Te çdo fis ka burra t’deut/Siç është Duka i Skënderbeut, /Prejsi, Daçi e Shehellarët, /Brez pas brezi si thesarët. / Në çdo kullë ndriçim masati/Sofër drite ka dhënë Perhati”... etj. Poezia e tij epike gurgullon me intonacione burrërore dhe vjen vetvetiu si frymëzim edhe përmes kujtesës, edhe përmes njohjes me kontaktet e sotme, nëntekstualisht poeti bën thirrje se këto kulla nuk duhen braktisur, ato janë vlera, jo vetëm të rralla etnografike që dëshmojnë për shpirtin artist të gjyshërve, por, mbi të gjitha, për virtytet e larta luftarake, për shpirtbardhësinë aristokratike e për thellësinë e mendjes së të parëve tanë. Ai i këndon birit të Manasdrenit, Qafë Murrës dhe Katër Grykëve, Liman Jakup Ballës, që ra në luftë kundër serbëve; Lurës heroike e mentare, Lurës së vllaznimit: “Në majë të Kunorës/ Lind në çark të martinës, /Bijt e Dom Nikollës, / flakë e vetëtimës”; martirit nacionalist Bilal Kola: “Kulla e Kolës Dejën ka vlla, /Në luftë me turq e luftë me shkja, /Në flakë u dogj prej gjermanit/ Kulla e Kolës-e Bilalit”; Matit të barotit, sa e sa luftëtarëve dhe fiseve të forta, për të gjithë ato cilësi të spikatura që përmendëm më lart e që lexuesi do t’i gjejë në libër.

Një numër jo i pakët poezish në këtë vëllim u kushtohen njerëzve të ndryshëm, personaliteteve të artit e të shkencës, të cilët poeti i ka njohur ose jo, si: për Kadarenë, Agollin, Albert Vërrinë, Fran Vukajn, Naim Plakun, Lefter Çipën, Ali Podrimen, Flora Brovinën, Gjokë Becin, Fadil Krajën, Gëzim Krujën, Sherif Dervishin, Vilson Blloshmi, Genc Lekën, por edhe për luftëtarë të ndryshëm, siç është minipoema për Kasem Dibrën, një krijim mjaft dinjitoz me një ritëm tirtean; por edhe për shokë e miq si Hasan Frangu e Ferit Fixha, Llesh Ndue Gjokën e Kaftallit të Kashnjetit (Mirditë), Fatmir Delishi, Skënder Abaz Gjucin e Macukullit të Matit. Mevludi ndryshon nga shumica e poetëve që, pasi e lexojnë krijimtarinë e mikut, nuk shqiptohen, por e lënë atë në heshtje, edhe pse në heshtje e pëlqejnë. Ai është entuziast për shokun, bën vlerësime dhe nderime, arrin ta kuptojë të bukurën te shoku dhe ta deklamojë duke treguar tiparet e një artisti të vërtetë që ego të vetme ka punën. Në poezinë e vet të përkushtimit ai portretizon secilin me mjete adekuatë të shprehjes, i shikon njerëzit, për të cilët shkruan, me dashuri, dhe këtë portretizim e skalit me identifikimin e tipareve specifike: “O Cukal me plot gjelbërim/ Tarabosh me lule prilli, Ti e rrite birin Gëzim, / Zaambël, me gjuhë bilbili. /Bunë moj, pse ngre valët/Rozafë, pse lëshon kujën/Nanë Shkodra i nisi vajet/ Për të madhin, Gëzim Krujën”. Vargje të tilla me plot përkushtim, ndjenjë, humanizëm e vështrim lartësues, do të gjejmë në poezinë për të cilën flasim, se dashuria për artin është në radhë të parë dashuria për krijuesit e tij. Poezia e Bucit është poezi e tonaliteteve të forta dhe e mjeteve shprehëse të pangarkuara, por gjithnjë të gjendura në vendin e duhur, ajo është poezi e vetvetishme, buron nga frymëzimi dhe përjetimi, jo nga kërkimi fals apo nga mendimi shterpëzues; si poezi e tillë ajo ngjit vetvetiu te lexuesi me ngrohtësi dhe ritëm të ëmbël, prej nga buron forca jetësore dhe integriteti i një krijuesi të frymëzuar. Për ta mbyllur këtë fjalë, në ndihmë na vjen një poezi e Ndrec Mustafës që ia kushton poetit Buci: “Mësues me zemër të madhe/Mjeshtër i madh i penës/l përket shkollës dibrane/Akademisë së mendjes”. Ndërsa poeti Zenel Anxhaku për të do të shprehë: “Në atë shtëpinë tënde të vjetër/Diku në periferi të Tiranës, /Një pllakë do vihet nga një brez tjetër/ Shenjë e mirënjohjes së pastër...” Edhe ky vëllim me poezi i justifikon plotësisht këto fjalë; ai është shenjë e pjekurisë dhe arritjeve të poetit, shenjë se, nëse i mban këmbët fort në truallin e vendlindjes, nëse nuk e humbet kujtesën ndaj traditave dhe dashurisë për natyrën, për njeriun, për të afërmit, poezia nuk shteron kurrë... Mevlud Buci është një nga shembujt më domethënës që e ilustron bukur –mirë këtë ide, dëshmi e pakundërshtueshme e së cilës është edhe ky vëllimi freskët poetik.

Shumë skuadra të superiores i kanë vënë syrin djaloshtit të talentuar për ta pasur si lojtar të vetin, por ndoshta mund ta shohim shumë shpejt dhe me ndonjë skuadër të huaj.

Katër breza sportistësh të familjes Skuka

Nga OSMAN XHILI

Lutfi Skuka ishte sportisti i parë i kësaj dinastie sportistësh të shquar dhe nuk kemi të dhëna nëse kishte të tillë para tij. Thuhet që ishte një futbollist mjaft i talentuar, përderisa luante si titullar me ekipin e Tiranës. Dy djemtë e tij, Esati dhe Arjani ndoqën rrugën e babait të tyre. E dinin që ishte e vështirë dhe e mundimshme, por dhe e bukur e magjike. Ata zgjodhën role të ndryshme në fushë, Esati duke mbrojtur portën, kurse vëllai si bombardues e shënues në të.

Esat Skuka e kish filluar që herët futbollin, por kur ishte akoma në pedagogjike, ra në sy si një sportist i talentuar. Pas mbarimit të saj, ai luajti për gati dhjetë vjet me ekipin dibran, duke u bërë shpesh protagonist i fitoreve. Më vonë Esati largohet nga ekipi, por jo nga sporti. Fillon punë si mësues në Maqellarë dhe tani falë pjekurisë që kishte fituar ndër vite, vihet në rolin e trajnerit. E krijon nga fillimi grupin e volejbollit me vajzat e gjimnazit dhe arrin suksese, që vështirë do ti kishte besuar dhe ai vetë. Ky grup vajzash përfaqësuan Dibrën dhe fituan titullin kampion në spartakiadën e organizuar në Kukës.

Padyshim që ai do t'i kushtonte kujdes dhe vëmendje dhe futbollit për ta përçar tek brezat e rinj. Për shumë vite krijon ekipe zinxhir të futbollit dhe rezultatet pozitive nuk munguan dhe këtu. Ja, kështu e deshi Esat Skuka sportin dhe jo vetëm futbollin, por gati të gjithë llojet e tij, duke u bërë një shembull për tu ndjekur nga brezat e rinj. Ai ndërroi jetë pa mbushur akoma 70 vite, kur kishte akoma për ti dhënë familjes e shoqërisë.

ARJANI

Esat Skuka do të ndjehej mjaft i plotësuar, kur shihte Arjanin djalin e tij, të ngjiste shkallët magjike të sportit. Por dhe pse luante mjaft mirë futbollin, atë e joshi dhe bëri për vete atletika, mbretëresha e sporteve. Që në shkollë tetëvjeçare ra në sy talenti i tij për garat e vrapimit, sidomos ato të gjatësisë, 800 dhe 1500 metra. Gati për një vit do të ishte pjesë e ekipit të Korabit në atletikë, ku dhe pse i ri konkurronte me të rritur pa asnjë kompleks inferioriteti. Vetëm një vit vazhdoi këtu, se më pas konkurroi e fitoi shkollën e mjeshtërisë sportive në Durrës. Medaljet, fama e suksesi e ndjekin në çdo hap djaloshin, që e dashuronte shumë atletikën. Asokohe Arjani ishte vetëm 19 vjeç dhe nuk e pati të vështirë të përfshihej e të fitonte dhe në gara akoma më të gjata si 3000 dhe 5000 metra. Në harkun kohor të dy viteve ai arrin të fitojë dy kupa kombëtare, një në Vlorë e një në Durrës.

Viti 1990 do të mbetet i paharruar për Arjanin. Nuk flasim për ngjarjet politike dhe kthesën që mori Shqipëria drejt demokracisë. Jo, ishte thjeshtë një ngjarje që kishte lidhje gjithnjë me atletikën. Një shqiptaro amerikan donte të organizojë e të financojë një garë maratone, me atletët më të mirë të Shqipërisë. Itinerari do të ishte me nisje nga Vollga në Durrës dhe do të përfundonte në sheshin Skënderbej në Tiranë, me një gjatësi plot 45 kilometër. Ishin gjithsej diku tek 35 atletë. Arjani kujton se ishte kohë vjeshte dhe gjithë ditës ra një shi i dendur. Shiu dhe lodhja e bënë të vetën dhe shumë atletë e lanë garën përgjysmë. Disa hipën nëpër autobusë e disa në ambulancat shoqëruese dhe më pak se gjysma e tyre arritën ta mbarojnë garën. Arian Skuka, stoik, i fortë



Arjani

dhe i vendosur donte fitoren me çdo kusht. Ai vraponte pa parë pas nëse e ndiqnin nga pas, kurse para tij nuk shihte njeri. Ai ishte heroi i ditës, maratonomaku i legjendës dhe i lashtësisë, që sillte lajmin e fitores. Hyri i pari në Tiranë, në sheshin Skënderbej, duke ndalur kronometrin në tre orë e 37 minuta. Organizatorët kishin vendosur dhe shpërblime për tre vendet e para, respektivisht 300, 200 dhe 100 dollarë, para që fituesit nuk i morën kurrë, siç do të ndodhte më vonë dhe për shumë gjëra të tjera. Arjani kujton se këmbët gati iu drunjëzuan dhe për një javë mezi e mori veten.



Xhuljani

Esat Skuka do të ndjehej mjaft i plotësuar, kur shihte Arjanin djalin e tij, të ngjiste shkallët magjike të sportit. Por dhe pse luante mjaft mirë futbollin, atë e joshi dhe bëri për vete atletika, mbretëresha e sporteve.

Mosha bën të vetën dhe Arjani ka 30 vite që punon si mësues i edukimit fizik në shkollën e Majtarës. Dhe pse në kushte jo shumë komode, ai ka ngritur e ka punuar me ekipe volejbollit e futbollit, duke fituar kupa e trofe, pa harruar atletikën, që aq shumë e deshi në rininë e tij.

XHULJANI

Është brezi i katërt i familjes Skuka që ka ndjekur rrugën e sportit, që nga stërgjyshi Lutfiu, gjyshi Esat dhe baba Arjani. Ishte vetëm shtatë tetë vjeç, kur gjyshi Esat e merre në stërvitje me grupin e të rinjve, që kishin dyfishin e moshës së tij. Ai habitej me mrekullitë që mund të bënte njeriu me atë top të rumbullakët, duke e lëmuar, duke e përkëdhelur, duke dribluar me të e së fundmi duke gjuajtur në portën e mbrojtur nga një gardian i hekurt. Më pas vinte fjala "gol", që bënte të hidheshin përpjetë lojtarë e tifozë, të gëzohej një palë e të hidhërohej pala tjetër.

Pasi mbaroi tetëvjeçaren djaloshi u hodh në Francë për të provuar fatin. Ky shtet me

kulturë, me ekonomi e me plot histori i fali shumë gjëra djaloshtit me emrin Xhuljo. I dha gjuhën frënge, nënshtetësinë franceze dhe klasin për të qenë një lojtar i spikatur e brilant. Erdhi në Shqipëri për të ndenjur pak kohë me familjen, por për shumë kohë mbeti i lidhur me vendlindjen, me familjen, me shoqërinë dhe me ekipin e zemrës, Korabin. Me këtë ekip kishte luajtur gjyshi Esat dhe xhaxhi Adrian për shumë e shumë vite me radhë.

Ka katër vite që Xhuljo luan me Korabin, në qendër të sulmit të tij. Shumë i fortë fizikisht, shumë inteligjent dhe nuhatës i mirë para porte, ai po bëhet një rrezik serioz për trajnerët dhe mbrojtjet kundërshtare. Për sezonin 2018 – 2019 ka shënuar plot 24 gola. Vitin e kaluar bëri një tripletë me Veleçikun dhe para pak javësh bëri të njëjtën gjë me skuadrën e Vorës. Ishte po ky lojtar brilant që shënoi golin ndaj Tiranës kampione, duke e eliminuar nga gara e mëtejshme për kupë.

Shumë skuadra të superiores i kanë vënë syrin djaloshtit të talentuar për ta pasur si lojtar të vetin, por ndoshta mund ta shohim shumë shpejt dhe me ndonjë skuadër të huaj.

Natyrisht që Xhuljano Skuka dëshiron të veshë fanellën e ekipit kombëtar dhe shpresojmë që një ditë kjo gjë të bëhet realitet. Falë këtij talenti dhe punës në grup, Korabi është pretendenti kryesor për të shkuar në superiore. Nuk dimë nëse ka pasur sportistë para Lutfiut, siç nuk dimë nëse do të ketë të tillë pas Xhuljanit, por dhe me këta katër breza sportistësh, familja Skuka ka siguruar një vend nderi në historikun sportiv të Dibrës.

Natyrisht që Xhuljano Skuka dëshiron të veshë fanellën e ekipit kombëtar dhe shpresojmë që një ditë kjo gjë të bëhet realitet. Falë këtij talenti dhe punës në grup, Korabi është pretendenti kryesor për të shkuar në superiore. Nuk dimë nëse ka pasur sportistë para Lutfiut, siç nuk dimë nëse do të ketë të tillë pas Xhuljanit, por dhe me këta katër breza sportistësh, familja Skuka ka siguruar një vend nderi në historikun sportiv të Dibrës.

printime dixhitale
me ngjyra dhe bardh e zi

shpejtësi | cilësi | çmime të favorshme
libra | broshura | revista | fletëpalosje
katalogë | kalendarë | postera | ftesa etj.
duke filluar nga 1 kopje e vetme

për informacion: mbbotime@gmail.com / Cel. 069 20 68 603

Mjeku është mjek, por ai është njeri. Ai është i vdekshëm vetë dhe, me gjithë përpjekjet e tij, ai në shumë raste nuk mund ta zbraps vdekjen edhe te të tjerët...

mendime

Mjeku enciklopedist Ramazan Buci

Nga prof. ELMAZ ELTARI

Unë e prita me gëzim, kur dr. Ramazan Buci, një nga studentët e mi, më solli dy libra: jetëshkrimin e vet “Një jetë për jetët e të tjerëve”, shkruar nga shkrimtari Xhafer Martini, dhe një libër origjinal shkencor me titull “Përballë sfidave të kohës”. Ramazan Buci ka qenë një nga studentët më të mirë që kam mësuar në jetën time. Unë kam patur rastin të jem pedagogu kujdestar i grupit të 16-të, ku bënte pjesë dhe Ramazani, i cili ishte edhe sekretar i rinisë, por edhe anëtar i komitetit të rinisë Fakultetit. Ndoshta ishte dhe meritë e Ramazanit që ky grup ishte aq i këndshëm. Ramazani kishte, gjithmonë, përkushtimin për t’i ndihmuar shokët e shoqet, duke treguar gatishmëri për të dhënë më shumë se sa lejohej, si p.sh. në sallën e provimit, ku ishte rigorozisht e ndaluar. Kështu ndodhi në provimin e filozofisë, ku pedagoget në vend që ta përjashtonin nga provimi e vlerësuan gabimisht me notë negative pavarësisht përgjigjes së tij, duke mos e ditur me çfarë studenti kishin të bënin. Ai duke shfrytëzuar gabimin e pedagogëve, akohet tek shefi katedrës së filozofisë së universitetit dhe dekanit të fakultetit të asaj kohe dhe në prani të tyre sfidon gjithë pedagogët e katedrës së filozofisë së fakultetit, duke u kërkuar provim me komision. Ramazani ishte një student me guxim profesional, kurajë civile, me ambicie për të ditur gjithçka për të ecur përpara, për të progresuar dhe që lexonte përveç librave të fakultetit edhe letërsi artistike. Pra, ishte një student i admirueshëm!

Ramazani ishte i pari që ngrinte dorën për t’u përgjigjur në mësim, ai kishte guximin që të ishte i pari për të provuar të bënte procedurat diagnostike terapeutike dhe ekzaminimet e ndryshme në orët e praktikave studentore. Jam befasuar kur ish studentë të mi, bashkëkohës të Ramazanit, më thoshin që këto procedura, madje edhe qepje kirurgjikale të vështira në raste aksidentesh, ai i bënte dhe në spitalin e zonale, ku ka punuar. Ai, në bashkëpunim me shefin e laboratorit të spitalit Peshkopi, kishte arritur të kualifikonte laboranten e spitalit zonal të bënte edhe analizën e likuorit cerebrospinal, të cilën nuk e bënte atëherë asnjë mjek fshati, se tani as që mund të imagjinohet.

Ramazani kishte kurajën që në mbledhjen e organizatës së partisë Fakultetit, të kritikonte profesorë të ndryshëm, në prani të sekretarit të byrosë dhe zëvendës ministrit të shëndetësisë për shkelje të ndryshme, sa mund të bëheshin atëherë, pa iu dridhur aspak qerpiku, duke iu përgjigjur me të njëjtën monedhë edhe insinuatave kërcënuese të ndonjërit. Ai kishte kurajën që, në prani të ministrit të shëndetësisë së kohës, në një sallë me 300 studentë të kritikonte tekste të ndryshme mësimore të profesorëve, madje deri edhe propozime për heqje nga qarkullimi. Megjithëse Ramazani ishte student i zgjuar dhe mbaroi shkëlqyer fakultetin, ai nuk mori “Medalje Ari”, sepse në qoftë se profesori mendonte ta vlerësonte me notën nëntë dhe i thoshte që të vijë të riprovohet në një moment të dytë për të marrë notën dhjetë, ai nuk pranonte, ashtu siç kishte studentë që jepnin provim dhe deri në katër herë vetëm e vetëm që të merrnin dhjetë.

Për të gjitha këto vlera që kishte Ramazani, pas mbarimit të vitit të pestë unë i propozova që të fillonte punën si pedagog në fakultet, në katedrën e sëmundjeve infektive. Mirëpo Ramazani nuk pranoi për arsye se përveç prindërve, ai kishte dhe shumë vëllezër e motra, të cilët kishin nevojë për të dhe prisnin me padurim të kthehej në Dibër. Dëshira e tij ishte të punonte si mjek specialist në spitalin e Peshkopisë, i cili atëherë ishte një spital me reputacion të mirë.

Në monografinë e shkrimtarit Martini tregohet për punën e palodhur të Ramazanit në Fushë-Alie, ku ai u emërua për herë të parë. Ishte mjek i ri, gjithë pasion dhe kulturë, me njohuri të thella, që vinte duke i zgjeruar çdo ditë, në saj të leximit të vazhdueshëm, të mos shkëputjes nga librat. Praktika në terren do ta ndihmonte formimin teorik dhe kështu Ramazan Buci vinte gjithnjë duke u kualifikuar dhe përsosur si mjek. Fushë-Alia e asaj kohe ishte një vend me një



Ramazan Buci

popull të zgjuar dhe bujar, por me probleme në sektorin e shëndetësisë të këtij lokaliteti, amulli dhe papërgjegjshmëri, duke filluar nga kuadrot drejtuese të partisë dhe të pushtetit.

Autori i librit e ka menduar mirë punën e tij para se të hynte për ta shkruar. Mjeti kryesor që ka zgjedhur Martini është paraqitja në lëvizje, si shprehje energjisë dhe dinamizmit të brendshëm të protagonistit. Edhe drurët nuk rriten, nëse nuk i lëviz era. Kësaj forme të menduari i janë nënshtruar tërë treguesit e përbërës të veprës.

Autori ka meritën e jashtëzakonshme që Ramazanin e ka paraqitur gjithnjë në arenë. Ramazani sot është bërë i njohur, me emër. Por, kjo famë nuk i erdhi për oxhaku, si thuhet, ajo u fitua me luftë. Autori shikon më thellë: autori dhe protagonist i tij sikur interferojnë te njeri-tjetri, por në mënyrë tjetër, së brendshmi, me bashkësinë e idealeve dhe qëllimeve. Ndryshe, autori nuk do ta paraqiste Ramazanin, të pa tolerueshëm me kuadrot kryesore të partisë dhe të pushtetit në lokalitet, madje i gatshëm për t’i sfiduar për çdo rast. Ramazani ishte i hidhur, ai krijonte një ankth intelektual për partiakët dhe pushtetarët injorantë. Ata nuk ndjeheshin mirë kur e shihnin.

Megjithatë, doktorin e ri në vend që ta çonin për specializim, e dërguan në Reç, zona më e thellë e rrethit të Dibrës, ku shikoje një hektar qiell. Fshatrat ishin shumë të përthyer dhe të shpërndarë. Niveli ekonomik i popullatës shumë i ulët, niveli shëndetësor po ashtu. Ishte spitali, materniteti, farmacia, por ata donin kuadro shëndetësorë që t’i vinin në efikasitet të plotë. Këtë punën Ramazani e filloi me zell të jashtëzakonshëm. E meritonin këta banorë fisnikë të jetonin më mirë. Kuadri shëndetësor, deri atëherë, ishte mbledhur aty në qendër të lokalitetit dhe pothuaj vegjetonte. Ramazani fryni edhe këtu si uragan spastrues. Ndau detyra që askush të mos ndihej pa punë. U hoq dorë tani nga puna opshe, secili kishte detyrën e vet dhe përgjegjësinë e vet. Në qendër mbetën një pjesë e vogël e kuadrove shëndetësorë, më të domosdoshmit, të tjerët u shpërndanë në të gjithë fshatrat. Filloi një mobilizim i jashtëzakonshëm që nuk ishte parë ndonjëherë. Fshatarët ishin të mirë, buajrë dhe me sedër të madhe. Kjo që një mbështetje shumë e madhe për Ramazanin, që ai e shfrytëzoi në dobi të punës. Në Reç ishin ndryshe edhe drejtuesit e partisë dhe të pushtetit lokal. Ata e përkrahën Ramazanin, sepse panë tek ai mjekun e devotshëm që nuk kursente asgjë për shëndetin e popullit. Ramazani diti të lidhej me të gjithë strukturat nga qendra deri në fshatin më të largët, i vuri ato në lëvizje dhe u krijua kështu një front i gjerë, i përbashkët, për ngritjen e një mjekësie të re, moderne, me aq sa e lejonin kushtet e asaj kohe. Punë shumë e mirë u bë edhe për mjediset e jashtme, oborret, shtëpitë, rrugët, sheshet që të kishte kudo pastërti. Tani edhe në rreth kishin ardhur në drejtim kuadro shëndetësor me mendësi të reja.

Ndër këta duhet përmendur dr. Nazmi Koçi, shefi i Shëndetësisë, siç quhej atëherë, që kishte nderim dhe respekt për Ramazanin. Nazmiu përfaqësonte vijën liberale të Partisë së Punës.

Në vitet 1989-1991, Ramazani u dërgua për specializim për pediater në Tiranë. Ndërkohë, shogen e tij të jetës që kishte punuar si laborante në Reç, e transferuan me këtë detyrë në Peshkopi. Autori i librit Xhafer Martini na e përshkruan me ngrohtësi këtë grua trime, me kurajë, e cila që një mbështetje e fuqishme për Ramazanin.

Me mbarimin e specializimit për pediater, Ramazanin e caktuan në repartin e pediatriisë, në Peshkopi. Aty kishte edhe mjekë të tjerë të mirë dhe me përvojë, por puna e Ramazanit ra menjëherë në sy. Mjeku tjetër pasionant, Filip Çfarku, thotë për Ramazanin: “Unë kam pasur fatin të punoj me një mjek si Ramazan Buci. Kishte cilësi të mrekullueshme si njeri, por edhe si specialist. Dallohej në përcaktimin e shpejtë dhe të saktë të diagnozës për të sëmurët, fillonte menjëherë një mjekim të shpejt dhe efektiv. Fitonte edhe mbi sëmundjen duke ia prerë asaj shfaqjen e plotë. Nuk kishte problem sado të vështirë që Ramazani të mos i dilte në krye. Aty ku ishte Ramazani, ishte besimi në fitore, edhe kur “armiku” ishte i padukshëm dhe i rrezikshëm. Ramazani nuk i mbyste të sëmurët me ilaçe. Ai dinte çfarë duhej përdorur në mjekim, duke synuar ilaçet më vepruese dhe më të domosdoshme që në çastin e parë të kontaktit me të sëmurët.”

Ramazani, pastaj e bënë drejtor të Kujdesit Parësor Shëndetësor të rrethit të Dibrës. “E gjeta fare të rrënuar këtë institucion, - thotë Ramazani. Ishin ngjarjet e 97 që kishin shkatërruar gjithçka. Madje as në ndërtesë nuk na linin të hynim “pronarët” e tokës. U desh ta hapnim derën me zor, të futim ndonjë tryezë dhe ndonjë karrige më një zyr, pastaj “të pushtonim” edhe zyrat e tjera. Me një fjalë e filluam nga hiçi.” Mungonte



Me prof. Elmas Eltarin

fare kontrolli në spital, shkolla, çerdhe, lokale, restorante, fabrika dhe në të gjitha qendrat e punës dhe të prodhimit. Vetëm Ramazan Buci, me energjinë dhe dinamizmin që e karakterizon, mund t’ia dilte mbanë kësaj pune. Në krye të këtij institucioni, sidomos në atë kohë, duhej një trim e guximtar, por edhe një profesionist i shkëlqyer si Ramazani. Nuk ia bënë nder emërimin si drejtor, ia caktuan si detyrë që nuk i dilte zot askush. Ramazani edhe këtu triumfoi. Brenda një vitit dukej sikur ky sektor nuk që prekur nga asnjë fazë shkatërrimtare. Gjithçka u bë e re, funksionale, më mirë se më parë.

Ramazani u mor edhe me politikë dhe këtu ai ka qenë i suksesshëm. Por, unë nuk do të merrem me këtë anë të personalitetit të tij. Mua më intereson çfarë ka bërë ai për mjekësinë shqiptare. Mbas i transferua nga Peshkopi erdhi mjek pediater në Laprakë, një nga zonat më të mëdha dhe me popullsi të dendur. Nga Peshkopia u përcoll në mënyrë madhështore: popull dhe personel shëndetësor e përcollën deri në afërsi të Bulqizës. Adhuronin dhe i shprehnin dashurinë e mirënjohjen njeriut të tyre që kishte punuar aq shumë për shëndetin e popullit. Ramazani, edhe në Tiranë, ra menjëherë në sy si specialist i zoti. Edhe këtu ishte i pamposhtur. Ishte edhe pak më i ri, por shumë më tepër me energji, me vendosmëri. Nuk kishte njeri që mund ta shikonte nga poshtë lart. Përkundrazi,

e shikonin me adhurim pak të ndrojtur këtë “përbindësh”, që nuk kishte prehje. Ramazani ka forcë imponuese. Te gjithë krijuan bindjen që fëmija në dorë të tij ishte si në dorë të Zotit. Në qoftë se nuk mund të bënte dot gjë Ramazani, do të thoshte se fëmijës kaq ia kishte caktuar Zoti jetën. Ky është kulmi i besimit. Në saj të punës dhe të përkushtimit, Ramazani u bë edhe drejtor i kësaj qendre të rëndësishme shëndetësore. Ishte e pamundur që Ramazani të mos tregonte aftësitë e tij të veçanta edhe në këtë detyrë të re dhe me përgjegjësi. Puna është sa ta bësh, ka një thënie të mençur. Edhe ai mund të vegjetonte si drejtorët e tjerë para tij pa bërë asgjë të re dhe pa lënë asnjë gjurmë. Por, Ramazani i bëri popullatës së Laprakës një shërbim të madh: ai e rikonstrukttoi nga e para qendrën shëndetësore, duke i bërë godinës edhe një shtojcë të re. E zgjeroi, i dha më shumë dritë dhe hapësirë. Personeli shëndetësor tani e ndien veten me një frymëmarrje tjetër, shumë më lirë dhe në kushte komode. Investimi i rëndësishëm ka zgjidhur në radhë të parë përmirësimin e kushteve të nënës dhe të fëmijës. Më përpara në konsultorin e fëmijëve punonin tre mjekë dhe gjashtë infermiere, plus vaksinatorja në kushte shumë të papërshtatshme. Tani ato punojnë në kushte ideale.

Meritë e autorit Martini qëndron në faktin se ai nuk e ka dhënë Ramazan Bucin vetëm si mjek që ishte i lidhur ngushtësisht me specialitetin e tij. Po ta jepte kështu, figura e Ramazanit nuk do të dilte e plotë, mbasi ai është njeri me interesa të gjëra. Nuk është thjesht mjek, por doktor i shkencave. I tillë është bërë me një punë efikase, me të vërtetë shkencore dhe jo me ndonjë paçavure që fle sirtarëve të institucioneve. Puna e tij shkencore përfshihet në një vëllim të veçantë të Ramazan Bucit me titull “Para sfidave të kohës”. Por për këtë do të kemi rast të flasim më poshtë. Këtu është e nevojshëm të theksojmë se në monografinë për Ramazanin ka edhe disa kapituj që për ndonjë monografi tjetër nuk do të kishte kuptim t’i përmendje. Autorit i rrinte mendja tek personaliteti kompleks i Ramazanit.

Një kapitull i çuditshëm është ai me titull: “Poetët e mi të dashur”. Plotësohet kështu profili i Ramazan Bucit si një lexues i jashtëzakonshëm, si një njohës i letërsisë shqiptare dhe asaj botërore. Autori ka bërë mirë që ka vënë në këtë kapitull ajkën e poezisë botërore duke filluar me Pushkinin, Esenin e duke vazhduar pastaj me poetët më të mirë shqiptarë si Naim Frashëri, Noli, Kadare, Agolli, Fatos Arapi, Xhevahir Spahiu etj. Këtu del në pah jo vetëm fakti që Ramazani lexon shumë, por ai ka edhe aftësi për të përzgjedhur duke u ngritur në nivelin e një kritiku letrar, të një studiuesi të letërsisë. Ai ka edhe përgatitje estetike, kritike dhe studimore. Kjo del tek kapitulli ku janë renditur disa artikuj të Ramazan Bucit që nuk janë thjesht për të rejtat shkencore në fushën e mjekësisë, por edhe kritika letrare, studime e monografi që, kur i lexon, të ngjallin emocione të veçanta. Lexoni shkrimet “Ditari i një mjekut”, “Mbi librin “Shekspiri dhe Kanuni”, monografinë për Met Sula dhe të shihni që Ramazan Buci ngrihet në nivelin e kritikëve letrarë, madje shumë prej tyre i kalon.

Martini e ka zgjeruar më shumë diapazonin e shfaqjeve të personalitetit të Ramazan Bucit me intervistën e gjatë që zhvillon me të. Ka shumë prurje filozofike, ideologjike, pedagogjike, psikologjike, politike. Na shfaqet figura e një intelektualit me interesa të veçantë që, të gjitha së bashku, japin një personalitet tashmë të formuar në nivelin më të lartë. Autori i bën shumë pyetje protagonistit, pyetjet nga më të ndryshme, shumë interesante. Nga përgjigjet e këtyre pyetjeve bëhet ndoshta një libër i vogël me rreth pesëdhjetë faqe. Libri nuk vlerësohet nga numri i faqeve: në ato pak faqe është përmbledhur ajsa, e mendjes së njeriut. Ramazan Buci del si enciklopedi shëtitëse, si enciklopedi e gjallë. Rralla njerëz ka në jetë që të jetë kaq shumë dimensional. Ka njerëz që dinë mjaft në një fushë, kurse në fushat e tjera kanë verbërim të plotë. Vetëm sikur këtë intervistë të kishte bërë autori, unë, pa dyshim, mund të them se kishte rrokur personalitetin e Ramazan Bucit. Intervistat kanë shumë rëndësi.

(vijon në faqen 21)

Talenti i Caje Poleshit, i faktuar nga profesorët e saj dhe të gjithë ata që e njohin, i vuri vulë këngës së bukur dibrane të cilën e kultivon për më shumë se katër dekada.

Caje Poleshi, zëri i artë i këngës së pastër shqipe

Nga ARSIM KOLARI

Ishin fillimvitet '70-ta kur u riaktivizua shoqëria artistike e Zall Dardhës së Peshkopisë, në të cilën u shquan shumë artistë, këngëtarë e valltarë. Ndër më të shquarit, u përzgjodh adoleshentja Caje Poleshi. Ajo u lind më 6 shkurt të vitit 1957 në një familje me tradita të Zall Dardhës. Talenti i saj u çmua gjatë shkollimit të mesëm në Vlorë, ku kishte filluar të studiojë për mjekësi. Për veçantitë e zërit të saj emëltues, Caja u zgjodh si solistja më e mirë e të gjitha shkollave të mesme. Kështu, u punësua si ndihmës mjeke në Zall Dardhë, ku u aktivizua me grupet artistike të vendit. Menjëherë, në vitin 1978 mori ftesë për t'u paraqitur në Festivalin Folklorik të Gjirokastrës me këngën "O mirë se na erdhe". Tekstin e punoi Naim Plaku dhe muzikën Përparim Tomçini. Kënga u bë një himn për një kohë të shkurtër, andaj presidiumi i Kuvendit Popullor e dekoroi me urdhrin "Naim Frashëri". E tillë vazhdon të jetë jehona e kësaj kënge edhe ditët e sotme. Fill pas këtij suksesi, Cajen e punësojnë në spitalin e Peshkopisë ku punoi për 8 vjet. Në ndërkohë, u aktivizua me ansamblin Dibra dhe estradën e Peshkopisë, ku nga viti 1980 për një vit, ka kryer kursin e kantos në Tiranë, me profesorë të shquar të artit shqiptar, si Çesk Zadeja, Luçie Miloti, Naile Hoxha etj. Në këtë kohë, u antarësua në Ansamblin e Shtetit me të cilët merr pjesë në shumë shfaqje artistike. Me ansamblin "Migjeni" mori pjesë në "Dekadat e Majit", ku u afirmua edhe më gjerë me publikun.

Në vitin 1982 merr pjesë në Festivalin e Këngës së Përpunuar qytetare në Tiranë me këngën "Oj zogo". Kënga "Oj zogo" është këngë dasme dibrane, e përpunuar nga artisti i popullit Çesk Zadeja, me të cilën Caja mori vendin e dytë. Në vitin 1983, përsëri në Festivalin Folklorik të Gjirokastrës mori pjesë me këngën "Hanza e Korabit" me tekst të Naim Plakut dhe muzikë të Përparim Tomçinit.

■ Në vitin 1982 merr pjesë në Festivalin e Këngës së Përpunuar qytetare në Tiranë me këngën "Oj zogo", këngë dasme dibrane, e përpunuar nga artisti i popullit Çesk Zadeja, me të cilën Caja mori vendin e dytë. Në vitin 1983, përsëri në Festivalin Folklorik të Gjirokastrës mori pjesë me këngën "Hanza e Korabit" me tekst të Naim Plakut dhe muzikë të Përparim Tomçinit. Me këtë këngë u akordua me Urdhrin "Naim Frashëri".

■ Ka bashkëpunuar me autorët e teksteve dhe muzikologët më të mirë shqiptarë siç janë Çesk Zadeja, Gjok Beci, Naim Plaku, Agim Doçi, Përparim Tomçini, Edmond Zhulali etj. Albumi i realizuar vite më parë rezultoi tepër i suksesshëm, duke pasur shpërndarje të mëdha, ku ishin të përfshira mbi 10 këngë dibrane.



Me këtë këngë u akordua me Urdhrin "Naim Frashëri". Me ansamblin "Dardania" mori pjesë në shumë koncerte në Amerikë e Evropë, ku duartrokittjet ishin të panumërta kur zëri i Cajes pushtonte skenën.

Ka bashkëpunuar me autorët e teksteve dhe muzikologët më të mirë shqiptarë siç janë Çesk Zadeja, Gjok Beci, Naim Plaku, Agim Doçi, Përparim Tomçini, Edmond

Zhulali etj. Albumi i realizuar vite më parë rezultoi tepër i suksesshëm, duke pasur shpërndarje të mëdha, ku ishin të përfshira mbi 10 këngë dibrane.

Janë me qindra dhe mijëra daljet skenike të saj nëpër mbarë botën, andaj, muajin e kaluar nga Presidenti i vendit u dekorua me titulli "Mjeshtër i madh" për meritat të veçanta në artin e këngës burimore shqipe.

Vlerat e saj janë të shumta, mbi të gjitha ajo ka një zemër aq të madhe, duke rrezatuar vetëm pozitivitet te njerëzit.

Talenti i saj i faktuar nga profesorët e saj dhe të gjithë ata që e njohin, i vuri vulë këngës së bukur dibrane të cilën e kultivon për më shumë se katër dekada. Jeton dhe vepron në Tiranë, bashkë me familjen e saj të mrekullueshme.

Mjeku enciklopedist Ramazan Buci

(vijon nfa faqja 20)

Fundja, gjithë jeta është: pyetje e përgjigje, problem e përgjigje.

Kapitulli i fundit i librit për Ramazanin është ai me titull "Enciklopedia". Për çfarë enciklopedie bëhet fjalë? pyet me të drejtë lexuesi.

Ramazan Buci, shkruan autori, ka në arkivin e tij 25 vëllime me nga 600-700 faqe me format të madh secili, që bëjnë rreth 20. 000 faqe material arkivor e jo arkivor për të gjitha fushat e jetës. Materialet kanë vlerë referimi. Tematika është shumë e gjerë. Në vëllimin e 25-të të Ramazanit, po përmend vetëm disa tematika: "Prejardhja e shqiptarëve nga Pellazgët", "Pellazgët janë i vetmi popull i identifikuar në Evropë", "Harta e Shqipërisë Etnike prej lashtësisë e deri në ditët tona", "Heraldika e Principatave Shqiptare", "Trungu i gjuhës shqipe në gjuhët indoeuropian", "Hartat e vendndodhjeve të ilirëve", "Deri ku flitej gjuha pellazge", "Shqipja si gjuha më e vjetër e botës", "Pellazgët shpikën shkrimin dhe alfabetin e parë", "Origjina e flamurit tonë", e shumë e shumë të tjera. Te vëllimi tre do të gesh artikuj pa masë për figura të shquara të njerëzimit, si: Remarku, Hemingueji, Brehti, Xheferson, Bill Klinton, Bushi II, Çurçilli, Hygoi, Anjshajtini, Tolstoi, Dikensi, Akuini, Van Gogu, Jobs, Frojdi, Edisoni, Monro, Darvini, Niçe, Hajdeger, e shumë e shumë të tjerë.

Përveç kësaj literature, Ramazani a ka edhe një bibliotekë shumë të pasur, prej 1.000 vëllimesh, shqip dhe në gjuhë të huaj, bibliotekë që fillon në një dhomë të shtëpisë së tij të madhe

dhe vazhdon në dhoma të tjera ku nuk le qoshe pa u futur.

Kështu, është konceptuar figura e Ramazan Bucit, prandaj monografia e zotit Martini nuk është thjesht "profesionale".

Ramazan Buci është shkencëtar i shkencës së mjekësisë në kuptimin më të plotë dhe më të gjerë të fjalës. Për këtë dëshmon libri i tij shkencor, me format të madhe, me rreth katërqind faqe, me titull "Përballë sfidave të kohës". Edhe në këtë libër ka dorë Xhafer Martini por kësaj here si hartues i parathënies dhe si redaktor. Është një parathënie e rrallë në llojin e vet dhe nuk i iket pa bërë citime prej saj, qoftë edhe me thëniet aq të bukura, si: "Nuk ka mjekësi që të shërojë atë që nuk e shëron dot lumturia", dhe "Mjekësia është si një adoleshente kurioze, e pasionuar dhe e guximshme që rritet nëpërmjet sfidave të panumërta".

Përmbledhja me shkrimet shkencore është një ëndërr e madhe e çdo mjeku. Në këtë përmbledhje ka edhe shkrime të tjera: për politikën, për letërsinë, për kulturën etj: Karakteri enciklopedik që e kemi theksuar më lart, veç vjen duke u përforcuar. Natyrisht që shkrimet mjekësore i japin tonin librit, por edhe shkrimet e tjera për artin dhe kulturën të japin njohuri dhe kënaqësi të madhe. Dy shkrime nga më të bukurit dhe nga më interesantët janë: "Terapia e dehidrimit orale një perspektivë globale", dhe "Autizmi". Këto janë shkrime për mjekët, jo për masat e lexuesve. Janë tamam shkencorë dhe që duhen zbërthyer për të përfutur. Shumë shkrime lidhen me sëmundje të ndryshme, me shërbimin shëndetësor, me kualifikimin mjekëve të familjes

dhe infermierëve, me kulturën shëndetësore të prindërve, me marrëdhëniet pacient-mjek etj. Trajtim të thellë, por njëkohësisht të hapur për t'u kuptuar nga të gjithë, kanë sëmundje të tilla, si: astma bronchiale, autizmi, stresi e të tjera. Çdo lexues për këto sëmundje ka lexuar dhe ka dëgjuar diçka, por, kur lexon dr. Ramazanin se si i përshkruan ato, bindesh se arti i paraqitjes së shkencës me atë gjuhë dhe me ato mjete që ta bëjnë atë të asimilueshme nuk zotërohet nga të gjithë. Shkrimet e Ramazanit kanë këshilla praktike se janë si rezultat i përvojës së tij të madhe në fushën e mjekësisë. Zakonisht, mjekët, edhe kur kanë njohuri të thella, nuk kanë aftësi për t'u shprehur as me gojë e as me shkrim me mënyrën më të thjeshtë të mundshme. Këtë dr. Buci e ka shumë organike. Ai bëhet i kuptueshëm, pa rënë në thjeshtësime bajate dhe në vulgarizma. Kështu, si shembull kur lexon shkrimin për stresin, lexuesi aftësohet për të shmangur stresin tek vetja dhe tek të tjerët. Jeta është plot stresi. Një pjesë i "kultivojmë" vetë, ne shpesh e rëndojmë gjendej tonë dhe e bëjmë stresante në vend që të punojmë për të kundërtën. Stresi luftohet, ashtu si edhe acarohet.

Urgjencat pediatrike duket sikur është një shkrim që u drejtohet vetëm mjekëve të specializuar- pediaterve. Në të vërtetë ka vlerë për të gjithë. Prindërit duhet të bëhen të gjithë pak a shumë "pediatër", çdo njeri duhet të ketë njohuri të tilla, se secili prej nesh mund të ndodhet në atë pozicion që të japë ndihmën e parë.

Një shkrim shumë interesant është ai me titull: "Skandalistika, litigimi dhe pasiguria mjekësore".

Mjeku është mjek, por ai është njeri. Ai është i vdekshëm vetë dhe, me gjithë përpjekjet e tij, ai në shumë raste nuk mund ta zbraps vdekjen edhe te të tjerët.

Me seriozitet, me aftësi dhe me qëllim për të ndikuar në mbarë shoqërinë trajtohet problemi i mjekut të familjes. Mjeku i familjes, që ka barrën kryesore në sistemin tonë shëndetësor, në mos qoftë i përbuzur, është i poshtëruar, i nënvlerësuar, si për rrogën që merr, si për pozicionin moral që ka në shoqëri.

Sistemi shëndetësor në Shqipëri është nga më të prapambeturit, jo duke e krahasua me sistemet shëndetësore në Europë e Amerikë, por edhe të vendeve fqinje, thotë autori në librin e tij. Kjo dukej si sakrilegj para një viti, por me rënien e pandemisë, u kuptua se me të vërtetë mjekësia jonë nuk është në gjendje të përballojë asgjë të rëndësishme. Duke analizuar sistemin tone shëndetësor, dr. Ramazan Buci ndalet tek infermieristika, si një formacion më vete që përbën një hallkë të rëndësishme pa të cilën zinxhiri i shërbimit tone shëndetësor këputet.

Edhe në ato fjalimet që konsiderohen si punë rutinë, Ramazani thotë gjera mbresëlënëse. Kur iu dha titulli "Nderi i Qarkut" të Dibrës ai me sinqeritet tha se ky titull nuk është vetëm imi se u përket të gjithë mjekëve të shquar të Dibrës, si: Basri Neziri, Rrahim Gjika, Qemal Çadri, Vehbi Keta, Selami Nazifi, Ahmet Alliu, Ahmet Shahinaj, Filip Cfaru e shumë e shumë të tjerëve.

Natyrisht, punimi shkencor më i thellë është ai që ka të bëjë me marrjen e titullit dr. i shkencave: "Aspekte epidemiologjike, klinike, terapeutike..." , që duhet zbërthyer dhe thelluar në leximin e tij se është nga gradat e vetme shkencore që shërben për punë dhe mbështetje, duke dhenë zgjidhje problemeve që kanë të bëjnë me këtë sëmundje.

Tafë Dauti i Sllatinës

Nga **SHAQIR SKARRA**

Kemi shkruar gjithmonë për figura e njerëz që bënë vërtet histori në Dibër dhe jashtë saj , kemi bërë monografi të ndryshme e mjaft portrete të njerëzve të njohur dhe pa njohur por që kemi lexuar, kemi gërmuar në kujtimet e të tjerëve. Dhe pa dyshim që është nisma ma e bukur e pas viteve nëntëdhjetë.

Mjaft figura të njohura por të mohuara e harruara i kishte mbuluar pluhuri i harresës kolektive. E një personazh historik dhe emblematik siç është Tafë Dauti i Sllatinës duhej të ishte shkruar më herët, duhej të ishte vendosur të paktën në altarin e historisë së Ujemujës.

Tafa lindi në fshatin Sllatinë në një familje të njohur për patriotizëm e atdhedashuri , në vitin 1909.

Nëse vërtet shkruhet e flitet se mikrorahina e Ujemujës është kurora ma e bukur e historisë në Dibër, këtë kurorë nuk e mori vetëm por me figura si Tafë Dauti e qindra e qindra të tjerë.

Për të shkruar për Tafë Dautin e Sllatinës, emblemen historike të krejt Ujemujës nuk ishte në fakt shumë e vështirë, as për vetë autorët të cilët e kishin gjysh, as për ne që dhamë vlerësimet tona. Për Tafën nuk kishim nevojë të gëmojmë nëpër arkiva, të futeshim nëpër skedat e bibliotekave, të takonim miq e shokë. Ai të paktën për brezin tim nuk ishte një emër anonim, një i pa njohur. Shumica shpreh bindjen se kanë patur fatin ta njohin nga afër, ta takojnë, ta urojnë apo ngushëllojnë, të pinë një kafe me të, të bëjnë një bisedë qoftë dhe sporadike. Tafë Dauti i Sllatinës ka jetuar në kohën tonë dhe mes nesh.

Historia , thonë se bëhet me pushkë në dorë, duke dhënë dhe jetën për lirinë dhe pavarësinë e atdheut, thonë se shkruhet me penë. Në fakt historia bëhet edhe me mendje e sofër, e njëri ndër to që bëri histori në të gjithë krahinën e Ujemujës është edhe Tafë Dauti i Sllatinës.

Në ato vite kur vendit i vinte era barot, kur pushka me gjalmë kërciste në male, kur shumica e djemve dhe vajzave kishin rrëmbyer armët e kishin dalë për liri, Tafë Dauti hapi portën e kullës dhe i priti krahëhapur këta trima. Kështu u bë shtëpia e tij në Sllatinë një ndër bazat kryesore të lëvizjes së madhe nacional-çlirimtare.

Dhe jo pak por partizanë të brigadës 18 sulmuese si dhe Shtabi i saj gjetën një strehë të ngrohtë, miqësorë dhe mjaft të sigurtë tek kulla e Tafë Dautit. Partizanë të plagosur, të sëmurë do të kalonin nga kjo kullë bujare e mikpritëse për në spitalin partizan i cili ishte afër si distancë. Jo vetëm mjekime të plagëve të vogla, ushqim, strehëm të sigurtë por në kullën e Tafë Dautit partizanët gjetën edhe veshmbathje të cilëve në ato vite u mungonin me shumicë. Udhëheqja e shtabit ka qëndruar me ditë të tëra në këtë kullë bujare në fshatin Sllatinë.

Para, gjatë dhe pas çlirimit sofra në kullën e Tafë Dautit rrinte shtruar, dera e kullës nuk u mbyll kurrë. Priste e përcillte miq të njohur e pa njohur dhe mos harrojmë se ishte një periudhë kohe kur varfëria ishte ulur këmbëkryq në votrat tona, por buka për mikun te Tafë Dauti gjithmonë rrinte shtruar. Vinin udhëtarë nga zona e Kalasë së Dodës, Luma por edhe Kosova. Tafë Dauti rrinte natën deri vonë zgjuar, priste mysafirë ti vinin në kullë. Një natë nëse nuk kishte mysafirë, Tafa mërzitej dhe u fliste djemve se do vinin udhëtarë nga zona e Kalasë së Dodës, Luma por edhe Kosova. Tafë Dauti rrinte natën deri vonë zgjuar, priste mysafirë ti vinin në kullë. Një natë nëse nuk kishte mysafirë, Tafa mërzitej dhe u fliste djemve se diçka nuk shkonte.

Të gjithë ato udhëtarë që bujtën një natë në kullën e Tafë Dautit, nuk kanë patur kohë të kthehen për së dyti, nuk kanë patur mundësi ta falënderojnë të zotin e kësaj kulle bujare e fisnike, por në biseda të ndryshme me miq e shokë pa tjetër që kanë shprehur vlerësimet më të larta duke e cilësuar si prototip i mikpritjes



dhe bujarisë shqiptare.

Sot nuk është nevoja të zgjatemi dhe të bëjmë portretin e Tafë Dautit, fjalët e tepërta siç thotë populli janë fukarallëk.

Portretin e tij e bëri vetë sa ishte gjallë se ishte njeri i veçantë, me virtyte më të larta njerëzore, i zgjuar, bujar dhe fisnik.

Ishte i vetmi në të gjithë mikrorahinën e Ujemujës që djemtë e tij punëtor dhe mjeshtër në përpunimin e drurit filluan partneritet me vetë ish kooperativën bujqësore, si në djegien e gëlqeres dhe përpunimin e drurit për nevoja të vetë kooperativës bujqësore. Kjo ishte një punë mjaft fitimprurëse për këtë familje të madhe patriarkale e shumë bujare e mikpritëse në Sllatinë.

Djemtë kishin përfutur shumë nga këshillat me mjaft vlere të Tafës dhe në këtë udhë të shtruar vite më parë po ecin dhe sot nipër e stërnipër të Tafë Dautit.

Në ato vite kam qenë i vogël, fëmijë, por ende e kam parasysh portretin e plotë të Tafë Dautit kur vinte në Shumbat, në lagjen time Hurdhë. Një trup i bëshëm, jo shumë i gjatë, me një veshje gjithë sqimë, karakteristike të zonës së Ujemujës; tirq të zinj me gajtana, koparane me kajuke, brez të kuq, këmbishë të bardhë me krah të gjerë e mitan. Qafës qosteku i orës së xhepit i dukej që larg e një shkop ma shumë e tundte se sa e mbante për tu mbështetur pasi ishte i fortë fizikisht .

Tafa vinte shpesh në Shumbat, vinte në lagjen time se kishte shumë miqësi në Shumbat. Tek Halit Skarra kishte martuar vajzën, Meleqen. Limanin, Likën, Saminin i kishte nipër. Po kështu edhe tek Idrizi, tek Rufati, tek Xhemali, Tafë Dauti ishte kudo i mirë se ardhur. Atë natë që vinte Tafa në lagjen Hurdhë mblidheshin burrat që para darke dhe e gdhinin gjithë natën me muhabet.

Ndodhte që në të njëjtën natë kishte ardhur edhe një mik tjetër tek Skarret. Në të shumtën e rasteve miku ngrihej bashkë me zotin e shtëpisë dhe shkonin atje ku ishte ulur Tafa. Ndodhte që dy veta në mëngjes ishin grindur, grindje ordinere e primitive, mbanin inat pak por në darkë nëse kishte ardhur Tafa diku, të dy që ishin grindur do të shkonin dhe askush nuk do ta kuptonte se ishin të zënë.

I tillë ishte Tafë Dauti, i zgjuar, me inteligjencë popullore, bujar dhe njeri fisnik. Gjithmonë gjatë gjithë jetës së tij u mundua vetëm të bashkojë njerëz jo të përçarjë.

Bisedonte rrjedhshëm Tafa, nuk ndërhynte kurrë kur flisnin të tjerët por as pranonte që t’ia ndërprisnin muhabetin. Nëse e kishte marrë vesh se Tafë Dauti ishte për darkë në Hurdhë

do të vinte edhe Mane Kacani nga Fushë-Alia, do të vinte edhe Selë Dika nga Shumbati. Oda do të mbushej plot e muhabeti niste rrjedhshëm.

Më ka ndodhur dhe mua të jem njëherë tek Tafë Dauti. Djali i tij Sufa kishte marrë për grua vajzën e Nuz Lekës. Unë e kisha teze, se dhe unë nip tek Leket në Shumbat jam. Aty pashë nga afër se Tafë Dauti respektin mikut ia bënte njëlloj, si mua që isha fëmijë, si tjetrit që ishte i moshuar, se kur dola, mbaj mend fare mirë se u ngrit në këmbë e më përcolli deri tek dera e jashtme e kullës.

Tafën do ta gjeje kudo, jo vetëm në odën dibrane ku bëhej muhabeti por edhe në arat me grurë e misër, edhe në mbledhjet e fshatit, edhe na dasma e hidhërime, edhe atje ku kishte grindje e konflikte. Tafa ndodhej kudo dhe mendohej me fjalën e tij ti pajtonte, ti bashkonte të gjithë. Ky ishte misioni i tij e sot me plot bindje mund të themi se Tafë Dauti i Sllatinës ishte një Anton Çetë për Ujemujën.

Tafë Dautit i takojë para viteve nëntëdhjetë të vizitonte Turqinë, ku pa nga afër një realitet krejt ndryshe. Takoi atje mjaft shqiptar të emigruar në vite të hershme, pa se si shumë prej tyre e kishin harruar gjuhën e bukur shqipe, i kishin harruar doket dhe zakonet shqiptare. I erdhi keq Tafës, ua tha aty në takime që bëri me shqiptar të emigruar në viset turke, ua tha me dhimbje se nuk ka si vendi ynë, nuk ka si gjuha jonë.

Tafa u kthye në atdhe i mbushur me mlllef dhe mërzë. E para u lëndua se shqiptarët kishin harruar gjuhën, ishin larguar shumë nga doket dhe zakonet e bukura shqiptare. E dyta pa një realitet krejt ndryshe në Turqi. Atje nuk vdisnin njerëzit për bukën e gojës siç trumbetohej me forcë tek ne, jo, kishte bollëk, kishte rritje ekonomike, kishte një jetesë krejt ndryshe me ne, por Tafa e mbylli gojën e nuk foli fare për arritjet e vendit turk, nuk tregoi asgjë edhe pse shumë veta kërkonin të dinin më shumë.

Tafë Dauti e njihte fare mirë alegorinë por kurrë nuk e përdorte për të ngacmuar mikun. Vetë kontaktet e takimet që kishte patur me njerëz të zgjuar nga Luznia, Çidhna, Reçi e Dardha kishin ndikuar që edhe Tafa të bëhej një profesionist në përdorimin e Ujemujës, por ndryshe nga shumë të tjerë që ngacmonin mikun në konak. Sa herë fliste Tafa të gjithë dëgjonin dhe askush nuk ndërhynte se bisedat dhe tregimet e tij kishin interes tek të tjerët , sidomos tek më të rinjtë që herë-herë ishin të shpërqendruar.

Bisedat e tij ishin krejt ndryshe, nisnin rrjedhshëm, ëmbël dhe muhabeti zgjatej e zgjatej sa të pranishmit e gdhinin natën e gjatë të dimrit.

Tregonte mjaft bukur histori reale, të vërteta që kishin ndodhur në kohë e periudha të ndryshme. Kishte një kujtesë që mund të them se ishte një arkiv i gjallë. Gabime bëjmë në jetë, dhe sot shpreh bindjen time se pse sa ishin gjallë këto arkiva, pleq të zgjuar nuk kemi ditur ti shfrytëzojmë.

Thesarin që kishin na e morën me vete. Jo që nuk deshën të na e japin, por nuk ishim ne të zotët që t’ua vilnim.

Tafë Dauti vdiq në Sllatinë në më 9 shtator të vitit 1990, ku sivjet mbushi plot 30 vjet nga ndarja nga jeta. Vdekja e Tafë Dautit i kaloi përmasat e Ujemujës. Erdhën ditën e ceremonisë së varrimit nga të gjitha zonat e Dibrës dhe Lumës.

Atë ditë në qendër të Slllovës u ul edhe një helikopter që vinte nga Tirana. Kishin ardhur Haxhi Lleshi, Prokop Murra, Milo Qirko, Xhelil Gjoni për ti dhënë lamtumirën e fundit Tafë Dautit të Sllatinës. Nuk e kishin humbur bukën, mikpritjen dhe bujarinë që u kishte dhënë në ato kohë të vështira.

Kur shkruhet sot për figura të njohura si Tafë Dauti i Sllatinës pa dyshim që është nismë e bukur. Të paktën le të njihen brezat e ardhshëm me figura të tilla patriotike, atdhetare dhe humane.

HOMAZH

Lamtumirë bilbil i pemëtarisë dibrane!



Muhamet Ramizi (majtas) me një koleg

Një mesazh nga Perllat Sadiku.
Shkurt...
Muhamet Ramizi...
Dhe një “zarf” që nuk hapej.
E natyrshme më erdhi pyetja: Çfarë ka Muhamet Ramizi?
Vdiq sot. Rahmet pastë!...
E hënë 9 nëntor 2020...
Iu përgjigja: Më vjen keq!
Kaq? Vetëm “më vjen keq”?
Jo, jo. Më dhemb...

Dhe sa më shumë e kujtoj, aq më shumë më dhemb... Fort, shumë fort.

Kam punuar me Metin në Stacionin Bujqësor të Dibrës... Ai, bashkë me Haki Kolën, në grupin e frutikuturës, e unë në sektorin e propagandës bujqësore.

Në vitet tetëdhjetë... I shihja, grup, tek ngjiteshin e zbrisnin kodrave të Begunecit, me aparate rilevimi në krah... I jepnin formë brezareve për të mbjellura qershi e lajthi... I dhanë jetë plantacionit më të lartë të pemëtarisë dibrane, Kuplonit...

Në tavolinën e punës shihja projekte e skica... Ëndërronin që ta ngjisin edhe më lart pemëtarinë dibrane...

Muhamet Ramizi ishte një ndër specialistët më të mirë të pemëtarisë... I qetë, buzëqeshur!

Eh si më vjen ajo buzëqeshje shpirt! Më vjen si një tufë gonxhesh qershie, vishnje, molle, dardhe, kajsie... Në pranverë...

Si bistakë frutash që thyenin degë... Në verë e vjeshtë...

E kërkova në arkivin tim fotografik... Nuk mund të mos e kisha... E gjeta...

E kisha fiksuar... Me një shok, me një koleg... Me mollë në dorë, simbol i jetës së tij...

Lamtumirë Muhamet Ramizi!
Lamtumirë bilbil i pemëtarisë dibrane!

Abdurahim Ashiku
Athinë, 10 nëntor 2020

NGUSHËLLIM

Redaksia e gazetës i shpreh ngushëllimet bashkëpunëtorit tonë, Ilmi Dervishi, për ndarjen nga jeta të bashkëshortes, Nadire Dervishi, 63 vjeç.

Qoftë e parajsës!

Një aksident i papritur, afër Shkallës së Tujanit
më datën 22 nëntor 2020 i mori jetën Hidër Ibrahim Dacit.

Lamtumirë miku ynë i mirë **Hidër Daci**

Një aksident i papritur, afër Shkallës së Tujanit më datën 22 nëntor 2020 i mori jetën Hidër Ibrahim Dacit. Njerëzit e afërm, kolegët e punës, dashamirësit erdhën pranë familjes për të lehtësuar sado pak dhimbjen për humbjen e njeriut të tyre të dashur.

E përcollën në varrezat e Grevës, në vendlindje pranë prindërve të tij qytetarë nga Peshkopia e fshatrat për rreth, punëtorë të mobilerisë “Erald sh.p.k.” ku Hidri punonte specialist prej shumë vitesh, miq e shokë nga Tirana etj.

Hidër Daci lindi më 10/05/1952 në fshatin Grevë, në një familje të madhe, atdhetare e patriotike. Prindërit e tij ishin mjaft arsimdashës dhe u përpoqën shumë që djali i tyre si më i talentuari të vazhdonte shkollën, por lufta e klasave dhe ato njollat e vogla që sajoheshin në biografi ia privuan të drejtën për të vazhduar studimet e larta. Megjithatë fëmijët e Ibrahim Dacit çanë vetë në jetë mes dallgëve të vështira, krijuan familjet e tyre dhe sot gëzojnë respekt në Peshkopi, Tiranë, Vorë, Durrës, Lushnje etj.

Hidri mbaroi shkollën fillore dhe tetëvjeçare në vendlindje, Grevë, shkollën e mesme, gjimnazin në qytetin e Peshkopisë. U dallua midis moshatarëve të tij. Ishte shumë i sjellshëm, tepër aktiv, kishte pasion letërsinë por edhe arkitekturën.

Kur pa se iu mohua e drejta e studimit për në universitet, në moshë mjaft të re filloi si nxënës praktikant në ekonomi, në ndërmarrjen e përpunim drurit në Peshkopi.

Ai u rrit bashkë me ndërmarrjen dhe repartin e zdrukthtarisë. Shumë shpejt u ambientua, përvetësoi zanatin e marangozit duke rënë në sy si novator e krijues. Punëtorët e vjetër dhe me mjaft përvojë e mbajtën e afër, e mbështetën dhe e nxitën për të realizuar projekte të vështira e të komplikuar. U afirmua si mjeshtër i rrallë i rimesos së arrës, vidhit e panjës. Mobiljet që dispononin familjet në Peshkopi, Bulqizë e fshatrat e Dibrës në vitet 1975-1995, mbajnë firmën e Hidër Dacit dhe shokëve të tij. Këto punime u bënë të njohura edhe në rrethet e tjera si Burrel, Rrëshen, Shkodër e deri në Tiranë.

Në sajë të punës dhe përvojës së mjeshtërve të Dibrës, mobileria e Peshkopisë doli në treg me punime të imta artistike. Hidri dha një ndihmë të pa zëvendësueshme për pasurimin e muzeve të kulturës popullore në Peshkopi, në muzeun e Shkodrës (pavioni i Dibrës) etj.

Në sajë të vullnetit, durimit e këmbënguljes, Hidër Daci u bë një mjeshtër i gdhendjes e përpunimit të drurit duke rikthyer traditën e mjeshtërve dibranë që ishin bërë të njohur në Ballkan e më gjerë.

Si mjeshtër i mirë, bashkë me kolegët përballoi një volum të madh pune, që erdhi si rezultat i kërkesave të mëdha për



mobилje, orendi shtëpiake, dhoma gjumi, sallone pritje të cilësive shumë të mira për kohën. Ishte novator e krijues. Pak nga pak u larguan nga modelet standarte duke krijuar mobilje me projekte bashkëkohore, gjithnjë me përdorim të gjerë nga banorët e Dibrës.

Hidër Daci kishte kërkesa të mëdha ndaj vetes për zgjerimin e kulturës së tij të përgjithshme. Gjente kohë për leximin. Ishte antar shumë i rregullt i bibliotekës së Peshkopisë. Frekuentonte rregullisht institucionet kulturore të Dibrës si: teatrin, estradën etj.

Në muzeun historik të rrethit lexonte literaturë kryesisht historike që shfrytëzohej nga studiuesit e historisë pasi nuk gjendej në bibliotekë.

Megjithëse jetonte familjarisht në Grevë, ai çdo ditë udhëtonte nga qyteti i Peshkopisë natën për të vajtur në shtëpi, pasi kishte marrë ushqimin shpirtëror nga librat. Ky ritual i tij ishte bërë pjesë e kulturës së punës ditore dhe shumë vjeçare.

Kjo nuk ishte e mjaftueshme për lexuesin e librave ndër më të dalluarit në rrethin e Dibrës. Librat artistik, Hidër Dacit i ruheshin nën banak në librarinë e Peshkopisë, ku për arsye pune e shërbimi nuk ishte paraqitur për ti marrë.

Biblioteka e tij shumë e pasur është një pasuri e madhe që me të drejtë duhet të mburren pasardhësit e tij.

Bisedat për librat, diskutimet për letërsinë dhe autorë të ndryshëm, vendas dhe të huaj, tregonin më së miri nivelin e lartë kulturor të

Hidër Dacit. Shumë të rinj e bashkëbisedues e respektonin dhe admironin atë për vullnetin që manifestonte në punë por dhe në jetën e përditshme e marrëdhëniet me librin.

Nuk kishte panair libri që Hidër Daci të mos shkonte dhe të blinte libra. Një dëshirë e përcaktuar e tij ishte të vizitonte shtëpinë botuese “M&B” si dhe librarinë e saj.

Në gusht të vitit 1995 erdhi familjarisht në Tiranë. Rekomandimin për të punuar në mobilerinë “Abaz Ulliri” e priti me kënaqësi dhe shumë shpejt fitoi besimin dhe respektin e punëdhënësit.

Ambienti i ngrohtë që u rezervonte njerëzve të punës Abaz Ulliri, marrëdhëniet e shëndosha e vëllazërore që ndërtoi me kolegët e nxitën Hidrin të rrisë më shumë mjeshtërinë e përpunimit të drurit. Në dru ai skaliti mjaft objekte të vështirësisë së lartë siç ishin rozetat e tavanit të bankës kombëtare shqiptare, të bankës së Beratit, tavane të gdhendura të teatrit “Metropol” etj.

Punimet e realizuara nga mjeshtri Hidër Daci bëjnë pjesë në trashëgiminë tonë kulturore duke e çuar më përpara kulturën e përpunimit të drurit të mjeshtërisë dibrane. Me ato punime firma “Erald sh.p.k.” ku punonte është paraqitur edhe në panairët kombëtare e ndërkombëtare, si në ato të Shkupit, Budvës, Kroaci, Kosovë, Serbi, Tiranë etj. Pa frikë ai zbërthente çdo projekt e objekt nga përvoja shqiptare e botërore. Mjafton ti tregojë një fotografi nga një revistë dhe ai ishte në gjendje të jepte objektin me detaje shumë të imta e cilësore.

Keqardhje që mjeshtër të tillë pak vlerësohen nga shoqëria, pak punohet edhe prej të rinjve që për të mësuar profesione e zanate siç është edhe ai i gdhendjes e përpunimit të drurit. Mjeshtri Hidër Daci ndihmonte kolegët, kryente edhe punë të tjera kur duhej dhe lypsej bashkëpunimi e ndihma reciproke në procese të ndryshme. Mendja dhe duart e tij ishin të arta. Ai e bënte drurin të zbukurojë ndërtesën, sallën, ambientet ku banojnë e jetojnë njerëzit. Megjithëse me kushte jo të favorshme ekonomike në vitet e luftës në Kosovë ai mori një familje kosovare nga Peja për rreth tre muaj, duke kontribuar kështu sado pak në çështjen kosovare. Kanë kaluar 20 vjet dhe ai mbante lidhje e kontakte me këtë familje në kushte të reja të paqes, për të forcuar më shumë miqësinë me vëllezërit tanë kosovarë.

Kishte mjaft dëshirë të eksplorojë e të njoh botën, kulturën e vendeve të tjera, prandaj udhëtonte pothuaj se çdo vit dhe bënte vizita në vende të ndryshme si: Stamboll, Antalia, Kroaci, Mal i Zi, Itali, Gjermani, Francë, Spanjë, Maqedoni, Greqi etj. Shfrytëzonte guidat turistike për të njohur historinë dhe kulturën e popujve të tjerë.

Lidhjet me miqtë dhe me shokët përbënin prioritet në jetën e tij të përditshme. Nuk hezitonte asnjëherë për të ndihmuar njerëzit e veçanërisht dibranët.

Hidër Daci u nda nga jeta para kohe. Humbja e madhe jo vetëm për familjen, gruan, djalin, vajzën por edhe për miqtë, të afërmit, kolegët e punës, shokët.

Humbja e tij krijoi një boshllëk që nuk mund të zëvendësohet. Iku në një kohë kur të gjithë kishim nevojë për të, për punën, ndihmën, këshillat me mjaft vlerë, nipërit dhe mbështetjen e tij prindëror.

Të gjithë ata që e njohën nga afër Hidër Dacin, do ta kujtojnë gjithmonë si një punëtor shembullor, mjeshtër i talentuar i drurit, prindin e dashur, shokun dhe mikun model, njeriun human e zemër bardhë.

Lamtumirë i dashur Hidër Daci!

Adem Bunguri, Sulë Ulliri, Avni Kacnia, Agim Spahiu, Sokol Juniku, Zabit Lleshi, Arjan Muja, Nehat Daci, Shaqir Skarra.

Bardhyl Hidër Manjani, biri i Grykës së Vogël



Ndahet nga jeta në moshën 82 vjeçare, ish ushtaraku i karrierës Bardhyl Manjani.

Dibra ka një histori të lashtë, me popullim të hershëm. Ajo renditet ndër qytetet e vjetra të banuara dhe ruan një popullsi të mirëfilltë qytetare.

Në vitin 1918, në Homesh të Grykës së Vogël, Diber u hap shkolla e parë shqipe. Të gjithë mësuesit e Dibrës kanë dhënë kontribut të jashtëzakonshëm për formimin e brezave të tërë, kontribut i cili është i njohur nga historiku i arsimit shqiptar. Ndër emrat e shquar me përvojë 40 vjeçare në mësime dhe drejtim në këtë shkollë, është edhe mësuesi i mirënjohur, Hidër Manjani.

Pikërisht, në këtë familje të lidhur me arsimin, kontributin gjatë luftës nacional çlirimtare dhe rindërtimin e mirëqenien e vendit, si edhe traditat e hershme dibrane, lindi në vitin 1938, Bardhyl Hidër Manjani.

I parëlindur në një familje me 6 fëmijë, ai u bë herët mbështetësi kryesor i prindërve të tij, Hidër e Libade Manjani në mbarëvajtjen e familjes.

Arsimin fillor e kreu në Zërqan në vitet 1945 – 1949, për të ndjekur më pas shkollën “Skënderbej” në Tiranë në vitet 1951-1955. Edukimi i tij vijoi me studimet në shkollën e bashkuar, të cilën e përfundoi me rezultate të shkëlqyera.

Në vitin 1957, filloi punë si oficer i karrierës, duke dhënë shembull të shkëlqyer në çdo detyrë që i ngarkohej. Në fillim, u emërua në Elbasan, pastaj në Durrës. Nisur nga rezultatet e larta në punë dhe si kuadër me perspektivë, u dërgua në akademinë ushtarake. Me mbarimin e akademisë me rezultate të larta u emërua në detyrë të rëndësishme, si: shef operativ në korpusin e Tiranës, etj... Për rezultate të larta në punë, u caktua komandant i njësisë (brigade) në Kavajë në vitin 1973. Doli në pension në vitin 1992.


Në të gjitha detyrat e ngarkuara, ka qenë korrekt dhe i ka kryer me devotshmëri. Për arritje dhe rezultate të larta në karrierën e tij 35 vjeçare në ushtrinë shqiptare, është vlerësuar me tituj e dekorata të ndryshme.

Ish kolegë e bashkëpunëtorë të tij, ushtarakë në pension e lirim, të cilët kanë bashkëpunuar me të, i kanë vlerësuar gjithnjë lart rezultatet profesionale të tij.

Ndërroi jetë në 27 Tetor 2020.

Mirjam Reçi



FOTOLAJM: LIDHET URA E FSHATIT, NË PRANVERË NIS QARKULLIMI


Ura e Fshatit Fshat u bashkua më 25 nëntor 2020, duke i hapur kështu mundësitë që në pranverën e vitit të ardhshëm, në rrugë të nisë qarkullim i automjeteve.

Kjo urë është një nga gjashtë urat e Rrugës së Arbrit, e dyta për nga rëndësia, pas Urës së Vashës. Ajo është e gjatë 174 metra dhe e lartë 157 metra. Konstruksionet metalike të saj, ashtu si Ura e Vashës, janë realizuar me elemente çeliku me karbon të saldueshëm. Përfundimi i saj shënon simbolikisht edhe lidhjen e plotë të të gjitha segmenteve në ndërtim të rrugës, përjashtuar tunelin e Murrizit, 3.8 km të gjatë, që pritet të përfundojë në qershor 2023. Me përfundimin e kësaj ure, tashmë puna kryesore në veprat e artit, ura dhe tunele, pothuajse kanë përfunduar.

Kontrata me kompaninë Gjoka Konstruksion, e nënshkruar më 28 mars 2018, parashikon që punimet të mbarojnë në fund të vitit të ardhshëm, por Presidenti i Kompanisë i premtoi atëherë Kryeministrit Rama, gjatë ceremonisë së nisjes së punimeve, se rruga do të hapej 6 muaj përpara afatit.

Por, siç është bërë e njohur përmes shtypit, punimet nuk kanë ecur ashtu siç duhej. Në maj 2019 ndodhi një shembje në Tunelin e Murrizit, duke detyruar kompaninë të ndryshonte projektin dhe duke e zgjatur tunelin edhe 600 metra të tjera. Ndërtimi i një by-passi, 9.5 km të gjatë u bë i detyrueshëm për të nisur qarkullimi në rrugë. Gjithashtu, shembjet në Bastar të Mesëm gjatë këtij viti, kanë krijuar vonesa në punime.

Burime nga punonjës të kompanisë, thonë se për përfundimin e Urës së fshatit Fshat dhe Tunelit të Murrizit, janë marrë përsipër nga një kompani turke.

Rruga e Arbrit është e gjatë 73.5 km, nga të cilat rreth 12 km nga Bulqiza te Ura e Cerencit konsiderohet e përfunduar. Kur kompania Gjoka Konstruksion mori rrugën me koncension, 15 km rrugë ishin përfunduar pjesërisht, ndërsa rreth 26 km ishin të paprekura me punime. Tashmë, rruga është e prekshme tërësisht në gjatësinë e saj, kështu që shpresat për nisjen e qarkullimit në pranverë janë të mëdha.

Rruga në fillim u parashikua se do ti kushtojë buxhetit të shtetit rreth 240 milionë euro për 13 vjet, por tashmë pas problematikave të shfaqura gjatë ndërtimit, kostoja e saj finale nuk dihet.

**REKLAMO
BIZNESIN
TËND**

Një faqe e plotë
me ngjyra kushton
15000 lekë

Me **1000** lekë
mund të rezervosh
një reklamë gjatë
gjithë vitit në format
kartvizite (8x5cm)

NE jemi gazetë e lirë dhe e pavarur nga ndikimi
politik. Pavarësia dhe liria jonë garantohet
vetëm nga mbështetja e lexuesve...
BËJ PAJTIMIN TËND!

Një pajtim vjetor kushton: **600 lekë.**
Në Europë: **10 Euro.**
Në SHBA dhe vende të tjera: **15 USD.**
Pajtimi në Europë dhe SHBA është vetëm në
versionin PDF.

Botimi i gazetës është
punë vullnetare,
ndaj çdo pajtim vjetor ose
dhurim, është i mirëpritur.
Dhurimet pranohen vetëm
përmes llogarisë bankare që
gjendet më poshtë dhe për çdo
rast ai do të bëhet publik.
**Raiffeisen Bank, Rr. Kavajës,
Tiranë. Sëift code: SGSBALTX.
IBAN(ALL): AL44 2021 1219
0000 0000 1003 6640**